Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për procedurë penale (LPP) erdhi deri te ndryshimi i organit të hetuesisë, dhe në këtë drejtim, në nenin 39 të Ligjit për procedurë penale ("Gazeta Zyrtare" nr.150/2010), me tjerash thuhet se ky organ, "nxjerrë urdhër dhe zbaton procedurë hetimore". Por, më tutje në Ligjin e njëjtë, në nenin 177 paragrafin 2 ku përcaktohen të drejtat e personave të paraburgosur thuhet "I paraburgosuri ka të drejtë të ushqehet me harxhime të veta, të merr vesh rroba të veta dhe të shërbehet me çarçafë të vetë, me harxhime të veta të furnizohet me libra, gazeta dhe sende të tjera të cilat shërbejnë për nevojat e veta të rregullta, po qe se një gjë e tillë nuk ishte e dëmshme për udhëheqjen me sukses të procedurës. Për këtë vendos organi i cili udhëheq me procedurën hetimore.

Duke u nisur nga e drejta parimore si dhe obligimi I Prokurorit Publik që t'i ndjek kryerësit e veprave penale, Avokati i Popullit-Mekanizëm Parandalues Nacional paraqiti Mendim se i njëjti organ nuk duhet të vendos për të drejtat e personave të paraburgosur, për arsye se ai e udhëheq hetimin, paraqitet si organ i cili i ndjek kryerësit e veprave penale, si dhe paraqet dhe i prezanton akuzat para gjyqit kompetent.

Në këtë drejtim kërkoi ndryshimin e nenit të cekur, me qëllim të shmangies së pasojave të mundshme ndaj të drejtave të personave të paraburgosur, të cilat në ndërkohë janë rregulluar me Rregulloren për ekzekutimin e masës së paraburgimit, e cila në tërësi e përfshinë materien e shfrytëzimit të shtrojës personale, ushqimit, si dhe furnizimit me libra dhe gazeta, për të cilat vendos gjyqi kompetent.

¹ Ministria e shëndetësisë nuk ka dorëzuar përgjigje as dhe për raportet e veçante për spitalet e psikiatrisë: Negorci, Demir Hisar dhe Bardovci për vizitat e realizuara në vitin 2012

1.6 PROMOVIMI I MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL DHE PËRFORCIMI I KAPACITETEVE NË PJESËN E REALIZIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA

Në vitin raportues MNP-ja zbatoi disa aktivitete promovuese dhe edukative edhe atë në drejtim të njoftimit të opinionit me rolin e MPN-së në shoqëri dhe përformimin e kapaciteteve në pjesën e realizimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Këto aktivitete u mbështetën nga Instrumenti për Ndihmë Teknike dhe Shkëmbim të Informacioneve të Komisionit Evropian (TAIEX). Me përkrahjen e TAIEX-it u mbajtën tri punëtori në nivel nacional dhe një konferencë në nivel rajonal.

Punëtorja e parë iu dedikua "Video mbikëqyrjes në vendet e privimit nga liria" e cila u organizua në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përveç MPN-së dhe Drejtorisë, në këtë punëtori diskutime të tyre patën edhe përfaqësuesit e Këshillit të Evropës në lidhje me çështjet e të drejtës së privatësisë përkundër nevojës së sigurisë në vendet e privimit nga liria, si dhe përfaqësuesit e MPN-s çeke i cili i shpalosi përvojat e tija në lidhje me këtë çështje. Në fund të punëtorisë u përpiluan edhe konkluzionet themelore në lidhje me sigurimin e të drejtës së privatësisë në vendet e privimit nga liria, duke e respektuar integritetin personal të personave, por edhe duke siguruar mbrojtje dhe siguri në vendet ku ata qëndrojnë. Ndër të tjerash, u konstatua se është e nevojshme që të rregullohet në mënyrë plotësuese Ligji për ekzekutimin e sanksioneve në aspekt të mënyrës dhe kushteve për zbatimin e video mbikëqyrjes nëpër institucionet ndëshkuese-korrektuese. Gjithashtu, u potencuar se gjatë zbatimit të video mbikëqyrjes në vendet e privimit nga liria duhet të respektohen parimet për mbrojtjen e të dhënave personale edhe atë: drejtësia dhe ligjshmëria, proporcionaliteti, udhëheqja e të dhënave të sakta, të tërësishme dhe të azhurnuara dhe ruajtja e tyre në afatin e saktë kohor.

Punëtorja e dytë nacionale e mbështetur nga Instrumenti TAIEX iu dedikua temës: "Roli i gjykatësit në realizimin e të drejtave të personave të privuar nga liria". Në lidhje me këtë temë, diskutime të tyre patën përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përfaqësuesit e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, gjykatës për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe anëtari i mëparshëm i Komitetit për Parandalimin e Torturës pranë Këshillit të Evropës. Gjithashtu, përvoja krahasuese, në lidhje me këtë çështje, prezantoi edhe përfaqësuesi i MPN të Austrisë. Një nga konstatimet e kësaj punëtorie ishte se roli i gjykatësit është shumë i rëndësishëm në pjesën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria. Gjykatësi, jo vetëm që duhet ta zbatojë të drejtën materiale, por duhet të sigurojë edhe respekt të tërësishëm të të drejtave të personave përderisa ata janë të privuar nga liria. Po ashtu, u konkludua se nevojitet komunikim intensiv dhe i vazhdueshëm, si dhe koordinim midis të gjithë faktorëve të cilët ndikojnë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë vendosin për të drejtat e personave të privuar nga liria, me qëllim të sigurimit të kushteve humane si dhe të realizimit të pandërprerë të minimum standardeve për personat e privuar nga liria.

Ngjarja e fundit e përfshiu temën: "Mbrojtja e personave të mitur gjatë ndalimit policor", ndërsa qëllimi i kësaj punëtorie ishte që nëpërmjet prezantimeve, diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave të kontribuohet drejt përmirësimit të kushteve për ndalimin e të miturve, si dhe të përfordhet mbrojtja e të drejtave të personave të mitur. Në punëtorinë e njëjtë, u konstatua se me fëmijët të cilët janë privuar nga liria duhet të vepohet duke e respektuar dinjitetin e tyre, si dhe të merren parasysh nevojat në pajtim me moshën e tyre. Në këtë punëtori, diskutime të tyre patën edhe përfaqësuesit e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës, Këshilli Shtetëror për Parandalimin e delikencës tek Fëmijët, ndërsa përvojat komparative i shpalosë edhe përfaqësuesit e MPN të Britanisë së Madhe dhe Polonisë.

MPN-ja me mbështetjen e TAIEX-it realizoi edhe vizitë studimore të MPN danez, ku u shkëmbyen eksperiencia dhe praktika të mira nga fusha e parandalimit të torturës në vendet e privimit nga liria. Gjatë vizitës studimore, MPN u njoftua me mënyrën e bashkëpunimit me sektorin civil i cili e ka këtë mekanizëm, dhe në këtë drejtim u realizuan takime me Institutin Danez për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe me Institutin Danez Kundër Torturës. Gjithashtu, u mbajt takim me Drejtorinë e Burgjeve dhe Provave pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe njëherësh u vizitua edhe burgu në Kopenhagë.

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve të personave zyrtarë të cilët i trajtojnë personat e privuar nga liria, MPN mbajti ligjërata për trajnim bazë për nëpunësit policorë në Qendrën për Trajnim të Ministrisë të Punëve të Brendshme. Në mënyrë plotësuese MPN-ja mbajti fjalim edhe gjatë trajnimeve të vazhdueshme të cilat MPB-ja i organizonte për njësitë e veçanta policore si dhe për grupet për intervenim.

Me rastin e ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Mekanizmi Parandalues Nacional mbajti ligjërata në Fakultetin për siguri, me temën "Të drejtat e personave të privuar nga liria". Në këtë rast, MPN-ja i njoftoi studentët me Raportin vjetor për vitin 2012, si dhe rolin të cilin e ka Seksioni për Parandalimin e Torturës, instruksionet dhe rekomandimet e dhëna, si dhe bashkëpunimin me organet, me qëllim të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

1.7 DUKSHMËRIA DHE TRANSPARENCA E PUNËS SË MPN-SË

Mekanizmi Parandalues Nacional, në faqen e Internetit të Avokatit të Popullit rregullisht i publikonte informacionet për të gjitha aktivitetet e veta, si dhe për vizitat e realizuara, për punëtoritë e organizuara, si dhe për mendimet dhe iniciativat e paraqitura deri te organet kompetente. Përmes publikimit të rregullt të informatave MPN siguroi transparencë dhe publicitet të punës së vet.

Në vitin raportues, Mekanizmi Parandalues Nacional e prezantoi Raportin Vjetor për vitin 2012, i cili përmban edhe pjesë të veçanta tematike për kategoritë e personave të margjinalizuar në vendet e privimit nga liria. Me 16 maj të viti 2013, publikisht u prezantua Raporti vjetor i Mekanizmit Parandalues Nacional nga ana e Avokatit të Popullit dhe i njëjti iu dërgua organeve përkatëse dhe ministrive kompetente, si dhe Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues, si dhe pranë institucioneve të tjera ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave njeriut.

1.8 BASHKËPUNIMI ME NËNKOMITETIN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË MPN

Bashkëpunimi me Nënkomitetin për Parandalimin e Torturës pranë Kombeve të Bashkuara vazhdoi të realizohet edhe këtë vit raportues nëpërmjet dërgimit të Raportit vjetor të MPN për vitin 2012, mirëpo edhe përmes pjesëmarrjes nëpër disa ngjarje të cilat Mekanizmi Parandalues Nacional i zbatoi gjatë vitit 2013.

Bashkëpunimi me Nënkomitetin, posaçërisht u potencua edhe Konferencën Ragonale të cilën e organizoi MPN-ja me mbështetjen e TAIEX-it, në të cilin një nga konstatimet ishte që të mbahet dialog konstruktiv dhe i dykrahshëm me trupat ndërkombëtare për parandalimin e torturës, si dhe mundësia që në mënyrë të drejtpërdrejtë të dërgohen rekomandimet të cilat i japin këto trupa.

Në këtë takim rajonal morën pjesë përfaqësues të MPN të Shqipërisë, MPN të Maqedonisë, MPN të Serbisë, MPN të Sllovenisë, MPN të Malit të Zi, Ombudsmanët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Kosovës, MPN i Polonisë, si dhe përfaqësues të Asociacionit për Parandalimin e Torturës dhe Komisionit për Parandalimin e Torturës pranë Këshillit të Evropës. Në punëtorinë dyditore u diskutua për mënyrën e vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vizitat parandaluese, si dhe për zbatimin e vizitave për ri-kontroll ose kontrolluese në vendet e privimit nga liria. Pjesëmarrësit në konferencë shkëmbyen përvoja edhe për efikasitetin e MNP nëpërmjet sigurimit të buxhetit adekuat, bashkëpunimit me sektorin civil dhe përfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm, me qëllim të sigurimit të ekspertizës dhe të qasjes multidisiplinore.

Mekanizmi Parandalues Nacional ishte njëri prej iniciatorëve për formimin e Rrjetit të MNP-së të Evropës Juglindore. Në takimin në Beograd, në të cilin morën pjesë MPN-të rajonal, si dhe përfaqësues të Avokatit të Popullit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të trupave ndërkombëtare për parandalimin e torturës, u miratua Deklarata për bashkëpunim përmes formimit të rrjetit i cili do të ketë për qëllim avancimin e mëturjes së bashkëpunimit të deritanishëm, i cili ekziston në rajonin e Evropës Juglindore, si dhe mundësimin e përkrahjes së ndërsjellë.

Përfaqësues i MPN mori pjesë edhe në takimin e Rrjetit të MPN të Evropës Juglindore, i cili u mbajt në Beograd me temën: "Roli i mjekut në realizimin e vizitave parandaluese me qëllim të mbrojtjes së personave të privuar nga liria". Në këtë takim, përveç përfaqësuesit të MPN-së të Maqedonisë mori pjesë edhe njëri nga bashkëpunëtorët e jashtëm, gjegjësisht psikiatër nga Shoqata e Psikiatërve të Republikës së Maqedonisë. Në takim u diskutua për qasjen multidisiplinare të punës së MPN, standardet e mbrojtjes shëndetësore në vendet e privimit nga liria, rolin e punëtorëve shëndetësor në parandalimin e torturës, si dhe standardet për institucionet psikiatrike të rëndësishme për punën e MPN. Në këtë takim punues morën pjesë përfaqësues të MPN, si dhe mjek të cilët marrin pjesë në vizitat parandaluese nga: Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia, Serbia, dhe Bosnja dhe Hercegovina.

MPN-ja, ka marrë pjesë edhe në Konferencën me temën: "Ndalimi i emigrantëve në Evropë", e cila ishte nën organizimin e Këshillit të Evropës dhe Mekanizmit Nacional Parandalues (MPN) të Mbretërisë së Bashkuar, i cili u mbajt në Strasburg, Francë. Në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të MNP nga numër më i madh të vendeve të Evropës, Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës të Kombeve të Bashkuara, Asociacioni për Parandalimin e Torturës dhe organizata tjera ndërkombëtare. Mekanizmat parandalues nacional, përmes grupeve punuese diskutuan për vendosjen e standardeve të cilat duhet të plotësohen në aspektin e të drejtave dhe kushtet në të cilat vendosen emigrantët. Në fund të konferencës u konstatua se është e nevojshme që të përgatitet Deklarata për nevojën e zhvillimit të standardeve për qendrat e migrimit e cila do të dërgohej deri te trupat evropian me çka do të rregullohej kjo materie sipas shembullit të Rregullave Evropiane të Burgjeve.

2 VIZITA TË RREGULLTA PARANDALUESE NË VITIN 2013

Në vitin 2013, MPN, në përputhje me programin vjetor për parandalimin e torturës, realizoi 16 vizita të rregullta parandaluese në vendet e privimit nga liria, si dhe në vendet ku liria e lëvizjes është e kufizuar ose de facto janë vende të privimit të lirisë.

Qëllimi i vizitave të rregullta parandaluese është përcaktuar konform mandatit i cili buron nga Protokollin Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtitit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues. Me Protokollin Fakultativ definohet se qëllimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria është identifikimi i rreziqeve për shkak të ndalimit të torturës ose të llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues. Njëkohësisht, me vizitat e rregullta Mekanizmi Parandalues Nacional i përcaktonte kushtet e qëndrimit dhe të vendosjes së personave të privuar nga liria, si dhe të personave tjerë të cilëve liria e lëvizjes u është e kufizuar, realizimin e të drejtave të tyre, si dhe identifikimin e rreziqeve të mundshme nga tortura ose nga ndonjë lloj tjetër i trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Gjitha vizitat e rregullta u realizuan pa paralajmërim paraprak edhe atë 6 në stacione policore me kompetenca të përgjithshme, 3 në stacionet policore për kontroll kufitarë (Tabanovcë, Bllacë dhe Bogorodicë), 2 në institucione ndëshkuese-korrigjuese (Repartin e Arrestit dhe Repartin e Hapur Kriva Pallankë në kuadër të Burgut Kumanovë), në Klinikën për Psikiatri si dhe në 4 institucione tjera (IP Shtëpia për Fëmijë "11 Tetori", Institucioni Publik për Mbrojtje dhe Rehabilitim Banja BANSKO, Institucioni Publik për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve "Topansko Pole", si dhe në Drejtorinë e Doganave).

Vizitat u realizuan nga ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional i përbërë nga dy këshilltarë, kurse në një pjesë të vizitave u përfshinë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët i posedojnë aftësitë e duhura, si dhe njohuritë profesionale dhe adekuate varësisht prej vendeve të cilat u vizituan.

2.1 STACIONE POLICORE

Në vitin 2013, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizita të rregullta të pa paralajmëruara në 6 stacione policore me kompetenca të përgjithshme (SPKP), të cilat në pajtim me aktvendimin e Ministrisë për Punë të Brendshme janë caktuar si vende për ndalimin e personave të privuar nga liria². Në përputhje me këtë aktvendim, ndalim i personave bëhet në 38 stacione policore me kompetenca të përgjithshme, kurse në bazë të nenit 161 paragrafi 4 të Ligjit për procedurë penale personi mbahet në stacione të posaçme të rregulluara policore të caktuara me akt të ministrit për Punë të Brendshme.

² Aktvendim për caktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, Nr. 163 nga 25.11.2011 ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.163/2011)

Në bazë të Programit vjetor të Mekanizmit Parandalues Nacional për vitin 2013, u vizituan stacionet policore me kompetencë të përgjithshme: **SP Shtip, SP Kërçovë, SP Ohër, SP Manastir, SP Strumicë dhe SP Veles**. Në përputhje me Metodologjinë e përcaktuar, MPN-ja për të gjitha vizitat e realizuara përgatiti raporte të veçanta me konstatime dhe rekomandime përkatëse të cilat iu dërguan kryeshefave të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme Ministrisë për Punë të Brendshme, me qëllim të ndërmarrjes së masave për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara negative.

2.1.1 Trajtimi i personave të privuar nga liria

Gjatë vizitave të rregullta të stacioneve policore (SP), MNP takoi vetëm një person të ndaluar edhe atë në SP në Ohër. Gjatë bisedës me personin e ndaluar MPN-ja nuk mori ankesa se me të është vepruar në mënyrë joprofesionale nga ana e nëpunësve policorë, personi potencoi se ka qenë i njoftuar për arsyet e privimit nga liria dhe se i janë udhëzimet për të drejtat gjatë arrestimit si dhe ndalimit të tij në SP Ohër. Gjithashtu, personit të ndaluar i është lejuar që të thërret avokat, kurse gjatë kohës derisa ka qëndruar në SP Ohër nuk është përballur me kërcënime ose lëndime nga ana e personave zyrtarë. MPN-ja konstatoi se personi ka qenë i informuar në gjuhën të cilën ai e flet ose e njeh dhe se ka qenë i njoftuar me të drejtat e tij në stacionin policor (të drejtë që të hesht, të këshillohet me mbrojtës-avokat, si dhe të drejtën e ndihmës mjekësore). Personi i ndaluar theksoi se kur ka pasur nevojë ka trokitur në derën e dhomës për arsye se në të njëjtën nuk ka sistem për thirrje, kurse për gjatë kohës së ndalimit, me kërkesë të tij, i është siguruar ushqimi nga mjetet që i ka pasur në disponim, si dhe i është lejuar shfrytëzimi i tualetit, me ç'rast i janë dhënë mjete për higjienë.

Nga gjendja e konstatuar, në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria, MPN-ja arriti në përfundim se në SP Ohër veprohet në mënyrë adekuate me personat e privuar nga liria, gjegjësisht personat e ndaluar në mënyrë adekuate dhe me kohë i udhëzojnë/mësojnë dhe i realizojnë të drejtat e tyre ligjore në procedurë policore.

2.1.2 Kushtet materiale

Hapësirat për ndalim

Gjatë vizitave të realizuara në vitin 2013, është bërë këqyrje në një stacion policor me kompetenca të përgjithshme me hapësira të reja për ndalim dhe në 5 stacione policore me kompetenca të përgjithshme me hapësira të vjetra për ndalim. SP Shtip ka hapësira të reja për ndalim, i njëjti SPKP është rinovuar me projektin për rinovimin e vendeve për ndalimin e personave të privuar nga liria të zbatuar nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB), kurse financiarisht i përkrahur nga Komisioni Evropian.

Në stacionet policore, ku hapësirat për ndalim janë të vjetra, gjendja nuk është në nivelin e duhur, kurse tek disa prej tyre gjendja është brengosëse. Në pjesën më të madhe të këtyre stacioneve policore hapësirat për ndalim janë të vendosura në hapësirat e bodrumit dhe katet përdhese (SP Kërçovë, SP Manastir dhe SP Veles).

MPN-ja shprehu shqetësim në lidhje me hapësirat për ndalimin e personave të privuar nga liria në Stacionin Policor në Kërçovë, duke theksuar se edhe mbajtja në kushte nën standarde paraqet trajtim johuman dhe nënçmues.

MPN-ja konstatoi se në hapësirat për ndalim në SP Kërçovë ka nivel të dobët

të ventilimit dhe lagështi të madhe, ndërsa dyshekët ishin shtruar në tokë pa krevate adekuate për personat e ndaluar.

Njëherësh, MPN-ja konstatoi se SP Kërçovë, në pjesën ku janë ndaluar personat e privuar nga liria nuk ka sistem të veçantë për thirrje, të ashtuquajtur alarm.

Në pesë stacionet e vizituara policore me hapësira të vjetra për ndalim (SP Kërçovë, SP Ohër, SP Manastir, SP Strumicë dhe SP Veles) u konstatua se në hapësirat për ndalim nuk kanë të instaluar sistem të posaçëm qendror për ngrohje dhe ftohje, kështu që shqetëson fakti se si ngrohen ato hapësira ngrohen gjatë ditëve të dimrit. MPN-ja hasi në situata ku hapësirat për ndalim, edhe pse janë të pozicionuara në pjesën përdhese të stacionit policor dhe të njëjtat i përmbushin standardet sa i përket pozitës së vendeve ku personat privohen nga liria, megjithatë nuk i përmbushin minimum standardet për ndalim sa i përket ndriçimit (SP Ohër dhe SP Strumicë). Në SP Ohër në pjesën ku ndalohen personat e privuar nga liria nuk ka sistem të posaçëm për thirrje, përkatësisht alarm, me çka MPN e ngriti çështjen se në çfarë mënyre personat e privuar nga liria do të mund të lajmërojnë me kohë dhe urgjentë nëpunësit policorë për nevojat e tyre, duke e pasur parasysh se hapësirat për ndalim janë të ndara nga zyrat e tjera të SP Ohër.

Në Stacionin Policor Strumicë u vërejt se hapësirat mbahen pastër, të njëjtat ishin të rregulluara dhe të ngjyrosura. Në mënyrë shtesë, u konstatua se në këto hapësira krevatet janë të fiksuara në dysheme me çka sigurohet mbrojtje më e madhe e personave të ndaluar. Mirëpo në krevatet nuk kishte dyshek e as jastëk, por tek në të njëjtët ishin shtruar batanije të vjetra të cilat nuk ishin të mjaftueshme për ngrohje, duke e pasur parasysh se në hapësirat ishte matur temperaturë relativisht e ulët. Temperatura e matur ishte rreth 14°C e që është nën standardet e dëshiruara dhe është e nevojshme ngrohja shtesë e këtyre hapësirave dhe posaçërisht kur ka persona të privuar nga liria.

Në Stacioni Policor Veles, edhe pse hapësirat nuk janë të rinovuara, mund të vërehet se ishin të rregulluara me çarçafë të pastër, ndërsa muret ishin të ngjyrosura dhe të bardha. Nëpër hapësira janë të vendosur dy krevate, ndërsa gjatë matjes u konstatua se nuk janë plotësuar standardet ndërkombëtare të cilat kërkojnë nga 4m² për person gjatë vendosjes kolektive. Gjithashtu, në SP Veles hapësirat për ndalim nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë deri te ndriçimi natyror, ndërsa ndriçimi artificial hyn nëpërmjet të korridorit ku gjinden hapësirat për ndalim.

Në lidhje me rregullimin e hapësirave të reja për ndalim, u konstatua se të njëjtat janë të pajisura me krevate të standardizuara, të fiksuara për dysheme dhe pajisje të unifikuar për pushim nate të përbërë nga dyshekë mbulesë të plastifikuar, batanije, çarçafë dhe jastëk. Mirëpo, jo në të gjitha stacionet policore ku ka hapësira të reja për ndalim shfrytëzohen pajisja e plotë për pushim. MPN-ja, në vitin 2013, realizoi vizitë të rregullt vetëm në një SPKP me hapësira të reja për ndalimin e personave të privuar nga liria (SP Shtip). Hapësirat për ndalim në SP Shtip janë të rregulluara në mënyrë adekuate me mjete të pastra dhe të rregulluara për pushim (për ndalime afatshkurtra dhe për ndalim gjatë natës), siç është krevati, dysheku, batanija, mirëpo nuk kishte jastëk për pushim dhe gjumë gjatë natës. Në SP Shtip hapësirat për ndalim janë punuara në mënyrë dhe nga materiale të cilat mundësojnë shkallë të lartë të mbrojtjes nga lëndimet, përderisa si masë mbrojtëse shtesë është edhe video mbikëqyrja dhe krevatet e fiksuara për dysheme, me çka pamundësohet shfrytëzimi jo i drejtë i tyre dhe keqpërdorimi i tyre nga ana e personave të ndaluar. Video mbikëqyrje adekuate në SP Shtip ka edhe në korridorin para hapësirës për ndalim, si dhe në hapësirat për marrjen në pyetje të personave. Gjithashtu, në hapësirat për ndalim është instaluar sistem për thirrje (interfon), i cili ishte në funksion në të dy hapësirave për ndalim, ndërsa në hapësirën e tretë i njëjti nuk funksiononte.

Në hapësirat e reja për ndalim janë të plotësuar (SP Shtip) standardet ndërkombëtare edhe sa i përket madhësisë së hapësirave, gjegjësisht standardeve të vendo-

sura nga Komiteti i Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT). Këto hapësira janë me sipërfaqe më të madhe se 6 m² me çka plotësohet standardi minimal prej 4 m² për person.

Nga 6 stacionet e vizituara policore, MPN konstatoi se në asnjërin stacion policor nuk ka hapësirë të veçantë për ndalimin e personave të mitur dhe nga kjo Avokati i Popullit-MPN shpreh shqetësimin për moszbatimin e dispozitave të Ligjit për të drejtat e fëmijëve. Në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore në vitin 2013 u konstatua se personat e mitur mbahen në hapësirat ekzistuese për ndalim, ndërsa diku edhe në zyrat zyrtare, gjë që në realitet paraqet mosrespektim të Ligjit për të drejtat e fëmijëve. Në dy SP (Veles dhe Strumicë) ka hapësira të veçanta të rregulluara për biseda me fëmijët, të cilat janë të pajisura në mënyrë adekuate dhe iu përgjigjen moshës për të cilën janë dedikuar. Megjithatë, MPN-ja u informua se këto hapësira në esencë shfrytëzohen për biseda me fëmijë-viktima, por jo edhe me fëmijë kryerës të veprave penale.

Në pjesën e qasjes deri në stacionet policore Mekanizmi Nacional Parandalues konstatoi se në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore nuk ekziston ndonjë platformë qasëse për personat me nevoja të veçanta në hyrje të stacioneve policore. Platforma qasëse në hyrje të stacionit policor u vërejtën vetëm në SP Shtip, ndërsa në SP Strumicë, hyrja nuk ka shkallë dhe e njëjta është e artishmei kapshëm për personat me nevoja të veçanta. Platformë të veçantë për personat me nevoja të veçanta ka gjatë hyrjes në zyrën e kujdestarisë në stacionin e njëjtë policor.

Shqetësuese është qasja deri te hapësirat për ndalim në stacionin policor Ohër, i cili është vetëm me shkallë dhe nuk ekziston platformë qasëse për personat me nevoja të veçanta. Njëkohësisht, shkallët nuk janë të siguruara me rrethojë mbrojtëse dhe paraqesin rrezik për sigurinë, sikur për personat e privuar nga liria po ashtu edhe për personat zyrtarë të stacionit policor. Në pajtim me nenin 4 të Rregullores për normativat dhe standardet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë hapësirat për ndalimin e personave në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme të Ministrisë për Punë të Brendshme „qasja deri te hapësirat për ndalim duhet të jetë e lehtësisht e arritshme për automjetet për intervenim të policisë me hyrje të veçantë në objekt e cila do të shfrytëzohet vetëm për këtë qëllim, ndërsa mundësisht qasja duhet të jetë pa shkallë”.

Gjatë kontrollit në këto 6 stacione policore, në pjesët e hapësirave për ndalim, si dhe në hapësirat e tjera zyrtare, MPN-ja nuk hasi në sende të dyshimta me të cilat mund që të ushtrohet presioni, dhunë fizike ose frikë mbi personat e privuar nga liria.

Nyjat sanitare

MPN në vitin 2013 zbatoi kontroll të rregullt në 5 stacione policore me kompetenca të përgjithshme me hapësira të vjetra për ndalim dhe vetëm në një stacion policor me hapësira të reja për ndalim. Në këtë drejtim konstatoi se kushtet e nyjave sanitare dallojnë, përkatësisht në stacionet policore ku vendet për ndalim janë të reja, në përbërje të pjesës së rinovuar ka edhe tualete të veçanta të cilët shfrytëzohen vetëm nga ana e personave të ndaluar (SP Shtip). Vlerësim i përgjithshëm për nyjat sanitare është se të njëjtat janë të reja, të ndërtuara në kuadër të projektit për renovimin e vendeve për ndalimin e personave, higjiena mbahet me rregull dhe është në nivelin e kënaqshëm.

Si shembull pozitiv MPN e potencon veprimin e SP Shtip i cili në pajtim me rekomandimet e MPN-së, në përputhje me rekomandimet e potencuara në raportin vjetor të vitit 2011, i ka larguar gjërat të cilat paraqesin rrezik në tualet, gjegjësisht është hequr pasqyra prej qelqi, si dhe mbajtëset e metalta të cilat mund të shpien deri te

rreziku eventual i lëndimit apo vetëlëndimit të personit të ndaluar, si dhe lëndimit të personave zyrtarë. MPN-ja e përshëndeti këtë akt të bërë nga ana e SP Shtip për arsye se rekomandimet në raportin vjetor ishin të dedikura në përgjithësi, e jo konkretisht për këtë stacion policor dhe e potencoi nevojën e bashkëpunimit të këtij lloji edhe në të ardhmen.

Në pjesën më të madhe të stacioneve policore me kompetenca të përgjithshme ku vendet për ndalim nuk janë rinovuar, u konstatua se nuk ka tualete të veçanta për personat e privuar nga liria, gjegjësisht tualetet e njëjta shfrytëzohen edhe për personat e ndaluar dhe për personat zyrtarë të punësuar në stacionet policore. Në SP Manastir edhe pse hapësirat për ndalim nuk janë rinovuar ekziston tualet i posaçëm për personat e privuar nga liria por i njëjti duhet të rinovohet dhe të mirëmbahet me rregull.

MPN shprehu shqetësim për qasjen në tualetet në SP Ohër për arsye se hapësirat për ndalim janë të ndara dhe larg nga tualetit i cili gjendet në vet stacionin policor. Në mënyrë shtesë për arsye se në hapësirat nuk u vërejt sistemi për thirrje MPN-ja e parashtrroi pyetjen se si personat e ndaluar lajmërojnë për nevojën për të shkuar në tualet. Qasja deri te tualetet paraqet problem edhe në SP Kërçovë – njëherësh tualetet janë të locuara në pjesën përdhese të stacionit, përderisa hapësirat për ndalim janë në pjesën e bodrumit të stacionit policor, kurse duke e pasur parasysh se edhe në këtë stacion policor nuk kishte të instaluar interfon, as sistem tjetër për thirrje, parashtrohet pyetja se në çfarë mënyre personat e privuar nga liria i lajmërojnë personat zyrtarë për nevojën për tualet.

Hapësirat për bisedë dhe marrje në pyetje

Në lidhje me hapësirat në të cilat zhvillohen biseda me personat e arrestuar dhe të ndaluar, MPN-ja edhe këtë vit raportues konstatoi se ekziston dallim mes vendeve të reja për ndalim dhe hapësirave të vjetra të parenovuara për ndalim. Pjesa më e madhe e stacioneve policore nuk kanë hapësira të posaçme për biseda dhe marrje në pyetje të personit të arrestuar dhe të atij të ndaluar kështu që bisedat me ta zhvillohen varësisht nga parakushtet materialo-teknike të stacionit policor, si dhe varësisht nga sjellja edhe koordinimi e bashkëpunimi i ndërsjellë i nëpunësve të uniformuar policore me inspektorët të cilët zhvillojnë biseda me personat e privuar nga liria për të cilët ekziston dyshim i bazuar se kanë kryer veprë penale.

MPN-ja gjatë realizimit të vizitave gjatë vitit 2013 konstatoi se hapësirë të posaçme për biseda dhe marrje në pyetje nuk ka stacionet policore: SP Kërçovë, SP Ohër, SP Manastir, SP Strumicë dhe SP Veles. Në këto stacione policore pikë së pari personi i privuar nga liria udhëzohet/mësohet për të drejtat e veta në zyrën e pranimit, gjegjësisht në zyrën e udhëheqësit të turnit, kurse më pas nëse bëhet fjalë për veprim me elemente të veprës penale, bisedën në lidhje me veprën e zhvillon inspektori kompetent në zyrën e tij zyrtare.

Konform Metodologjisë së përcaktuar të punës, MPN sipas zgjidhjes së rastësishme bëri kontroll të zyrave zyrtare të inspektorëve ku zhvillohen bisedat me personat e arrestuar dhe personat e ndaluar, me çka në asnjërën hapësirë nuk janë vërejtur mjete të dyshimta me të cilat mund të ushtrohet presion, të shkaktohet frikë ose dhunë fizike mbi personat e privuar nga liria.

Në Stacioni policor Shtip, ku ka vende të reja të rinovuara për ndalim, ekziston hapësirë e veçantë për bisedë dhe marrje në pyetje. Njëherësh, në këtë stacion policor në pjesën e hapësirave për ndalim ekzistojnë dy hapësira të veçanta, nga të cilat njëra

shfrytëzohet si hapësirë për pranimin e personave të arrestuar dhe personave të ndaluar dhe hapësirë për biseda dhe marrje në pyetje me inspektorët policorë, përderisa hapësira e dytë shfrytëzohet si hapësirë e udhëheqësit të turnit. Në zyrën e njëjtë u vërejtën masa mbrojtëse të cilat ky stacion i ka ndërmarrë, gjegjësisht karriget dhe tavolinat ishin të fiksuara për dyshe dhe të njëjtat nuk mund të keqpërdoren në drejtim të lëndimit ose vetëlëndimit.

Magazina për sendet e sekuestruara përkohësisht

Gjatë vizitave të bëra të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme në vitin 2013, MPN bëri kontroll edhe në magazinat për sendet dhe armët e sekuestruara përkohësisht. Në pjesën e sendeve dhe armëve të sekuestruara përkohësisht, MPN konsideron se të njëjtat ruhen në vend adekuat pothuajse në shumicën e stacioneve të vizituara policore (SP Ohër, SP Manastir dhe SP Strumicë).

Në SP Manastir dhe SP Strumicë magazinat janë të siguruar në mënyrë adekuate dhe fizikisht të ndara nga hapësirat e tjera të punës, sendet e sekuestruara ruhen të kyçura me çelës, ndërsa dera dhe dritaret janë të mbyllura me grila prej hekuri. Gjatë kontrollit të magazinave në këto stacione policore MPN konstatoi se të gjitha sendet e sekuestruara ishin shënuar me numra (me çka zvogëlohet rreziku për keqpërdorimin e tyre), kurse qasje deri në magazinat ka vetëm një person i cili është i autorizuar për sendet e sekuestruar përkohësisht. Si shembull pozitiv, duhet të potencohet SP Manastir, i cili udhëheqë edhe libër intern për evidentimin e personave të ndaluar dhe sendet e sekuestruara. Në SP Veles, edhe pse magazina për sendet e sekuestruara përkohësisht ruhet nën çelës dhe qasje në atë vend ka vetëm një nëpunës i autorizuar policor, e njëjta shfrytëzohet për shumë qëllime, e jo vetëm për sendet e sekuestruara. Gjatë kontrollit magazinës u konstata se sendet ishin shënuar me rregull.

2.1.3 Realizimi i të drejtave të personave të ndaluar

Informimi dhe udhëzimi për të drejtat

Udhëheqësi i turnit (nëpunësi policor për pranim), në pajtim me Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve policore dhe Procedurat Standarde Operative për ndalimin dhe trajtimin e personave të ndaluar është kompetent për pranimin e personit, për udhëzimin dhe realizimin e të drejtave të tij, si dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme derisa personi është i ndaluar me qëllim për ta siguruar sigurinë e tij në stacionin policor.

Pas realizimit të 6 vizitave të rregullta gjatë vitit 2013, MPN-ja edhe këtë vit konstatoi se lidhja e rolit të udhëheqësit të turnit me rolin e nëpunësit policor për pranim është i pandryshueshëm edhe përkundër rekomandimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga ana e MPN –së, në drejtim të sigurimit të rolit të vërtetë të personit zyrtar për pranim dhe mbikëqyrje mbi personat e ndaluar. MPN –ja, sërish vuri në pah nevojën e ndarjes së këtyre dy funksioneve, edhe atë në drejtim të sigurimit dhe realizimit me kohë të të drejtave të personit të ndaluar.

Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se udhëheqësit e turnit i informojnë personat e privuar nga liria për të drejtat e tyre gjatë kohës së arrestimit në stacionin policor. Informatat për të drejtat janë të vendosur në vende të dukshme në gjitha sta-

cionet e vizituara policore me kompetenca të përgjithshme për shkak të informimit të plotë të qytetarëve nëse të njëjtit janë thirrur, arrestuar ose janë ndaluar në stacion policor.

Në numrin më të madh të stacioneve të vizituara policore informatat për të drejtat e personave të ndaluar ishin vendosur në vende përkatëse në vetë hyrjen e stacionit policor, kurse në numrin më të vogël të stacioneve të njëjtat ishin vendosur në hapësirën për praninë (në hapësirën e punës së udhëheqësit të turnit), në zyrën për biseda me personat e ndaluar (në stacionin policor me kompetenca të përgjithshme ku hapësirat për ndalim janë të rinovuara), si dhe në pjesën e vetë hapësirave për ndalim. MPN kosdieron mendon se informatat për të drejtat duhet të potencohen në ato hapësira ku zhvillohet biseda me personat e privuar nga liria, përkatësisht në vendet ku udhëzohen për të drejtat e tyre si dhe në hapësirat ku mbahen. Në këtë mënyrë, personave të ndaluar do t`u sigurohet këqyrje e vazhdueshme dhe e pandërprerë në listën e të drejtave të cilat u takojnë gjatë kohës së procedurës policore.

Si shembull pozitiv duhet të theksohet SP Shtip, i cili në përputhshmëri me rekomandimet e MPN të dhëna në raportin vjetor për vitin 2011, në vend adekuat dhe të dukshëm e kishte vendosur listën me të drejtat e personave të ndaluar në pjesën e vendeve për ndalim, përkatësisht të njëjtën e kishte vendosur në anën e brendshme të dyerve të hapësirave për ndalim.

Kodeksi i etikës policore është vendosur në hapësirat e përbashkëta në të gjitha stacionet e vizituara policore dhe është i arritshëm dhe i dukshëm për të gjithë nëpunësit e uniformuar policorë.

E drejta e ushqimit dhe ujit

Duke u nisur nga standardet ndërkombëtare për personat e privuar nga liria, me të cilat garantohet e drejta e ushqimit dhe ujit, u potencua se në 4 stacione policore me kompetenca të përgjithshme ka buxhet të veçantë për ushqimin e personave të ndaluar (SP Shtip, SP Manastir, SP Strumicë dhe SP Veles), përderisa SP Ohër dhe SP Kërçovë nuk disponojnë me buxhet të posaçëm për sigurimin e ushqimit për personat e ndaluar. Në stacionin policor Ohër, nga ana e personit të ndaluar u pohua se këtë të drejtë e kishte të realizuar, përkatësisht gjatë kohës së ndalimit, me kërkesë të tij, i ka siguruar ushqimi nga mjetet të cilat i ka pasur në disponim.

Në pajtim me procedurat sipas të cilave veprojnë stacionet policore, ushqimi sigurohet nga mjetet personale të personit të ndaluar, nga mjetet e familjes së tij ose nga buxheti i Ministrisë për Punë të Brendshme me bashkëngjitjen e llogarisë fiskale.

Në stacionin policor Manastir MPN-ja u informua se personave, të cilët ndalohen në këtë SP çdoherë u sigurohet ushqim dhe për këtë përgatitet shënim i posaçëm zyrtar, mirëpo në dy dosje të kontrolluara për persona të ndaluar më shumë se 10 orë nuk kishte kurrfarë dokumenti që do të vërtetohej se personi i njëjtë ka fituar ushqim adekuat, derisa ka qenë i ndaluar në SP Manastir.

MPN konsideron se çdo stacion policor me kompetencë të përgjithshme duhet të disponojë me buxhet të vet, i cili do të jetë vetëm për personat e ndaluar dhe çdo SP duhet të mbajë shënime të veçanta zyrtare për realizimin e të drejtës së ushqimit, si dhe ta bashkëngjisë llogarinë fiskale me të cilën do të vërtetohet realizimi i të drejtës së ushqimit gjatë periudhës së ndalimit.

E drejta e mbrojtësit dhe njoftimi i familjes

MPN nga të gjitha vizitat e rregullta të realizuara nëpër stacionet policore, konstatoi se personat e ndaluar çdoherë në mënyrë adekuate udhëzohen për të drejtat e tyre. Personat të cilët mbahen në stacionin policor, shumë rrallë e realizojnë të drejtën e mbrojtësit, gjegjësisht një numër i vogël thërrasin mbrojtës. Në shumicën e stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme ekzistojnë lista me emra të mbrojtësve (avokatëve), mirëpo në pajtim me informatat e udhëheqësve të turnit edhe kur në rastet e rralla personi kërkon praninë e avokatit, më së shpeshti kërkon që përzgjedhjen e mbrojtësit ta bëjë vetë. Në SP Ohër, në bisedë me personin e ndaluar MPN-ja mori informatë se nuk i është lejuar të thërras avokat.

Personi i ndaluar në stacionin policor udhëzohet për të drejtën e tij, si dhe për t'i informuar anëtarët e familjes së tij. Nga kontrolli i bërë në më shumë evidenca të stacioneve policore, MPN-ja konstatoi se për dallim nga e drejta e mbrojtësit, personat e ndaluar më shpesh e shfrytëzojnë të drejtën për të informuar anëtarë të familjes me çka më së shpeshti e informojnë partnerin bashkëshortor ose prindin.

Për personat e ndaluar të moshës së mitur ekziston obligimi në pajtim me Ligjin për të drejtat e fëmijëve që biseda me fëmijën detyrimisht të bëhet në praninë e mbrojtësit, prindit ose përfaqësuesit ligjor të tij. Konform rregullave ligjore, gjatë kohës së ndalimit nuk mund të zhvillohet biseda pa praninë e mbrojtësit. Nga vizitat e realizuara në vitin 2013, është konstatuar se nëpunësit policorë çdoherë i lajmërojnë prindërit mirëpo, jo çdoherë mund të sigurojnë praninë e mbrojtësit. Në pjesën më të madhe të rasteve në SP Kërçovë avokatët nuk vijnë dhe nuk e zbatojnë obligimin që del nga Ligji për të drejtat e fëmijëve. SP Veles i informon prindërit për obligimin e thirrjes së mbrojtësit, por të njëjtit shpesh herë refuzojnë, dhe në atë drejtim biseda zhvillohet pa praninë e mbrojtësit.

E drejta për mjek

Fillimisht, gjatë pranimit të personit të privuar nga liria udhëheqësi i turnit e ka për detyrë që ta konstatojë gjendjen shëndetësore të personit dhe të njëjtën ta evidentojë në procesverbalin për ndalim mbajtje. Në procesverbalin për ndalim ka rubrika të veçanta, në të cilat udhëheqësi i turnit i evidenton lëndimet e dukshme, shenjat e dukshme të sëmundjes, alkoolizmin dhe veprimin e substancave psikotropike dhe në mënyrë adekuate e vërteton nevojën për ndihmë mjekësore. Realizimi i të drejtës së mjekut në numrin më të madh të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme bëhet nëse personi vetë kërkon që të thirret mjeku apo nëse udhëheqësi i turnit vëren lëndime të dukshme, shenja të dukshme të sëmundjes ose kur personi është nën veprimin e alkoolit ose të substancave tjera psikotropike.

MPN konstatoi se në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore thirret mjeku. Gjatë kontrollit të dokumentacionit për personat e ndaluar, në pjesën më të madhe të stacioneve policore, u konstatua se e drejta e mjekut në mënyrë adekuate dhe me kohë realizohet. Njëherit, në SP Manastir nga kontrolli i bërë në evidencat është konstatuar se në procesverbalin për ndalimin e personit është konstatuar nevoja për mjek për shkak të lëndimit të dukshëm dhe gjendjes së alkoolizuar. Nga ana e stacionit policor është thirrur ndihma e shpejtë për dhënien e ndihmës mjekësore, kurse në lidhje me lëndën kishte edhe shënim zyrtar për thirrjen dhe dhënien e ndihmës mjekësore.

³ Neni 116 paragrafi 9 nga Ligji për të drejtat e fëmijëve (Gazeta zyrtare e RM, nr.148 nga 29.10.2013)

Në SP Kërçovë, gjatë bisedës me udhëheqësin e turnit, MPN u informua se ky stacion policor nuk ka praktikë që në mënyrë preventive të thirrë mjek, kur personi është nën ndikimin e alkoolit. Mirëpo, gjatë kontrollit në një dosje individuale për person të ndaluar është konstatuar se për person që ka qenë nën ndikimin e alkoolit (2,85%) është informuar mjeku dhe në mënyrë preventive ka marrë masa me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga lëndimet ose vetëlëndimet e personit të privuar nga liria. Por në një dosar tjetër të kontrolluar është konstatuar se për person nën ndikimin e alkoolit (2,70%) nuk është informuar mjeku me çka nuk janë ndërmarrë masa preventive për personat me shkallë të lartë të alkoolit.

MPN-ja çdoherë ua sugjeron stacioneve policore që detyrimisht të thërrasin mjek në rastet me nivel të lartë të alkoolit të personit të ndaluar, pa dallim se personi a kërkon ndihmë mjekësore apo jo, me qëllim të veprimit preventiv në drejtim të mbrojtjes me kohë të shëndetit të personit të privuar nga liria.

SP Strumicë mund të potencohet si shembull pozitiv në pjesën e ekzistimit të shënimeve të veçanta zyrtare për ndihmë mjekësore. Njëherit, në një dosje të kontrolluar, ku personi kishte shenja të dukshme të sëmundjes si dhe mundësia që të ishte nën veprimin e mjeteve narkotike është thirrur mjek, si dhe është lajmëruar prindi i personit të ndaluar. Në tjetër rast ku ka pasur nevojë për mjek i njëjti është thirrur, ndërsa nëpunësi policor ka përgatitur shënim zyrtarë për kontrollin e bërë të personit nga ana e mjekut.

Në stacionin policor Ohër janë vërejtur lëshime në pjesën e udhëheqjes së evidencave. Njëherit, në Regjistrin për personat të cilëve pa marrë parasysh se me çfarë baze iu është kufizuar e drejta e lëvizjes është vërejtur se një person i ndaluar është dërguar me veturë të ambulancës në Spitalin Psikiatrik në Demir Hisar, kurse gjatë kontrollit të dosjes individuale e njëjta nuk ishte regjistruar në procesverbalin për mbajtje, por as nuk ishte potencuar se personi tregonte shenja të çrregullimit mendor. Së këtejmi, MPN e shprehi shqetësimin për mënyrën në të cilën plotësohen procesverbalet për mbajtje, gjegjësisht e theksoi nevojën për shënimin thelbësor dhe të tërësishëm të të dhënave në procesverbal.

Në stacionin e njëjtë policor, MPN-ja konstatoi se për një person që ka qenë në gjendje të alkoolizuar, nuk është thirrur në mënyrë preventive mjeku. Mirëpo, në tjetër rast, ku ka pasur edhe lëndime të dukshme mjeku ka qenë i thirrur dhe në dosjen e personit të ndaluar qëndronte edhe raporti i specialistit për diagnozën e konstatuar.

Në SP Shtip, gjatë kontrollit në dy dosarë është konstatuar se kur personi ka nevojë për mjek, si dhe kur personi ka gjendje të dukshme alkoolike thirret ndihma e shpejtë për shkak të dhënies së ndihmës së shpejtë, për çka në kuadër të dosjes ekziston edhe shënimi zyrtar adekuat për dhënien e ndihmës mjekësore.

Në SP Veles, në rast të nevojës për mjek, patjetër thirret ndihma e shpejtë, kurse nëpunësi policor çdoherë i regjistron lëndimet e dukshme të personave të cilët mbahen në SP Veles. MPN këtë e konstatoi edhe gjatë kontrollit të 8 dosjeve individuale në të cilat në 6 raste është thirrur mjek. Praktikë pozitive e SP Veles është thirrja e mjekut në rastet e përqindjes së madhe të alkoolit në gjak, që në mënyrë preventive mund t'i zvogëlojë rreziqet përderisa personi është i ndaluar në stacionin policor. Në një rast ku personi kishte 3,95% alkool, është thirrur mjeku i cili ka konstatuar se i njëjti mund të mbahet në stacionin policor dhe ky konstatim është shënuar në procesverbalin për mbajtje. Në rast tjetër, për person që ka pasur 2,50% alkool, ka dëshiruar që vetëlëndohet dhe për të cilin është regjistruar se ka pasur çrregullime mendore, ka qenë i thirrur mjeku. Nga gjithë dosarët e kontrolluar, MPN e vlerësoi si mjaftë pozitive mënyrën preventive të thirrjes së mjekut në rast të çrregullimit mendor ose alkoolizmit të lartë, i cili jep mendim ose vlerëson se personi mund të mbahet në stacion, duke pasur parasysh se vendet për ndalim gjenden në pjesën e bodrumit në të cilën nuk ka sistem për thirrje të ashtuquajtur alarm në raste të nevojave urgjente.

2.1.4 Evidentimi dhe regjistrat për personat e ndaluar

Në të gjitha stacionet e vizituara policore MPN realizoi kontroll në Regjistrin për ngjarje të ditës në lidhje me kryerjen e punëve policore, Regjistrin e personave për të cilët mbi çfarë do lloj baze u është kufizuar liria e lëvizjes (regjistri për personat e thirrur, të arrestuar dhe të ndaluar), Regjistrin për parashtrësat e parashtruara nga ana e qytetarëve kundër nëpunësve policor si dhe masat e ndërmarra, Regjistrin për përdorimin e mjeteve të detyrimit dhe disa dosarë individual për personat e ndaluar. Nga kontrolli i bërë është konstatuar se në numrin më të madh të stacioneve policore Regjistri për ngjarjet e ditës dhe Regjistri për personat të cilëve mbi çfarë do lloj baze u është kufizuar liria e lëvizjes (regjistri për personat e thirrur, të arrestuar dhe të ndaluar) udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe plotësohen të gjitha rubrikat.

Njëherit, gjatë kontrollit të regjistrave, MPN konstatoi se në të gjitha stacionet policore me kompetenca të përgjithshme, informatat nga Regjistri për ngjarjet e ditës, korrespondojnë ose përputhen me të dhënat në Regjistrin për personat të cilëve mbi çfarëdo lloj baze iu është kufizuar e drejta e lëvizjes. Gjatë kontrollit në Regjistrin për shfrytëzimin e mjeteve për detyrim dhe Regjistrin për parashtrësat e qytetarëve kundër nëpunësve policor dhe masave të ndërmarra nga ana e tyre, në numrin më të madh të stacioneve të vizituara policore, MPN konstatoi se ato regjistra udhëhiqen dhe plotësohen në mënyrë korrekte. MPN nga kontrolli i bërë në dy lëndë për shfrytëzimin e mjeteve për detyrim (SP Kërçovë dhe SP Manastir) konstatoi se në mënyrë përkatëse është përgatitur vlerësimi për arsyetimin e mjeteve për detyrim si dhe raporti për përdorimin e mjeteve për detyrim nga ana e personit zyrtar.

Në të gjitha stacionet policore të vizituara rregullisht ishte vërejtur se nuk udhëhiqej rikapitulimi ose përmbledhja mujore për numrin e të thirrurve, të arrestuarve ose të personave të ndaluar siç është paraparë me Procedurat Standarde Operative për ndalim dhe procedurë me personat e ndaluar. MPN, në këtë drejtim, sugjeroi se në Procedurat Standarde Operative për ndalim dhe procedurë me personat e ndaluar të Ministrisë për Punë të Brendshme, në pjesën e evidentimit të personave të ndaluar, është theksuar se në Regjistrin për persona të cilëve mbi çfarë do lloj baze iu është kufizuar liria bëhet rikapitulimi mujor me atë që në fund të muajit tërhiqet vijë e kuqe dhe shënohet numri i të arrestuarve, të thirrurve, si dhe personave të ndaluar në stacionin policor.

Nga kontrolli i bërë në dosarë të veçantë për ndalimin e personave, MPN konstatoi se të njëjtët në numrin më të madh të stacioneve policore me kompetenca të përgjithshme udhëhiqen në mënyrë të rregullt, me korrektësi është plotësuar faqja e dytë dhe e tretë e dosarit, me çka fitohet pasqyrë e qartë për dokumentacionin që është në përbërje të dosarit. Njëherit në kuadër të të njëjtëve, përveç procesverbalit për ndalim janë të parashtruara edhe numër më i madh i dokumenteve tjera të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen e personit dhe realizimin e të drejtave të tij në procedurë policore.

Në SP Strumicë gjatë kontrollit në dosjet individuale, MPN konstatoi se përveç procesverbalit të detyrueshëm për ndalim në pjesë tjera të dosarëve qëndronin edhe procesverbale tjerë, me qëllim të realizimit të të drejtave, siç është procesverbali për mbrojtës, vërtetimi për sende të sekuestruara, procesverbali për pranim-dorëzimin e personit të dënuar, kurse në lëndë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për procedurë penale qëndronte edhe Vendimi për ndalim (në pajtim me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 të Ligjit për procedure penale, Gazeta Zyrtare 150/2010).

MPN, në numrin më të madh të stacioneve të vizituara policore, nuk arriti ta vërtetojë rrjedhën logjike të ngjarjeve që nga momenti i privimit nga liria deri te mbajtja në stacionin policor (që mund të sjell deri te dyshimi në lidhje me përcaktimin e kohës së privimit nga liria në mënyrë të rregullt), gjegjësisht e njëjta kohë evidentohet

edhe për arrestimin si dhe për ndalimin. Këto palogjikshmëri mund të jenë problem shtesë tek ndalimi i personave me afat më të gjatë kohor nga aspekti i respektimit të maksimumit të parashikuar kohor të privimit prej 24 orëve për personat e moshës madhore ose 12 orë për personat e moshës së mitur.

Pa logjikshmëri u konstatuan në SP Manastir, SP Veles, SP Ohër dhe SP Kërçovë, përderisa në SP Shtip dhe SP Strumicë, në numrin më të madh të dosarëve të kontrolluar mund të konstatohet se ka rrjedhë logjike të ngjarjeve nga momenti i privimit, deri te ndërprerja e ndalimit në stacionin policor. Në SP Strumicë në të gjitha dosjet për personat e ndaluar në procesverbalin për ndalim kishte rrjedhë logjike të ngjarjeve, përkatësisht ishte e potencuar në veçanti koha e privimit nga liria, ndalimi dhe udhëzimi për të drejtat që jep pasqyrë të qartë se prej kur ka filluar privimi nga liria dhe prej kur fillon afati prej 24 orëve i cili është maksimumi ligjor i privimit në stacionin policor.

Në drejtim të preventimit nga lëndimet dhe vetëlëndimet e mundshme, si dhe zvogëlimin e rreziqeve nga tortura dhe lloje tjetra të trajtimit johuman ishte konstatuar se disa stacione policore me kompetenca të përgjithshme me vetiniciativë kanë futur edhe dokumentacion shtesë, gjë që mund të theksohet si shembull pozitiv. SP Manastir udhëhiqet shënim zyrtar për sigurimin e ushqimit, si dhe raport me shkrim për thirrjen e mjekut dhe masat e ndërmarra nga ana e mjekut, gjest që paraqet praktikë të mirë dhe i njëjti duhet që të merret si shembull dhe të shfrytëzohet edhe nga stacionet tjera policore. Shënim zyrtar për dhënien e ndihmës mjekësore udhëhiqet edhe në SP Strumicë, SP Kërçovë, SP Ohër, dhe SP Shtip. Në SP Veles përveç procesverbalit për ndalim përgatitet shënim zyrtar për dhënien e ndihmës mjekësore, shënim zyrtar për refuzimin e nënshkrimit të procesverbalit, si dhe listë kontrolluese për mbikëqyrje mbi personat e ndaluar.

Numri më i madh i stacioneve të vizituara policore janë me hapësira të vjetra për ndalim të cilat gjenden në pjesën e bodrumit dhe në të njëjtat nuk ka të instaluar video mbikëqyrje, kurse te disa nuk funksiononte edhe interfoni për thirrje. Në ato stacione policore me kompetencë të përgjithshme udhëhiqet listë kontrolluese për mbikëqyrjen e personave të ndaluar në të cilën shënohen orët se kur është zbatuar mbikëqyrja mbi personin e ndaluar. Listë kontrolluese për kontrollin e kryer mbi personin e ndaluar udhëhiqet në SP Manastir, SP Strumicë, SP Veles, dhe SP Shtip. Në SP Shtip (SP me hapësira të reja për ndalim) MPN konstatoi se mbikëqyrja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë mbi personin e ndaluar realizohet në njërën prej hapësirave ku nuk funksionon interfoni për thirrje. Në dosarët individual qëndronte edhe lista e kontrollit të bërë mbi personin e ndaluar.

Vlerësim i përgjithshëm i MPN është se stacionet policore në mënyrë të rregullt e udhëheqin evidencat, në mënyrë të rregullt dhe azhure i plotësojnë regjistrat dhe dosjet individuale për personat e ndaluar. Në dosjet përveç procesverbalit për ndalim është bashkëngjitur edhe një numër më i madh i dokumenteve tjera të cilat kanë të bëjnë me ndalimin. Janë vërejtur lëshime të caktuara në pjesën e plotësimi të procesverbaleve, kështu që në një stacion policor me kompetenca të përgjithshme në një procesverbal nuk ishte regjistruar koha kur ka filluar ndalimi në stacionin policor, si dhe cili nëpunës policor ka e zhvilluar bisedën me personin e privuar nga liria.

2.1.5 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Ministria për Punë të Brendshme dhe stacionet policore me kompetencë të përgjithshme nëpërmjet të përgjigjeve të dorëzuara i pranuan vërejtjet dhe udhëzimet e dhëna, si dhe rekomandimet e dhëna, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave të privuar nga liria. Në këtë drejtim MPN u informua se është në rrjedhë përpunimi i Procedurës së re të standarde operative për trajtimin e personave të cilëve iu është kufizuar e drejta e lëvizjes së lirë, në të cilën do të përshihen autorizimet policore siç janë, arrestimi, privimi nga liria dhe ndalimi i personave. Njëherit në këto procedura në mënyrë detajore do të përpunohet edhe trajtimi me personat e moshës së mitur, përkatësisht fëmijët si dhe thirrja e mbrojtësit në pajtim me normat pozitive ligjore. Gjithashtu, Ministria për Punë të Brendshme u përgjig se do t'i merr parasysh rekomandimet e MPN, të cilat kanë të bëjnë me standardet e hapësirave për mbajtje gjatë periudhës kur do të fillohet kah rekonstruimi dhe renovimi i stacioneve policore, në përputhje me planin e paraparë aksionar.

Njëkohësisht, Ministria për Punë të Brendshme informoi se për hapësirat e ndalimit në SP Veles për të cilat është konstatuar se nuk i plotësojnë standardet e dëshiruara ndërkombëtare, është bërë projekt propozimi dhe me ndihmën e Këshillit të Europës do të fillohet me ndërtimin e hapësirave të reja të cilat do t'i përmbushin standardet e parapara.

Mekanizmi Parandalues Nacional nga stacionet policore u informua se është vepruar sipas rekomandimeve të dhëna, pra në atë drejtim të drejtat e qytetarëve janë vendosur në mënyrë të rregullt në hapësirat e udhëheqësit të turnit, si dhe në pjesët e hapësirave për ndalim. Në një pjesë të stacioneve policore ku ishte vërtetuar palogjikshmëria në evidentimin gjatë shënimit të kohës së privimit nga liria dhe kohës së ndalimit të personit, MPN mori përgjigje se është vepruar sipas rekomandimeve të dhëna, përkatësisht rekomandimi është pranuar dhe në të ardhmen në evidencë do të shënohet rrjedha logjike që nga momenti i parë i privimit nga liria.

Në SP Gjevgjeli janë larguar sendet e rrezikshme nga tualeti për personat e ndaluar, dhe njëkohësisht ndërmerren edhe aktivitete për rregullimin e dy hapësirave të cilat do të shfrytëzohen për fëmijë, në pajtim me rregullativën ligjore delikuentin e të miturve. Në drejtim të ndërtimit të platformës qasëse në hyrjen e SP Gjevgjeli është dhënë përgjigje se është e nevojshme që të gjendet një zgjidhje teknike me çka do të tejkalohet ky problem.

Në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme me hapësira të vjetra dhe bodrume në të cilat nuk kishte të instaluar sistem të thirrjes (SP Kërçovë dhe SP Ohër) ishte pranuar rekomandimi që të instalohet, gjegjësisht të vendoset një sistem i llojit të tillë (interfon ose zile), e deri te ndërtimi i hapësirave të reja për mbajtje. MPN u informua se do të vazhdohet edhe më tutje me praktikën pozitive të kontrolleve të rregullta mbi personat e ndaluar, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria, përderisa për realizimin e të drejtës së ushqimit në të ardhmen do të përgatitet shënim zyrtar.

Në SP Strumicë ka filluar procedura për furnizimin me dyshekë dhe batanije adekuat. Gjithashtu, është siguruar edhe më shumë dritë natyrore në hapësirat për ndalim me zmadhimin e hapjeve të rrethimit prej llamarine. Në SP Kërçovë për shkak të mosplotësimit të standardeve për ndalim dhe deri në ndërtimin e hapësirave të reja është vendosur që ndalimi të bëhet vetëm në situata të jashtëzakonshme edhe atë me ndalime afatshkurtra për disa orë.

Stacionet policore i pranuan rekomandimet për thirrjen preventive të mjekut në rast të nivelit të lartë të alkoolizmit, pa marrë parasysh se a kanë kërkuar personat ndihmë mjekësore apo jo (SP Ohër, SP Kërçovë dhe SP Shtip). Njëkohësisht ishte

vepruar sipas rekomandimit për udhëheqjen e përmbledhjes mujore që është obligim, në përputhshmëri me Procedurat Standarde Operative për trajtimin e personave të privuar nga liria.

2.2 INSTITUCIONET NDËSHKUESE – KORREKTUESE

Gjatë vitit 2013 Avokati i Popullit -Mekanizëm Parandalues Nacional realizoi dy vizita të rregullta në institucionet ndëshkuese-korrektuese, më saktë në Repartin e Arrestit pranë Entit Ndëshkues-Korrektues "Idrizovë" dhe në Repartin e Hapur të Kriva Pallankës në kuadër të Burgut të Kumanovës.

2.2.1 Reparti i Arrestit pranë Entit Ndëshkues-Korrektues "Idrizovë"

Vizita e rregullt në **Repartin e Arrestit** u realizua pa paralajmërim në shoqërimin e bashkëpunëtorit të jashtëm-psikiatrit nga Shoqata e Psikiatërve. Me kontrollin ishin të përfshira kapacitetet për vendosje dhe automjetet transportuese, kurse njëherësh MPN-ja bëri këqyrje edhe mbi fletoren e posaçme në të cilën evidentohen kontrollet e realizuara.

Nga kontrolli i bërë në Repartin e Arrestit, MPN-ja, konkludoi se kushtet materiale nuk i përbushin standardet, si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Reparti i Arrestit në të cilin qëndrojnë personat e dënuar të sëmurë ka gjashtë hapësira. Gjatë kontrollit ishte vërejtur lagështi nëpër korridoret, batanijet ishin të vjetra dhe nuk kishte çarçafë. Në këtë repart ekziston tualeti i cili është me higjienë relativisht të mirë. Krevatet ishin pa çarçafë, kurse ishin të vërejtur edhe dyshekë të papastër.

Meqenëse ishte vërejtur se një pjesë e dhomave ishin të pa rregulluara, si dhe pa shtrojën e duhur, ndërsa personat e vendosur të dënuar u ankuan edhe në sasinë e paktë të mjeteve higjienike me të cilat do ta mbanin higjienën, MPN e potencoi rolin e mjekut dhe në këtë kontekst theksoi se i njëjti duhet *„rregullisht të bëjë kontrolle dhe drejtorit t'i jep rekomandime në lidhje me: higjienën në ent dhe të burgosurve, tualeteve, ngrohjes, ndriçimit dhe ajrosjes së hapësirave, si dhe cilësisë dhe pastërtisë së veshjeve dhe çarçafëve të personave të dënuar.“*⁴

Personat e vendosur në Repartin e Arrestit nuk kishin ankesa për trajtimin ndaj tyre përderisa ata qëndronin në këtë repart. Të njëjtit u ankuan se mund të lëvizin vetëm brenda në korridor pa pasur të drejtë që jashtë të shëtisin. MPN konstatoi se të drejtat e personave të gjykuar janë të kufizuara, gjegjësisht personat nuk mund të realizojnë komunikim me botën e jashtme, për arsye se në këtë repart nuk ka kabinë telefoni.

Gjatë vizitës së Repartit të Arrestit, MPN bëri kontroll edhe në veturën me të cilën personat e gjykuar barten deri te Qendra Klinike. Automjeti transportues ishte i vjetër dhe i amortizuar, pa parakushtet e duhura për bartjen e personave të privuar nga liria, përkatësisht pa masa sigurie me qëllim të mbrojtjes sikurse të personave të privuar nga liria, gjithashtu edhe të të punësuarve në Sektorin për Siguri, të cilët e kryejnë transportin.

MPN e potencoi standardin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës (KPT) në lidhje me transportin e personave të gjykuar në institucion shëndetësor. Konform rekomandimeve, KPT konsideron se çdoherë kur është e nevojshme që personat e gjykuar të hospitalizohen ose të kontrollohen nga mjeku specialist në spital, duhet të barten menjëherë dhe në mënyrë që u përgjigjet gjendjes së tyre shëndetësore." Gjendja e automjeteve me të cilët barten personat e dënuar të sëmurë mund ta vë në pikëpyetje shëndetin dhe jetën e personave të dënuar dhe të njëjtat nuk janë të përshtatshme për bartjen e personave të sëmurë, duke e pasur parasysh se nuk kanë të instaluar ventilim, ngrohje, si dhe masa tjera të sigurimit-mbrojtjes për bartjen e

⁴ Rregullat minimale standarde për trajtimin e personave të burgosur, pika 26 Kombet e Bashkuara

personave të dënuar të cilët kanë nevojë për ndihmë mjekësore jashtë institucioni i burgut.

Për arsye se në Repartin e Arrestit nuk ka të punësuar personel të rregullt mjekësor, kurse mjeku është i angazhuar në bazë vullnetare, MPN-ja sugjeroi se personeli mjekësor duhet të sigurohet gjë që është edhe një nga rekomandimet e KPT. Në raportin e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës të vitit 2010, të publikuar në vitin 2012, është dhënë rekomandimi për punësimin e një infermiere, si dhe të sigurohet besueshmëri mjekësore gjatë kohës së kryerjes së kontrolleve.

2.2.2 Reparti i hapur Kriva Pallankë në kuadër të burgut të Kumanovës

Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë edhe në repartin e hapur Kriva Pallankë pranë Burgut Kumanovë. Gjatë realizimit të vizitës u bë kontrolli i kapaciteteve të vendosjes në pjesën e të dënuarve, u realizuan biseda të besueshme grupore me disa persona të dënuar sipas zgjedhjes personale, biseda me të punësuarit në repart, u bë kontroll edhe në hapësirat tjera të përbashkëta dhe ndihmëse, si dhe në hapësirën për shëtitje jashtë dhe sipas zgjedhjes personale u kontrolluan disa dosje profesionale dhe evidence tjera të cilat udhëhiqen në këtë ent.

Personat e dënuar me të cilët MPN zhvilloi bisedë nuk kishin ankesa për maltretime fizike ose trajtim dhe sjellje joçnjerëzore nga ana e Sektorit për Siguri dhe konsideron se i njëjti ka marrëdhënie korrekte ndaj tyre. MPN nuk konstatoi as ankesa për dhunë ndërmjet personave të dënuar. Personat u shprehën të kënaqur edhe nga cilësia e ushqimit, ata u ankan vetëm për sasinë e ushqimit të cilën e marrin për darkë. Si problem u potencua mbajtja e higjienës së rregullt të çarçafëve ose shtrojës si dhe të veshjeve personale. Edhe pse personat nga burgu marrin detergjent për larje, prapë se prapë lavatrici nuk ishte në funksion, dhe si rezultat i kësaj personat janë të detyruar që veshjet t'i lajnë vetë në dorë.

Gjithashtu, personat e dënuar vunë në dukje se nuk janë të njoftuar në tërësi me të drejtat e tyre, obligimet e tyre si dhe me komoditetet të cilat dalin nga Rregullorja për Rendin e Shtëpisë, kurse MPN-ja gjatë vizitës së bërë vërtetoi se i njëjti nuk ishte vënë në vend të dukshëm në Repart, me çka personat nuk kishin çdoherë dhe në kontinuitet qasje për këqyrje. Problem real është mospasja e profilit të punëtorit social, duke e pasur parasysh se në këtë repart dënimin me burg e vuajnë edhe personat e rrezikuar social.

Në pjesën e mbrojtjes shëndetësore, të gjithë të dënuarit u ankuan për qasjen deri te mjeku, duke e pasur parasysh se mjeku nuk është tërë kohën i punësuar në repart, me çka i njëjti rrallë here vjen për t'i vizituar ata. Si problem u potencua edhe buxheti i pamjaftueshëm për barna. Edhe pse mjeku u jep receta me medikamente të përshkruara, jo çdoherë të njëjtat porositen për shkak të mungesës së mjeteve në të holla. Në burg nuk ekziston hapësirë e veçantë për kontrolle mjekësore, kurse personat që dërgohen në izolim nuk vizitohen për çdo ditë nga ana e mjekut gjë që është obligim në pajtim me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve.

Për sa i përket kushteve materiale, MPN gjatë kontrollit të bërë konstatoi se dhomat në Repartin e Hapur janë në nivel të kënaqshëm higjienik dhe kanë dritë brenda ditës. Janë të vendosur dollapë të metaltë në korridorin kryesor në të cilët të dënuarit i ruajnë gjërat e tyre personale. Të gjithë personat në Repartin e Burgimit kanë krevat personal me dyshek. MPN-ja konstatoi edhe gjendje të caktuara negative, kështu që në Repartin e të Dënuarve ishte konstatuar mbipopullim të kapaciteteve, më saktë vendosja nëpër dhomat nuk ishte në pajtim me dispozitat e Ligjit për ekzekutimin

e sanksioneve⁵, si dhe nuk respektohej as sipërfaqja prej 4m² për person të dënuar konform rekomandimeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (KPT). Në hapësirat për vendosje ishte evident ekzistimi i sasisë së madhe të lagështisë. Inventari në hapësirat është relativisht i vjetër, ndërsa krevatet janë të metalta me dyshekë të vjetër dhe të amortizuara. Nyjet sanitare janë të përdunuara dhe të pa adaptuara sipas nevojave të personave të dënuar.

MPN konstatoi se me rregull udhëhiqet evidenca profesionale për personat e dënuar, si dhe librat për dënime disiplinore dhe shfrytëzim të mjeteve për detyrim. Gjatë kontrollit në një dosje profesionale të personit që ka mbajtur dënim disiplinor izolim, nga kontrolli mbi aktvendimin, MPN-ja konstatoi se në mënyrë adekuate është plotësuar procesverbali për marrjen në pyetje të akuzuarin, pastaj është marrë aktvendim për formimin e komisionit për dënime disiplinore, deklaratë nga personi i dënuar, kërkesë për ngritjen e procedurës disiplinore për lëndim të kryer disiplinor, kurse si shtesë kishte edhe diagnozën mjekësore dhe mendimin nga ana e mjekut konform nenit 179 paragrafi 4 të LES.

2.2.3 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Enti Ndëshkues-Korrektues "Idrizovë" në kuadër të të cilit gjendet Reparti i Arrestit e informoi MPN se do të vepronte sipas udhëzimeve të dhëna po ashtu do të ndërmer masa për përmirësimin e gjendjeve si dhe do të sigurojë çarçafë ose shtrojë gjithashtu edhe mjete për higjienë. Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve dërgoi përgjigje se është vepruar sipas rekomandimit të dhënë për sigurimin e automjetit adekuat për transport.

Në pjesën e sugjerimit për punësimin e rregullt të personelit mjekësor në Repartin e Arrestit, Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve e informoi MPN se vepruari sipas këtij rekomandimi ka të bëjë me miratimin e punësimeve të reja, të cilën e jep Ministria e Financave. Në këtë drejtim edhe Institucioni ndëshkues-korrektues (INK) vërtetoi se më shumë se një vit kërkon që të merr pëlqimin nga Ministria e financave për punësimin e rregullt të personelit mjekësor në repartin e Arrestit.

Enti Ndëshkues-Korrektues "Idrizovë" u pajtua që mjeku i angazhuar-vullnetar, rregullisht të kryejë kontrole dhe t'i jep rekomandime drejtorit në aspekt të: higjienës të Repartit të Arrestit, pajisjeve sanitare, ngrohjes, ndriçimit dhe ajrosjes së hapësirave, si dhe cilësisë dhe pastërtisë së veshjeve dhe çarçafëve të personave të dënuar.

Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve në lidhje me rekomandimin për zvogëlimin e mbipopullimit në Repartin e Hapur Kriva Pallankë, e informoi MPN se pas përfundimit të ndërtimit të Burgut Kumanovë i cili do të jetë me kapacitet prej 250 personave, do të vjen deri te zvogëlimi i mbipopullimit.

Drejtorja e Burgut në Kriva Pallankë në drejtim të njoftimit të tërësishëm të personave të dënuar me Rendin Shtëpiak ka përgatitur numër shtesë të kopjeve të cilat janë të kapshme për personat e dënuar. Në lidhje me rekomandimin e dhënë për vendosjen e sendukëve për kërkesa të kontrolleve mjekësore është vepruar ashtu siç është rekomanduar. Burgu nuk disponon me hapësirë e cila do të riadaptohej në një dhomë e posaçme për kontrole mjekësore. Njëkohësisht, ky institucion e informoi MPN se mjeku nuk mundet për çdo ditë t'i vizitojë personat e vendosur në izolim-qeli, për arsye se i njëjti nuk është i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune dhe vjen saktë në ditë të caktuara në pajtim me kontratën.

Edhe pse me pjesën më të madhe të konstatimeve të potencuara Drejtorja e burgut u pajtua, prapë se prapë u vu në pah se pjesa më e madhe për implementimin

⁵ Vendosja e me tepër se 5 persona te burgosur në dhomë që është në kundërshtim me nenin 104 paragrafi 3 nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve.

e rekomandimeve varet nga sigurimi shtesë i mjeteve financiare, me të cilat burgju për momentin nuk disponon.

2.3 INSTITUCIONET PSIKIATRIKE

2.3.1 Klinika për psikiatri

MPN gjatë vitit raportues realizoi vizitë të rregullt preventive të Klinikës për Psikiatri. Kjo vizitë u realizua në shoqërinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nga Shoqata e Psikiatërve. Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës bëri kontroll mbi kushtet materiale në institucionin publik shëndetësor, zhvilloi biseda me një pjesë të pacientëve, por njëherësh ishte konstatuar se personat i realizojnë të drejtat e garantuara me Ligjin për shëndet mental, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe akte tjera juridike.

Gjatë vizitës së klinikës, MPN gjatë bisedës me një pjesë të pacientëve nuk mori ankesa për torturë dhe trajtim mizor nga ana e personelit mjekësor. Pacientët ishin të kënaqur nga sjellja e të punësuarve mirëpo në disa raste u ankuan për sjellje jo korrekte të kuadrin të mesëm (teknikët mjekësor), gjegjësisht se të njëjtit ndaj tyre janë sjell në mënyrë nënçmuese dhe ofenduese.

Në Klinikën për Psikiatri zbatohet protokoll i veçantë me të cilin është përcaktuar politika dhe rregullat për ndërmarrjen e masave për kufizimin fizik (fiksime), kurse e njëjta është vënë në minimum me çka të punësuarit insistojnë që pacientët t'i qetësojnë përmes bisedës dhe bindjes. Gjatë vizitës ishte vërejtur se në Klinikë nuk ka hapësirë të veçantë për fiksime, por e njëjta bëhet në cilën do hapësirë ku krevatet kanë kënde të mprehura, nuk janë të fiksuara për dysheme dhe ekzistojnë rreziqe nga lëndimi ose vetëlëndimi.

MPN-ja konstatoi se pacientët nuk janë mjaft të informuar me rendin shtëpiak të klinikës. MPN konsideron se është e preferuar që Rendi Shtëpiak të vendoset në vend të dukshëm në pjesën e korridoreve, me çka pacientët në mënyrë adekuate do të informohen për të drejtat e tyre në lidhje me vendosjen dhe kurimin në këtë institucion.

MPN-ja gjatë kontrollit të Rendit Shtëpiak konstatoi se kufizohet vullnetshmëria e të shëruarit, si dhe e drejta e besueshmërisë e cila është e rregulluar në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. Njëherësh, në të njëjtin theksohet se lëshimi i pacientëve bëhet detyrimisht me shoqërues, me çka MPN kërkoi nga klinika që të ndryshohet kjo pjesë në drejtim të respektimit në tërësi të të drejtave të pacientëve dhe vullnetit të lirë gjatë mjekimit të tyre.

Në formularin për dhënien vullnetar të pëlqimit për mjekim qëndron se pacienti pranon dhe pajtohet "ta lëshojë spitalin në bazë vullnetare vetëm atëherë pasi ta njoftojë dhe ta marrë pëlqimin mjeku i tij." MPN mendon se pëlqimi për mjekim vullnetar duhet të harmonizohet me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, i cili parasheh procedure për lëshim nga institucioni shëndetësor në bazë vullnetare pa paralajmërim.

MPN-ja bëri kontroll në hapësirat për vendosje në të gjitha repartet dhe konstatoi se kapacitetet e vendosjes në thelb i plotësojnë standardet e dëshiruara dhe janë të rregulluara në mënyrë adekuate për vendosjen e kësaj kategorie të personave. Njëherësh, ishte vërtetuar se higjiena në hapësirat mbahet me rregull dhe me korrektësi, kurse muret ishin të ngjyrosura me ngjyra pastel të cilat ndikonin pozitivisht në stimulimin vizual të pacientëve të vendosur.

Në të njëjtat hapësira ka depërtim të mjaftueshëm të dritës diellore, dhe në çdo dhomë ishin vërejtur trupa ngrohës dhe sirtarë të posaçëm të metaltë. Në të gjitha hapësirat shtretërit ishin të shtruar me çarçafë të pastër dhe mirë të rregulluar si dhe me dyshekë të ri. Pozitive është se pacientët e gjinive të kundërta në Klinikë vendosen në hapësira të ndara, me çka ishte vërtetuar se për secilin pacient kishte krevat të veçantë. Enti, në secilin repart disponon me hapësirë të veçantë për qëndrim ditor e cila rregullisht mirëmbahet dhe e njëjta pozitivisht ndikon në stimulimin e pacientëve të vendosur në klinikë.

MPN-ja nga kontrolli i bërë konstatoi se ekzistojnë kushte adekuate për servimin dhe shërbimin e ushqimit dhe numri më i madh i pacientëve ishin të kënaqur nga cilësia dhe sasia e vakteve të cilat i fitojnë. Për pacientët që vuanin nga diabeti (sëmundja e sheqerit), nga ana e klinikës u sigurohet ushqim i posaçëm dietor, kurse pacientëve u lejohet të marrin pajisje nga shtëpia.

2.3.2 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Drejtorja e Klinikës së Psikiatrisë e informoi MPN se do të zbatojë trajnim të vazhdueshëm dhe edukim të teknikëve mjekësor, me qëllim të vendosjes së raporteve korrekte dhe humane ndaj pacientëve. Njëkohësisht do të sigurohet hapësirë e veçantë për fiksime me krevate të përforcuara për dysheme, për shkak të zvogëlimit të rreziqeve nga lëndimet ose vetëlëndimet e pacientëve. Klinika, Rëndin Shtëpiak e ka vënë në vend të dukshëm nëpër reparte, dhe njëherësh i njëjti do të harmonizohet me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. Drejtorja e Klinikës pranoi që edhe Pëlqimin për mjekim vullnetar të harmonizohet me nenin 127 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.

Mekanizmi Parandalues Nacional nuk mori përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë në pjesën e rekomandimeve të cilat i dedikohen edukimit permanent, si dhe mbikëqyrjes mbi personelin mjekësor i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me pacientët. Me veprimin e këtillë, Ministria e Shëndetësisë nuk i respekton dispozitat e nenit 22 të Protokollit Fakultativ kundër torturës ku qëndron se "organet kompetente të shtetit i analizojnë rekomandimet e Mekanizmit Parandalues Nacional dhe hyjnë në dialog me të njëjtin për masat e mundshme për zbatim". Me sjelljen e tillë, dhe duke e pasur parasysh se nuk ka dorëzuar përgjigje as për vizitat e realizuara paraprakisht në spitalet psikiatrike në vitin 2012, Ministria e Shëndetësisë në mënyrë direkte e pengon punën e Avokatit të Popullit-Mekanizmit Parandalues Nacional.

2.4 INSTITUCIONET PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA

Në vitin raportues, MPN realizoi vizita të paparalajmëruara në institucionet publike për persona me nevoja të veçanta edhe atë në IP Entin për Mbrojtje dhe Rehabilitim Banja Bansko dhe IP Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve-Shkup. Këto vizita MPN-ja i realizoi në bashkëpunim me Lidhjen e Defektologëve të Republikës së Maqedonisë.

Edhe pse këto institucione nuk paraqesin vende klasike për privim nga liria, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional vendosi t'i vizittoj këto institucione në përputhje me kompetencat që dalin nga neni 4 dhe neni 20 i Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese.

Gjithashtu, në pajtim me nenin 11-a të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit siguron mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve, personave me nevoja të veçanta dhe personave të cilët janë objekt torture ose i ndonjë lloji tjetër të trajtimit ose ndëshkimit brutal, jonjerëzor, ose nënçmues, kurse në pajtim me nenin 31-a Avokati i Popullit për realizimin e aktiviteteve bën vizita të rregullta dhe të paparalajmëruara në organet, organizatat, si dhe institucionet në të cilat e drejta e lëvizjes është e kufizuar për çka edhe përgatitë raport të veçantë.

Vizitat në këto institucione realizohen në bashkëpunim të plotë me drejtoritë dhe të punësuarit, ndërsa Mekanizmi Parandalues Nacional kishte këqyrje të papengueshme në vendet e vendosjes, si dhe liri të plotë në zgjedhjen e personave me cilët zhvilloi biseda.

2.4.1 Instituti Publik Enti për Mbrojtje dhe Rehabilitim - Banja Bansko

Këtë institucion publik MPN-ja e vizitoi në shoqërimin e bashkëpunëtorit të jashtëm –defektologun. Në fillim ishte konstatuar se institucioni publik Enti për Mbrojtje dhe Rehabilitim -Banja Bansko është institucion i cili strehon, kujdes, edukon dhe rehabiliton persona me invaliditet trupor. Njëherësh, Enti Banja Bansko është institucion shtetëror dhe është nën kompetenca direkte dhe mbrojtje të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, e cila e financon pjesën më të madhe të shpenzimeve, kurse me pjesë më të vogël të financimit merr pjesë edhe Ministria e Arsimit. Enti është institut i hapur publik për personat me inteligjencë të ruajtur prej 6 e deri më 26 vite moshë. Mirëpo realisht në të njëjtin janë të vendosur edhe persona me pengesa intelektuale dhe me pengesa të kombinuara, kurse në raste të caktuara moshë e tyre është mbi 26 vite moshë.

Personat e vendosur vijnë nga të gjitha rajonet e Maqedonisë. Edhe pse Enti është institucion për persona me invaliditet trupor që para tre viteve pranohen edhe personat me pengesa ose paaftësi të kombinuar. Personat në Ent pranohen me vendim të Qendrës për Mbrojtje Sociale dhe miratim të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale.

Momentalisht katër personat, të cilët janë të vendosur në Ent, nuk kanë invaliditet trupor, përkatësisht kanë lloj tjetër të pengesave për të cilën institucioni nuk ka kushte, ndërsa të punësuarit nuk janë të aftësuar për të punuar me këtë kategori të personave. MPN-ja mori informatë se drejtori disa herë ka kërkuar zhvendosjen e tyre në institucione adekuate ose qendra adekuate, mirëpo deri më tani për atë veprim nuk është marrë ende miratim. përkatësisht, ishte takuar fëmijë shurdhërmec i cili për shkak të pengesës së tij, dhe për shkak të mosnjohjes së të folurit me shenja nga ana e personelit, mbahej i lidhur me litar për krevatin, dhe gjithashtu në Ent ishin vendosur edhe një fëmijë në rrezik social, një person me pengesa mendore, si dhe person me

çrregullime psikike, por pa invaliditet trupor. Në këtë drejtim MPN e informoi edhe Sekcionin për persona me nevoja të veçanta pranë Avokatit të Popullit duke konsideruar se vendosja joadekuat e kategorive të caktuara të personave të cilëve nuk mund t`u ofrohet kujdes adekuat dhe mbrojtje mund të çojë deri në trajtim johuman dhe nënçmues.

Shfrytëzuesit vunë në dukje sjelljen johumane ndaj disa të punësuarve gjatë transportit të tyre, për arsye se nuk është treguar kujdes i duhur për mënyrën e futjes së tyre në automjet, kurse ka pasur raste edhe kur është dashur që ta presin automjetin më gjatë se një orë në ambient të hapur. Nga ana e shfrytëzuesve në veçanti u manifestua shqetësim për ndërprerjen shtesave për mobilitet, për arsye se të njëjtit janë të varur nga transporti të cilin ua organizon enti.

Nga kontrolli i realizuar në hapësirat për trajtim fizikal ishte konstatuar se ekzistojnë kushte të mira zbatimin e terapisë. Kabinetet janë të pajisura me aparaturë moderne për terapi fizikale, realizohet kinezoterapija dhe terapia balneo. Numri më i madh i shfrytëzuesve shprehën kënaqësi në lidhje me kushtet e jetesës, ndërsa të kënaqur janë edhe me ushqimin të cilin ua japin në ent. Nga kontrolli i realizuar në kapacitetet e vendosjes MPN konstatoi se kushtet materiale dhe gjendjet në të gjitha repartet i plotësojnë minimum standardet e dëshiruara, të njëjtat janë bukur të rregulluara, të adaptuara për nevojat e tyre, njëherësh është vënë edhe platformë qasëse në hyrje të objekteve dhe ashensorë të brendshëm të cilët janë në gjendje të rregullt. Në të gjitha repartet më mënyrë përkatëse ishin instaluar trupa për ngrohje (ngrohje qendrore), me të cilat hapësirat janë ngrohur në pajtim me standardet e dëshiruara.

Shfrytëzuesit theksuan se mund të dalin lirshëm nga Enti kuptohet me firmosjen e deklaratës, pa iu kufizuar e drejta kryesore e lirisë së lëvizjes. Numri më i madh i të punësuarve kanë sjellje korrekte ndaj shfrytëzuesve, mirëpo prapë se prapë shfrytëzuesit mendojnë se u kushtohet pak kujdes nga ana e drejtorisë për nevojat e tyre dhe jo çdoherë pranohen idetë dhe kërkesat e tyre. Gjithashtu ishte potencuar se në ent nuk ekziston sistem adekuat i ankesave dhe parashtresave.

Në ent realizohet mësim i organizuar nga klasa e parë e deri në të nëntën, sipas planit dhe programit për mësim të rregullt të cilët janë në pajtim me Ligjin për arsim fillor të Republikës së Maqedonisë, mirëpo te nxënës të caktuar për shkak të zvogëlimit të aftësive të tyre dhe mundësive i njëjti është reduktuar. Nga kontrolli i planeve dhe programeve mësimore ishte konstatuar se mësimdhënësit punojnë sipas programeve të rregullta me nxënësit të cilët i kanë ruajtur aftësitë intelektuale, ndërsa me nxënësit të cilët janë me paaftësi intelektuale dhe pengesa të kombinuara e reduktojnë programin. Të njëjtit zbatojnë mësim inaktiv dhe të individualizuar, mirëpo mungojnë plane individuale arsimore për fëmijët me pengesa të kombinuara, me përjashtim të defektologut i cili bën përpjekje për vendosjen e tyre.

2.4.2 IP Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve-Shkup

Mekanizmi Parandalues Nacional bashkë me bashkëpunëtorin e jashtëm-defektolog realizoi vizitë Në Institucion Publik Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve-Shkup, i cili është institucion me interes publik dhe është në rrjetin e institucioneve publike me karakter social. Veprimtaria kryesore e Entit është sigurimi i trajtimit, rehabilitimit-korektiv të fëmijëve dhe të të rinjve me pengesa mesatare, të rënda, si dhe të kombinuara të zhvillimit intelektual. Ky trajtim është kompleks, për arsye se në vete përmban më shumë komponentë, siç janë: përfshirje ditore në konvik, strehim, edukim, arsimim, aftësi pune, angazhim punues dhe preokupim pune, mbrojtje shëndetësore, si dhe jetë kulturore-argëtuese dhe jetë rekreative-sportive të

shfrytëzuesve.

Personat në Ent pranohen me vendim të Qendrës për mbrojtje sociale. MPN gjatë vizitës së Entit konstatoi se në Ent gjatë periudhës së kaluar më shumë pranohen shfrytëzues me pengesa të kombinuara dhe pa kujdes prindëror, gjithashtu edhe pa periudhë adaptuese gjë që e vështirëson punën e personave profesionist;, posaçërisht në pjesën e mbrojtjes shëndetësore, për arsye se rreth 25 shfrytëzues për çdo ditë janë në trajtim mjekësor, kurse të punësuar ka vetëm 5 persona të mjekësisë (infermiere dhe dado) të cilët bëjnë kujdestari në tre turne. Mbrojtja primare shëndetësore në Ent realizohet nëpërmjet mjekut amë i cili gjendet në afërsi të Entit dhe i cili është i obliguar që të jep terapi medikamentoze ose t'i udhëzojë tek mjeku specialist. Mjeku i cili është i punësuar në Ent e përcjell gjendjen shëndetësore të të gjithë shfrytëzuesve dhe kujdeset për zbatimin e terapisë dhe të shërimit.

Nga kontrolli i bërë në pjesën e konviktit (kapacitet për vendosje) ishte konstatuar se në dhomat e fjetjes higjiena nuk është në nivelin e duhur (në disa dhoma kundërmonite era e fuqishme e urinës), ndërsa mungon edhe hapësira e mjaftueshme për shkak të numrit të madh të shtretërve në dhoma. Hapësirat për mësim praktik, në pjesën më të madhe, janë të pajisura me vegla dhe makina për punë, mirëpo mungojnë materiali për punë dhe pajisja mbrojtëse (doreza mbrojtëse, si dhe veshja e veçantë për punë).

Gjatë bisedës me disa shfrytëzues nga Qendra ditore, MPN konstatoi se të njëjtit janë të kënaqur nga përfshirja e tyre në qendrën ditore, mirëpo treguan për nevojën e sigurimit të kushteve më të mira për qëndrim dhe aktivitete, ndërsa u ankuan në pamundësinë për ta shfrytëzuar palestrën e sportit. Njëkohësisht, shfrytëzuesit u ankuan edhe për mospasjen e larjes (lavatриçes) në qendrën ditore, në të cilën më herët kanë larë dhe kanë hekurosur veshje. Personat theksuan se nuk kanë zgjidhje të madhe të aktiviteteve, si rezultat i kësaj të njëjtat u janë bërë monotone dhe shpesh herë kanë mospajtime ndërmjet tyre, ndërkaq paraqiten edhe tentativa për përplasje të ndërsjella.

Enti disponon me veturë të vjetër për transportin e personave e cila shpesh herë është në gjendje jo funksionale.

2.4.3 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Mekanizmi Parandalues Nacional nuk mori përgjigje në afatin e caktuar ligjor nga ana e Entit për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve-Shkup, Entit për Mbrojtje dhe Rehabilitim-Banja Bansko, si dhe nga ana e ministrisë përkatëse.

Pas urgjencës së dorëzuar MPN mori përgjigje nga ana e Entit për Mbrojtje dhe Rehabilitim -Banja Bansko, se janë ndërmarrë masa për vendosjen e personave të cilët kanë lloj tjetër të aftësive të kufizuara dhe se tanimë dy persona janë transferuar në institucione të cilat u përgjigjen nevojave të tyre. Në lidhje me vendosjen joadekuate e cila do të mund të sjell edhe deri te trajtimi johuman, instituti informoi se nuk ka kompetenca dhe se për atë vendosin qendrat për punë sociale. Ky institut e lajmëroi MPN se do të vendosë sëndukë për ankesa dhe parashtresa, si dhe se i ka njoftuar shfrytëzuesit për formimin e këshillit me qëllim të tejkalimit të lëshimeve të caktuara ose të problemeve në Ent.

2.5 VENDE PËR STREHIMIN DHE QËNDRIMIN E TË HUAJVE, MIGRANTËVE ILEGALË, DHE AYILKËRKUESVE

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit-Mekanizëm Parandalues Nacional realizoi vizita të rregullta të paparalajmëruara në tre stacione policore për kontroll kufitar (SPKK): SP për Kontroll Kufitar Tabanovcë, SP për Kontroll Kufitar Bllacë e Poshtme dhe SP për Kontroll Kufitar Bogorodicë. MPN-ja realizoi vizita të paparalajmëruara në këto stacione policore për kontroll kufitar me qëllim të perceptimit të gjendjeve dhe kushteve në vendet ku personat privohen nga liria dhe trajtimin të tyre, si dhe realizimit të të drejtave të personave të huaj, migrantëve ilegalë, si dhe kërkuesve të së drejtës së azilit.

2.5.1 Kushtet materiale

Stacionet policore për kontroll kufitare nuk janë përcaktuar si stacione policore ku ndalohen personat e privuar nga liria, dhe si rezultat i kësaj në të njëjtat nuk ka hapësira për këtë qëllim. Mirëpo, në bazë të autorizimeve të cilat i kanë, këto stacione policore mund të privojnë nga liria persona të cilët kërkohen, gjegjësisht persona për të cilët është dhënë urdhër-arrest, apo nëse bëhet fjalë për persona të cilët ilegalisht kanë hyrë në shtet. Së këtejmi, privimi nga liria ose mbajtja e përkohshme në stacionin policor për kontroll kufitare Tabanovcë bëhet në zyrat zyrtare edhe atë më së shpeshti në dhomën për takime, në SP në Bogorodicë ndalimi i përkohshme bëhet në zyrat e udhëheqësit të turnit ose në sallën e cila gjendet tek kalimi hekurudhor, kurse në stacionin policor për kontroll kufitare Bllacë ndalimi i përkohshëm kryhet në zyrat e udhëheqësit të turnit ose në njërën nga hapësirat e objektit të posaçëm të ndarë në të cilin ka edhe banjë.

Në tri stacionet policore për kontroll kufitare ishte konstatuar se hapësirat ku përkohësisht ndalohen personat e privuar nga liria nuk janë adekuate dhe nuk janë të përshtatshme as për mbajtje prej disa orëve.

Njëherësh, në stacionin policor për kontroll kufitare Tabanovcë, si hapësirë për ndalim të përkohshëm shfrytëzohet dhoma për takime e cila nuk ka ngrohje, kurse në rastet e privimit nga liria në dhomë është i pranishëm edhe nëpunësi policor i cili e siguron personin deri te pranishmësinë e tij. Në stacionin policor për kontroll kufitare ishte konstatuar se shfrytëzohet hapësirë jo adekuate për arsye se e njëjta nuk është e pajisur dhe nuk ka ngrohje, dhe njëherësh në të njëjtën hapësirë të punësuarit i ruajnë edhe punët e tyre personale.

Konform Urdhrit për standardet dhe normativat për planifikim, ndërtim dhe rregullim të objekteve të cilat i shfrytëzon MPB në kalimet kufitare është konstatuar ekzistimi i hapësirës për kontrollin e personave dhe sendeve, si dhe hapësirë për azilkërkuesit me sipërfaqe prej 9m².

Në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar Tabanovcë, MPN ishte i informuar se ky kalim kufitar nuk disponon me hapësira të tilla gjë që paraqet mangësi në sigurimin e kushteve materiale, veçanërisht për personat kërkues të azilit. Hapësirë të veçantë për kontrollin e personave të privuar nga liria, nuk ka as në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar në Bllacë dhe në këtë drejtim kontrolli i personave të privuar nga liria bëhet në cilën do hapësirë të lirë, gjegjësisht në zyrën e udhëheqësit të turnit përderisa sendet e sekuestruara nga personat magazinohen dhe ruhen në depo të posaçme ose në sirtar të veçantë (sef) MPN konstatoi se Stacioni Policor për Kontroll Kufitar në Bogorodicë si hapësirë të veçantë për kërkuesit e azilit e shfrytëzon dhomën për takime dhe trajnime e cila është në gjendje të rregullt, mirë e pajisur dhe diskrete për qëndrimin e azilkërkueseve.

Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme parasheh: *"Kërkesa për pranimin e të drejtës së azilit të parashtrohet në kalimin kufitar gjatë hyrjes në Republikën e Maqedonisë"*. Në pajtim me këtë, janë të nevojshme hapësira ku do të qëndrojnë kërkuessit e mundshëm të azilit deri në momentin e transportimit të tyre në Qendrën e Pranimi ku kanë të drejtë të vendosjes deri në mbarimin përfundimtar të procedurës për azil.

2.5.2 Realizimi i të drejtave të personave të privuar nga liria

Në bazë të vizitave të realizuara Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se udhëheqësit e turneve çdoherë i informojnë personat e privuar nga liria për të drejtat e tyre gjatë momentit të privimit nga liria për çka nëpunësit policor i plotësojnë në mënyrë adekuate procesverbalet. Në Stacionin Policor për Kontroll Kufitare Bogorodice, komunikimi me personat e privuar nga liria të cilët janë shtetas të huaj bëhet në gjuhën angleze ose gjuhë tjetër të cilën e flasin nëpunësit policor (në gjuhën greke, turke ose gjuhën shqipe). Njëkohësisht ky stacion policor në mënyrë obliguese e lajmëron organin kompetent për privimin nga liria të shtetasit të huaj, me qëllim të ndërmarrjes të aktiviteteve të duhura. Në pajtim me informatat e fituara gjatë vizitës së realizuar, por edhe kontrollit në evidencat MPN konstatoi se në këtë kalim kufitar është evidentuar numër i madh i migrantëve ilegal.

Gjithashtu në SPKK Bllacë, personat e privuar nga liria si dhe migrantët ilegal çdoherë njihen me të drejtat e tyre në gjuhën të cilën e njohin dhe në këtë stacion policor ka të punësuar më shumë nëpunës policorë të cilët njohin më shumë gjuhë (gjuhën shqipe, turke, rome, serbe dhe gjuhën angleze). Në SP Tabanovcë personat e privuar nga liria që janë migrantë ilegal me të drejtat e tyre njihen në gjuhën të cilën ata e njohin, ndërsa në rast se nuk e njohin gjuhën, atëherë lajmërohet sektori kompetent në Ministrinë për Punë të Brendshme dhe ndërmerren veprime përkatëse.

MPN konstatoi se personat e arrestuar në tre stacionet e vizituara policore për kontroll kufitar janë në mënyrë adekuate të udhëzuar për të drejtën e mbrojtësit, mirëpo shumë rrallë herë vendosin që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë. Nëpunësit policorë çdoherë thërrasin mjek, po qe se personat kanë nevojë dhe domosdoshmërisht informohen për të drejtën e mjekut.

2.5.3 Evidenca për personat e privuar nga liria

Gjatë vizitave të realizuara në stacionet policore për kontroll kufitar, MPN bëri kontroll në evidencat dhe regjistrat për personat e arrestuar. Nga ana e MPN ishte konstatuar se në të gjitha stacionet policore për kontroll kufitar Regjistri i personave për të cilët mbi çfarë do lloj baze u është kufizuar liria e lëvizjes udhëhiqet në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë adekuate plotësohen të gjitha kolonat e këtij Regjistri. Në SP Tabanovcë ishte konstatuar se Regjistri udhëhiqet në mënyrë të rregullt dhe adekuate, vetëm në një rast ishte vërejtur se nuk është regjistruar ora kur ka përfunduar ndalimi në këtë stacion policor, gjegjësisht kur personi i është dorëzuar organit tjetër për ndalim.

Në SPKK Bogorodice ishte konstatuar se Regjistri për ngjarjet e ditës udhëhiqet me rregull dhe në pjesën më të madhe të gjitha kolonat janë plotësuar qartë, me disa përjashtime ku në një pjesë të librit për ngjarjet e ditës nuk ishte theksuar koha e ndërprerjes së arrestimit. Nga kontrolli i bërë në Regjistrin e personave të cilëve, mbi çfarë do lloj baze, u është kufizuar liria e lëvizjes mund të vërehej se mbajtjet në të

gjitha stacionet e vizituara policore për kontroll kufitare zgjasin nga dy orë, gjegjësisht nuk ka mbajtje më të gjata se dy orë. MPN bëri kontroll edhe në dosjet individuale të personave të arrestuar, kurse kontrolli i dosjeve individuale u bë sipas zgjedhjes së rastësishtme. MPN konstatoi se në SPKK dosjet individuale udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe adekuate, në të cilat përveç procesverbalit për ndalim janë shtuar edhe një numër i madh i dokumenteve tjerë të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen e personit dhe realizimin e të drejtave në procedurë policore. Vetëm SPKK Bogorodicë nuk plotëson procesverbal për mbajtje për arsye, duke u nisur prej faktit se i njëjti nuk ndalon persona, "por vetëm arreston persona", dhe në pajtim me këtë udhëheq evidencë për personat të privuar nga liria të cilët janë të arrestuar në kalimin kufitar.

Në këtë drejtim MPN theksoi se në kalimet e tjerë kufitar, gjatë kontrollit të evidencave është konstatuar se udhëhiqen edhe procesverbal për ndalim ku evidentohet koha e fillimit të privimit dhe koha kur personi u dorëzohet stacioneve kompetente policore.

MPN konsideron se praktika e ndryshme e stacioneve policore për kontroll kufitar e imponon pyetjen se cili lloj i dokumentacionit dhe evidencave duhet të udhëhiqet në kalimet kufitare, duke e pasur parasysh se të njëjtat nuk janë të caktuara për ndalim, mirëpo është e nevojshme që t'i kushtohet kujdes rrjedhës logjike të ngjarjeve dhe të evidentohet se kujt dhe kur i dorëzohet personi i privuar nga liria. Në këtë drejtim Avokati i Popullit-MPN kërkoi nga Ministria për Punë të Brendshme që të përgatis udhëzim për dokumentacionin e nevojshëm i cili do të plotësohet për personat të cilët privohen nga liria në kalimet kufitare e deri në marrjen e tyre nga ana e organit kompetent dhe në të cilin do të regjistrohet sigurimi i të drejtave të parapara.

Në SP Tabanovcë në pjesën më të madhe të dosarëve të kontrolluar mund të konstatohet se ekziston rrjedha logjike e ngjarjeve, që nga momenti i privimit, ashtu që në të gjitha dosarët individual ishte shënuar se kur personi është privuar nga liria, kur i janë treguar të drejtat, si dhe kur i është dorëzuar organit kompetent. MPN konstatoi se në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar Bllacë, në numrin më të madh të procesverbaleve të kontrolluara për ndalimin e personave nuk ishte plotësuar pjesa për udhëzimin me të drejtat, si dhe pjesa për lëndimet e personit (se a ka pasur lëndime të dukshme apo jo), shenja të sëmundjes dhe nevoja për mjek gjatë pranimit të personit. MPN konsideron se gjatë pranimit është e nevojshme që patjetër të plotësohen të gjitha kolonat në procesverbalin për ndalim, duke i përfshirë pjesët për udhëzimin e personit për të drejtën e mbrojtësit, si dhe pjesën se a ka apo nuk ka lëndime të dukshme dhe nevojën për mjek.

Ajo që veçanërisht ishte vërejtur në evidencat për ndalim është se në SPKK Bogorodicë, në pjesën më të madhe të dosjeve të kontrolluara, nuk ishte theksuar koha se deri kur personi ka qenë i privuar nga liria dhe as se kujt i është dorëzuar. Duke u nisur nga praktika e kalimeve tjera kufitare ku udhëhiqet procesverbal për ndalim dhe në të cilin potencohet e gjithë koha e kaluar në këtë stacion policor, si dhe cilit stacion policor ose organi tjetër i është dorëzuar personi, MPN sugjeroi se e njëjta duhet të evidentohet edhe në evidencat e këtij stacioni. MPN konsideron se për personat e privuar nga liria, të cilët qëndrojnë edhe nga disa orë në këtë kalim kufitar, është e nevojshme të përpilohet procesverbal adekuat i ngjashëm me procesverbalin për ndalim (edhe pse këto stacione policore nuk janë caktuar për mbajtje, por de facto personat e privuar nga liria mbahen nga disa orë), si dhe të sigurohet ushqim adekuat për personat e arrestuar të cilët qëndrojnë më gjatë se 6 orë deri në momentin e dorëzimit të tyre te nëpunësit kompetent policor dhe stacione.

2.5.4 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Pas dërgimit të raporteve për vizitat e stacioneve policore për kontroll kufitare Tabanovcë, Bllacë e Poshtme dhe Bogorodicë, MPN mori përgjigje nga Ministria për Punë të Brendshme se është dërguar telegram deri te Sektori për Punë Kufitare dhe Migrim në pajtim me të cilin, qëndrimi i personave të privuar nga liria nuk guxon të jetë më i gjatë se 30 minuta, duke e pasur parasysh se këto stacione policore nuk janë të përcaktuara për ndalimin e personave të privuar nga liria. Njëkohësisht, duke u nisur nga fakti se këto stacione policore nuk kanë hapësira të veçanta për kontroll, si dhe hapësira për kërkuesit e azilit, shfrytëzohen hapësirat zyrtare me çka mbahet kujdes për dinjitetin personal si dhe trajtimin human të personave. Ministria gjithashtu informoi se në afat sa më të shkurtër të mundshëm do të përpunohen materiale të shkruara në më shumë gjuhë për të drejtat e personave të privuar nga liria, të cilët do të vendose në vende të dukshme për qytetarët.

2.6 VENDETË TJERA TË VIZITUARA

2.6.1 Institucioni Publik Shtëpia për Fëmijë "11 Tetori" Shkup

Në vitin 2013 në pajtim me planin vjetor, MPN realizoi vizita edhe të institucioneve të hapura të cilat de jure nuk janë vende të privimit nga liria, mirëpo në përputhje me qëndrimin janë institucione në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar gjegjësisht në të cilat vendosen persona në bazë të aktit të nxjerrë nga ana e organit gjyqësor ose të atij administrativ.

Me qëllim të analizimit të trajtimit të fëmijëve, MPN së bashku me përfaqësuesit e Dhomës së Psikologëve dhe Shoqatës së Punëtorëve Social të Qytetit të Shkupit, realizoi vizitë të IP të Entit për Fëmijë, "11 Tetori" në Shkup. Konform Ligjit për mbrojtje sociale të drejtë të vendosjes në institucion kanë fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore të moshës mbi tre vjet dhe për ato institucioni siguron strehim dhe edukim deri në aftësimin e tyre për jetë dhe punë të pavarur, ndërkaq më së voni deri në gjashtë muaj pas mbarimit të shkollës së mesme, në rast se nuk ekzistojnë mundësi tjera që strehimi të sigurohet në mënyrë tjetër. Institucioni është i obliguar që fëmijëve dhe të rinjve t'u sigurojë ndjekje të shkollës fillore dhe asaj të mesme, organizim të ndihmës profesionale për procesin edukativo-arsimor, të organizojë forma të ndryshme të punës, si dhe të kujdeset për shëndetin e fëmijëve.

Mekanizmi Parandalues Nacional nuk mori ankesa për torturë ose ndonjë lloj tjetër të trajtimit brutal, johuman ose nënçmues. Numri më i vogël i fëmijëve treguan vetëm pakënaqësi ndaj sjelljes pasive dhe ndonjëherë të ashpër të një pjese të edukatorëve dhe konsiderojnë se institucioni duhet të ketë qasje proaktive ndaj tyre me më shumë kujdes, mbikëqyrje, si dhe sigurim të aktiviteteve shtesë gjatë ditës. Në bisedat e zhvilluara me fëmijët ishte theksuar se të njëjtit janë njoftuar me rendin shtëpiak, kurse në çdo dy deri në tre ditë mbajnë takime grupe.

Pjesa më e madhe e vërejtjeve u dedikoheshin banjave në të cilat nuk kishte shtypje të mjaftueshme të ujit dhe higjiena nuk mbahej në nivelin e duhur. Një numër i vogël i fëmijëve u ankuan se nuk marrin me kohë mjete për mbajtjen e higjienës personale, përderisa të tjerët vërtetuan se të njëjtat i marrin nga Enti.

Hapësirat në të cilat vendosen fëmijët disponojnë pajisjen e nevojshme të dedi-

kuar për shkollim dhe edukim (tavolinë pune, karrige). Janë siguruar krevate cilësore me dyshekë për fjetje, si dhe garderoba personale për ruajtjen e veshjeve. Grupet edukuese janë të ndara në katër njësi banesore, në secilën njësi banesore ka kuzhinë të posaçme, si dhe dhomë për dite të zbkuruar në përputhje me moshën e fëmijëve. Gjatë matjes së temperaturës dhe lagështisë në dhoma ishte konstatuar se temperatura sillej prej 22 deri në 24 °C, ndërsa lagështia prej 41-44% që është në pajtim me standardet e dëshiruara. Në përgjithësi në të gjitha njësitë banesore kushtet materiale janë në nivel të lartë, me nevojën e ngjyrosjes shtesë të një pjese të vogël të dhomave, si dhe mirëmbajtjen e banjave me kohë.

Në institucion është punësuar infermiere e cila kujdeset për mbrojtjen shëndetësore të të mbrojturve të entit dhe e njëjta është me orar pune prej ora 07 e deri në orën 15.00. Dhoma medicinale është e pajisur me dollap të veçantë për barna, aparat për matjen e shtypjes, material sanitar, inhalator. Për fëmijët është siguruar mjek amë jashtë entit, ndërsa terapinë e ndanë infermierja gjatë orarit të punës, ose edukatorët kur e njëjta nuk është në punë. Për raste urgjente infermierja fëmijët i dërgon në klinikë, kurse MPN-ja gjatë bisedave të zhvilluara mori konfirmim se infermierja i dërgon në mjek, gjithashtu bashkë me të shkojnë edhe në stomatolog. Gjatë pranimit të fëmijës në ent merret vërtetim nga mjeku se i njëjti është i shëndoshë dhe kërkohet kartoni i tij shëndetësor. Infermierja mban dosje për secilin fëmijë, dhe njëherësh mban edhe evidenca për vaksinimin e fëmijëve të vendosur në ent.

2.6.2 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në përgjigjen e dhënë ndaj rekomandimeve të dorëzuara informoi se është në vijim procesi i deinstitutionalizimit të entit, ndërsa njëherësh Ministria bashkë me Entin për punë sociale përgatisin program për transformimin e punës së këtij entit në drejtim të përmirësimit të kujdesit për fëmijët.

Nga ana e entit është dorëzuar informacion me të cilin MPN-ja njoftohet se është punësuar edukatorë sporti i cili i angazhon shfrytëzuesit në sferën e sportit dhe të rekreacionit, kurse njëherësh Enti ka të përgatitur program vjetor për punë në sione. Ishte potencuar se entit për punë sociale ka përgatitur program për edukimin e drejtorëve dhe punëtorëve profesional, sipas të cilit është paraparë edhe edukimi i punëtorëve social.

Në drejtim të sanimit të tualeteve janë ndërmarrë masa, ndërsa në aspekt të ndërrimit të prizës dhe izolimit të kablove, është bërë kontroll nga ana e komisionit përkatës.

2.6.3 Drejtoria e Doganave

Drejtoria e Doganave në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale ka kompetenca që të privojë nga liria, si dhe të bëjë ndalimin e personave të privuar nga liria. Në të njëjtin Ligj theksohet se "personi ndalohet në stacione policore të rregulluara posaçërisht për këtë qëllim, hapësira posaçërisht të rregulluara të Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë për Polici Financiare, të përcaktuara me akt të ministrit për Punë të Brendshme, gjegjësisht ministrit të Financave"⁶

Gjatë vizitës MPN konstatoi se ekzistojnë hapësira të veçanta në të cilat vendosen personat e ndaluar të cilët janë të privuar nga liria. Drejtoria e Doganave ka

⁶ Neni 161 paragrafi 4 nga Ligji për procedure penale, Gazeta zyrtare e RM nr. 150 nga 18.11.2010

përgatitur edhe Udhëzimin për mënyrën dhe procedurën e arrestimit, ndalimit, dhe marrjes në pyetje të personit fizik. Në momentin e vizitës nuk kishte persona të ndaluar me të cilët MPN do të mund të bisedonte rreth trajtimit të tyre nga ana e nëpunësve doganorë dhe kushtet për ndalim në Drejtorinë e Doganave.

Hapësirat për ndalim gjenden në pjesën e bodrumit të Drejtorisë së Doganave. Dy hapësirat i plotësojnë minimum standardet për vendosjen e personave të ndaluar nga aspekti i madhësisë së tyre. Gjithashtu, hapësirat e njëjta janë me sipërfaqe më të madhe se 4 m² me çka plotësohet standardi minimal prej 4 m² për person. Nga kontrolli i hapësirave për ndalim, MPN –ja konstatoi se të njëjtat janë të rregulluara në mënyrë adekuate me pajisje të pastra dhe mirë të rregulluara për pushim (për ndalim afatshkurtër dhe ndalim gjatë natës), siç është krevati, dyshekë të rinj, jorganë dhe jastëk për pushim nate dhe fjetje. Të njëjtat janë të punuara në mënyrë dhe nga material të cilat mundësojnë shkallë të lartë të mbrojtjes së personave nga lëndimet, kurse si masë shtesë mbrojtëse është edhe video mbikëqyrja e vënë në dhomat për vendosje. Nëpërmjet video mbikëqyrjes përcillet gjendja e personave të ndaluar. Në pjesën e mbrojtjes dhe sigurisë së personave të ndaluar janë edhe krevatet në të cilët dysheku është i vënë në konstruktin prej pllakave, me çka pamundësohet shfrytëzimi jo i rregullt i tyre si dhe keqpërdorimi i tyre. MPN –ja konstatoi se në hapësirën për marrjen në pyetje tavolina dhe karriget nuk janë të fiksuara për dyshemenë, ndërsa në banjë ishte vendosur mbajtës i metalit për letër, i cili mund të përdoret dhe të sjellë deri te rreziku eventual i lëndimeve ose vetëlëndimeve të personit të ndaluar.

MPN –ja ishte e njoftuar se personat çdoherë ishin të informuar për të drejtat e tyre dhe për arsyen e ndalimit në gjuhën të cilën ata e kuptojnë përmes përkthyesit (përmes agjencisë së përkthimit) apo përmes nëpunësve doganorë të cilët e flasin gjuhën e personit të ndaluar.

Për ndalimin e personit në Drejtorinë e Doganave plotësohet Procesverbal për ndalim. Evidenca për personat e privuar nga liria udhëhiqet në formë elektronike, si dhe në formë të shkruar. MPN nga kontrolli i bërë në procesverbalin për ndalimin e personave, konstatoi se i njëjti udhëhiqet me korrektësi me atë që të gjitha kolonat janë të plotësuar në tërësi dhe në mënyrë të lexueshme. Njëherit, nga kontrolli i bërë në procesverbalet e njëjtë, MPN konstatoi se në Drejtorinë e Doganave personat e ndaluar çdoherë janë të njoftuar me të drejtat e tyre konform normave dhe rregullave ligjore. MPN konstatoi se personit të ndaluar i është ofruar ushqim, ujë dhe duhan, ndërsa përderisa personi është ndaluar kryhet kontroll e drejtpërdrejtë në çdo 30 minuta, gjë që në mënyrë adekuate regjistrohet në procesverbalin për ndalim. Gjithashtu, në procesverbal regjistrohet se cili prej nëpunësve doganorë e ka krye kontrollin.

Në lidhje me Urdhrin për shfrytëzimin e mjeteve për detyrim të cilën e ka miratuar Drejtoria e Doganave, MPN –ja konstatoi se nuk janë potencuar mjetet për lidhjen e personit (prangat), edhe pse të njëjtat përdoren nga ana e nëpunësve doganorë. Gjithashtu, në Udhëzimin për mënyrën dhe procedurën e arrestimit, ndalimit dhe marrjes në pyetje të personit fizik nuk është rregulluar çështja e parashtrimit të parashtrësve nga ana e personit të privuar nga liria, po që se personi mendon se trajtimi dhe raporti ndaj tij ka qenë jokorekt, përkatësisht janë tejkaluar autorizimet e dhëna.

Nga biseda me personat zyrtarë MPN mori informatë se Drejtoria e Doganave nuk ka mjete të veçanta nga buxheti për sigurimin e ushqimit të personit të ndaluar, edhe pse në Udhëzimin për mënyrën dhe procedurën e arrestimit, ndalimit dhe marrjes në pyetje të personit fizik qëndron se "inspektorët doganorë ose nëpunësit doganorë janë përgjegjës për nevojat elementare të personit të ndaluar, ndërsa kjo do të thotë sigurimin e ushqimit dhe pijeve në periudha përkatëse, si dhe qasje deri te hapësirat për mbajtjen e higjienës". Drejtoria konfirmoi se nuk disponon edhe me veturë të veçantë për transportin e personave të privuar nga liria.

2.6.4 Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Drejtoria e Doganave në bazë të raportit të dorëzuar, gjendjes së konstatuar dhe rekomandimeve të dhëna, e ka informuar Mekanizmin Parandalues Nacional se në dhomën për marrjen në pyetje të personave të dyshuar karriget dhe tavolina janë të fiksuara dhe nëpër tualete janë larguar lëndët e rrezikshme, me të cilat personat do të mund të lëndoheshin.

Në buxhetin për vitin 2014 parashihet pikë e veçantë për fonde të destinuar për blerjen e ushqimit për personat e ndaluar. Gjithashtu, nga kompania e autorizuar është kërkuar që të kryen përshtatjen e automjetit, me qëllim që të jetë i pajisur për transportin e personave të privuar nga liria.

Drejtoria e Doganave ka hartuar një Projekt Urdhër për ndryshimin dhe plotësimin e Urdhrit për përdorimin e masave të detyrimit, si dhe mbajtjen e armëve dhe në projektin është përmendur se me urdhrin duhet rregulluar edhe përdorimi i mjeteve për lidhje, përkatësisht përdorimi i prangave. Projekt urdhri i është dërguar Ministrisë së Financave. Gjithashtu, Udhëzues shtesë për mënyrën dhe procedurën e arrestimit, privimit nga liria dhe paraburgimit, është plotësuar, me ç'rast është paraparë që gjatë dorëzimit të kopjes së procesverbalit personi të ketë mundësi të bëjë vërejtje për trajtimin në formë të ankesës. Vërejtjet më tujte do të futen edhe në evidencën elektronike.

3 VIZITA PËR RI-KONTROLL NË VITIN 2013

Në vitin 2013 Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) ka realizuar 16 vizita për ri-kontroll, nga të cilat 4 nëpër stacione policore, 5 nëpër institucionet ndëshkuese - korrektuese (burgje), 3 nëpër institucionet për kujdesin e fëmijëve, 2 nëpër qendrat për vendosjen e të huajve dhe të azilkërkuesve, si dhe 1 vizitë në Qendrën Edukuese - Korrektuese dhe Entin Special Demir Kapi.

3.1 STACIONET POLICORE

Në përputhje me programin vjetor për vitin 2013 janë realizuar vizita për ri-kontroll nëpër stacionet policore Kriva Pallankë, Kumanovë, Gjevgjeli dhe Radovish, me qëllim të konstatimit të gjendjes të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga vizitat e mëparshme në vendet e privimit nga liria.

Gjatë vizitës në **Stacionin Policor Kriva Pallankë** ishte konstatuar që akoma janë në funksion të njëjtat dhoma për paraburgim, për të cilat MPN kishte konstatuar se nuk i përmbushin standardet e duhura. Në pjesën e bodrumit gjenden dy dhoma për vendosje individuale, në të cilat ishte konstatuar gjendje e pandryshuar në lidhje me kushtet për paraburgim. Në këto dhoma ka lagështi të madhe, nuk është vendosur ndriçimi artificial, dritat në korridor përmes të cilit ndriçohen dhomat e paraburgimit nuk funksiononin, dhe si problem i veçantë është mosekzistimi i sistemit të ngrohjes. Gjatë kontrollit të sistemit të thirrjes ishte konstatuar se i njëjti është në gjendje të rregullt. Në derën hyrëse të dhomave ishin vendosur lista të kontrollit (check list) për mbikëqyrjen e personave të ndaluar. Sa i përket gjendjes së dhomave për paraburgim, nga ministria përkatëse, MPN u informua se ky stacion policor është përfshirë në planin aksionit për renovim. Nga inspektimi MPN arriti në përfundim se procesi i renovimit nuk ka filluar me kohë, gjegjësisht ka vonesë me zbatimin i tij në afatin e caktuar.

Nga inspektimi mbi Regjistrin e ngjarjeve të ditës, si dhe të Regjistrin për persona të cilëve për çfarëdo arsye ju është kufizuar liria e lëvizjes (Regjistri për presona të thirrur, të arrestuar dhe të ndaluar) është konstatuar se të njëjtit menaxhohen siç duhet dhe në to nuk përdoret korrektor, d.m.th., të dhënat e gabuara shlyhen. Regjistri për ngjarjet e ditës menaxhohet siç duhet, ku përfshihej edhe përmbledhja mujore e të thirrurve, të arrestuarve dhe të ndaluarve. Gjatë inspektimit të dosjeve është konstatuar se të gjitha dosjet i përmbajnë procesverbalet kyçe (procesverbal për paraburgim, procesverbal për të drejtat, si dhe procesverbal mbi të drejtën e mjekut), në këtë pikë MPN konstatoi përparim. Po ashtu, dosjet ishin plotësuar ashtu siç duhet në faqen e dytë dhe të tretë, me listë të përmbajtjes se cilat dokumente ndodhen në to, si dhe cilët persona kanë realizuar bisedë me personat e privuar nga liria. Të gjitha dosjet e kontrolluara kishin procesverbal për të drejtën e mjekut në të cilin përmendet nëse personi kërkon ose nuk kërkon mjek, megjithatë MPN ka konstatuar rast të nivelit më të lartë të alkoolit në gjak tek personi i ndaluar për të cilin nuk është thirrur mjeku, në pajtim me indikacionet paraprake të dhëna nga MPN. Në disa proces verbale është

vërejtur se nuk mund të përcaktohet rrjedha logjike e ngjarjeve nga koha e privimit nga liria deri te paraburgimi në stacionin policor, ndërsa në një procesverbal është konstatuar se nuk është regjistruar ora e ndalimit. Në pajtim me inspektimin mbi realizimin e të drejtave dhe udhëheqjes së evidencës për personat në paraburgim, MPN konstatoi se rekomandimet e dhëna më parë pjesërisht janë zbatuar.

Nga vizita e MPN në vitin 2013 dhe nga korrespondenca e mëparshme me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mund të konkludohet se ndërmerren masa për përmirësimin e kushteve në dhomat për paraburgim të personave, përmes planit për renovimin e tyre. Ky stacion policor është i përfshirë në planin aksional për renovim, por duke i pasur parasysh kushte tejet të vështira në dhomat për paraburgim, nevojitet përshtatje e përkohshme e dhomës ndihmëse, me qëllim të përdorimit të saj gjatë paraburgimeve të shkurtra.

Në **Stacionin Policor Kumanovë** u konstatua se pjesa më e madhe e rekomandimeve të dhëna pjesërisht apo plotësisht ishin përbushur. Rekomandimet e dorëzuara pranë Ministrisë përkatëse nuk ishin zbatuar, për shkak të mos implementimit me kohë të Planit aksional për renovim të miratuar nga MPB. Në pajtim me Planin aksional të MPB për rinovimin dhe rikonstruktimin e dhomave për paraburgim në stacionet policore, SP Kumanovë është ndër stacionet e para policore në të cilin do të bëhet rinovimi i dhomave për paraburgim, më saktë, rinovimi dhe rikonstruktimi është dashur të fillojë në vitin 2012. Në SP Kumanovë në periudhën kohore prej dy vjetësh gjendja është e njëjtë dhe akoma shfrytëzohen dhomat e vjetra për paraburgim të personave të privuar nga liria, që nuk i përbushin standardet në raport me ngrohjen, ndriçimin natyror dhe artificial, ventilimin etj.

Në dhomat e paraburgimit është konstatuar se higjiena është përmirësuar, por jo në nivel të kënaqshëm, krevatet në të gjitha dhomat ishin mbuluar me çarçafë dhe batanije (të cilat ishin pjesërisht të pastërta), por jastëkët ishin të pistë dhe të shprishhtë. Në to akoma nuk kishte të vendosur sistem për ngrohje dhe ftohje, si dhe sistem për ventilim. Gjatë inspektimit në njërën nga dhomat nuk funksiononte sistemi për thirrje (alarmi).

Përveç kësaj, MPN kërkoi që njoftohet nga ministria përkatëse për dinamikën e implementimit të Planit Aksional, dhe dorëzoi rekomandime të reja deri te MPB dhe stacioni policor. MPN erdhi në përfundim se nuk janë zbatuar rekomandimet që kanë të bëjnë me pajisjen e një dhome të posaçme për paraburgimin e personave të mitur në pajtim me Ligjin mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe sigurimin e ushqimit që është paraparë me standardet ndërkombëtare për privimin e personave nga liria dhe paraburgimin e tyre. Janë konstatuar përmirësime në udhëheqjen e evidencës për personat e privuar nga liria, gjegjësisht të gjitha lëndët ishin me dosje të formuara të cilat përbëjnë procesverbalet e detyrueshme gjatë paraburgimit në SP. Ekipi i MPN konstatoi se të drejtat e personave të thirrur, të arrestuar ose të ndaluar ishin të theksuara në më shumë gjuhë në më shumë vende të dukshme, megjithatë të njëjtat nuk ishin të theksuar në pjesën e brendshme të dhomave për paraburgim.

Gjatë vizitës për ri-kontroll së **SP Radovich** u konstatua se gjendjet, në raport me kushtet në këtë stacion, nuk kanë ndryshuar. Dhomat të cilat ndodhen në bodrum, u hasëm të pastra dhe të bojatisura, por në krevatet nuk kishte dyshekë për ta kaluar natën. MPN konstatoi se dhomat e ndalimit edhe pse nuk i përbushin standardet minimale themelore akoma shfrytëzohen për paraburgim të afatgjatë. Personat e ndaluar kontrollohen në çdo orë dhe informacionet plotësohen në libër të veçantë për zbatimin e kontrollit. Gjatë inspektimit është konstatuar se numri i ndalimeve në këtë stacion policor është shumë i vogël.

Gjatë vizitës për ri-kontroll është vërejtur se informacionet mbi të drejtat e qytetarëve tanimë janë theksuar ashtu siç duhet në dhomën e pritjes (zyra e udhëheqësit të turnit), megjithatë nuk ishin vendosur në pjesën e dhomave për ndalim. Është konstatuar se ka përmirësime në udhëheqjen e evidencës për personat e privuar

nga liria, gjegjësisht në të gjitha lëndët përveç procesverbalit për ndalim dhe procesverbalit për të drejtat e personave ishin të bashkangjitura edhe një numër i madh i dokumenteve që kanë të bëjnë me ndalimin e personit dhe realizimin e të drejtave të tij gjatë procedurës policore. Si shembull pozitiv është ekzistimi i procesverbalit për të drejtën e mjekut. Në të gjitha dosjet, faqja e dytë dhe e tretë e dosjes, ishin të plotësuara siç duhet, me çka mundësohet inspektimi i lehtë dhe pa pengesa i përmbajtjes së dosjes dhe të dokumenteve në përbërjen e saj. Gjatë inspektimit në të gjitha dosjet individuale MPN konstatoi se procesverbali për ndalim udhëhiqet dhe plotësohet plotësisht dhe me rregull. Megjithatë nga të gjitha dosjet e kontrolluara, MPN konstatoi se vetëm te njëra ka rrjedhje logjike të ngjarjes, përdërisa te tri dosjet tjera është konstatuar se e njëjta nuk ekziston.

SP Radovish nuk ka fonde të posaçme për të siguruar ushqim për personat e ndaluar, në pajtim me Procedurat Operative Standarde. Duke i respektuar këto procedura të MPB-së, stacioni policor duhet të disponojë me fonde me të cilat do siguronte vakt (ushqim) për personat e ndaluar.

Në bazë të vizitës së realizuar MPN dha rekomandime plotësuese për stacionin si dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. U dhanë rekomandime për realizimin në kohë të Planit Aksional, me qëllim që në një afat sa më të shkurtër të mundshëm të sigurohen dhoma për ndalim në Stacionin policor Radovish që do t'i plotësojnë standardet ndërkombëtare, të hartohet udhëzim intern për mënyrën e plotësimit të procesverbaleve të reja për ndalim me definicion të qartë të nocioneve (termave) privim nga liria, arrestim dhe ndalim, të sigurohet buxhet i veçantë me të cilin do të përfshihen shpenzimet për ushqimin e personave të privuar nga liria që janë ndaluar në SP Radovish, si dhe të miratohet udhëzim për thirrjen e detyrueshme të avokatit mbrojtës gjatë bisedës dhe ndalimit të fëmijëve në pajtim me Ligjin për të drejtat e fëmijëve.

Në kuadër të vizitave për ri-kontroll ishte përfshirë edhe **SP Gjevgjeli** i cili disponon me dhoma të rinovuara për ndalim të personave të privuar nga liria. Gjatë vizitës për ri-kontroll në orët e natës, të cilën e realizoi MPN u konstatua se numri më i madhi rekomandimeve nga MPN, adresuar deri te Stacioni policor Gjevgjeli, ishin zbatuar. Është konstatuar se ka përmirësime në udhëheqjen e evidencës së personave të privuar nga liria, gjegjësisht në të lëndët në procesverbalin për ndalim kishte rrjedhë logjike të ngjarjes. Gjatë inspektimit të evidencës për *personat e ndaluar*, në një dosje është vërejtur se tek personi me nivel të lartë (promil) të alkoolit në gjak nuk është thirrur mjek. MPN dha një indikacion se stacioni policor detyrimisht duhet të thirr mjek në raste kur konstatohet nivel i lartë i alkoolit tek personi i ndaluar, pavarësisht nëse personi kërkon apo jo ndihmë mjekësore, me qëllim të veprimit parandalues për mbrojtje me kohë të shëndetit të personit të privuar nga liria.

MPN konstatoi se të drejtat e personave të thirrur, të arrestuar dhe të ndaluar ishin vendosur në më shumë gjuhë në pjesën e dhomave për ndalim, si dhe në dhomën për praninë dhe bisedë me personat e ndaluar. Dhoma për marrje në pyetje dhe bisedë me personat e privuar nga liria nuk ishte e pajisur ashtu siç duhet me kompjuter dhe pajisje të tjera teknike. Gjatë inspektimit të tualetit MPN konstatoi se akoma nuk ishin larguar materialet dhe gjërat të cilat nuk janë të sigurta, gjegjësisht të cilat mund të keqpërdoren për lëndime ose vetëlëndime (mbajtëse e metaltë për letër, pasqyrë e thyeshme).

3.2 INSTITUCIONET NDËSHKUESE-KORREKTUESE DHE ENTI EDUKUES-KORREKTUES

Vizita për ri-kontroll janë realizuar në burgjet: **Tetovë, Strumicë, Ohër, Shkup dhe Gjevgjeli**, si dhe në **Entin Edukues-Korrektues Tetovë** me vendndodhje të përkohshme në Veles. Gjatë vizitës në burgjet Tetovë, Strumicë, Ohër dhe Shkup ishte përfshirë edhe një bashkëpunëtor i jashtëm nga Shoqata e Psikiatërve, përderisa vizita në burgun Gjevgjeli u realizua në shoqërimin e bashkëpunëtorëve nga Shoqata e Mjekësisë Ligjore pranë Institutit për Mjekësi Ligjore, si dhe Shoqata për të Drejtën Penale dhe Kriminologji. Në Entin Edukues-Korrektues përveç Shoqatës së Mjekësisë Ligjore dhe Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji ishte përfshirë edhe një bashkëpunëtor i jashtëm nga Dhoma e Psikologëve, duke pasur parasysh edhe rolin edukativo-risocializues që luan ky institucion.

Për shkak të kushteve të hasura në momentin e vizitës së burgut Shkup, si dhe në **Entin Edukues-Korrektues** është dorëzuar edhe një kërkesë deri te Ministria e Drejtësisë për të marrë masa urgjente. Më shqetësuese ishin gjendjet në Entin Edukues-Korrektues. MPN, gjatë vizitave të mëparshme ka dhënë rekomandime për ndarjen e personave të mitur nga të rriturit, në pajtim me standardet ndërkombëtare⁷, ndërsa gjatë vizitës për ri-kontroll është vërejtur se personat e vendosur ndahen vetëm në bazë se a do të vendosen në repartin e hapur apo atë të mbyllur, të ashtuquajtur Reparti për ndikim të përforcuar riedukues (RNPR).

MPN rekomandoi shqyrtimin e të gjitha ankesave për lëndime të mundshme dhe abuzime fizike me qëllim të parandalimit të torturës dhe trajtimit tjetër mizor, por gjatë vizitës për ri-kontroll në bisedë me nxënësit e vendosur në Repartin për ndikim të përforcuar riedukues, si dhe në repartin e hapur, mori ankesa për sjelljen e një pjese të punonjësve në Sektorin e sigurimit. Edhe pse gjatë inspektimit të dokumentacionit mjekësor nuk mundej të konstatohej se në çfarë mënyrë ishin shkaktuar lëndimet tek personat konkret, megjithatë MPN ka shprehur shqetësim sepse përsëri ankesat kanë të bëjnë me personat e njëjtë nga Sektori i sigurimit.

Gjatë bisedës me një pjesë të punonjësve në Sektorin e sigurimit është vërejtur qëndrim ndaj personave të mitur si *persona të dhunshëm, të padëgjueshëm dhe me sjellje vandale, të prirë për ikje dhe të pa motivuar për punë në ekonominë*. Qëndrimi i tillë i punonjësve hap dilemën për zbatimin efikas të procesit të risocializimit dhe nëse të njëjtit nuk kanë qasje pozitive shtrohet pyetja për përshtatshmërinë e masës së vetë institucionit që mes tjerash ka edhe rolin edukues-korrektues.

Për sistem efikas të risocializimit MPN kishte rekomanduar rregullimin e punëtorëve plotësuese, por gjatë vizitës për ri-kontroll është konstatuar se edhe më tej gjendja është e njëjtë, d.m.th. përveç punës në kuzhinë personat e mitur nuk kanë të tjera detyra pune. MPN arriti në përfundim se edhe më tej nuk zbatohet procesi arsimor në Entin Edukues-Korrektues dhe se personat e mitur janë të angazhuar vetëm përmes aktiviteteve të caktuara arsimore, si pjesë e realizimit të disa projekteve.

Pas inspektimit të bërë në kartonët mjekësorë të dy personave të përkujdesur të cilët treguan se kanë pasur probleme mjekësore, është konstatuar se janë plotësuar ashtu siç duhet (gjithmonë shënohet diagnoza e caktuar dhe trajtimi i përshkruar). Në kartonët mjekësorë janë vërejtur dokumente mjekësore nga kontrollet e kryera në institucione të tjera shëndetësore. Edhe pse mjeku gjatë bisedës plotësuese të zbatuar theksoi se fëmijët testohen për Hepatit dhe HIV, kjo nuk ishte shënuar në kartonët mjekësorë. Një nga rekomandimet e MPN në raportin paraprak ishte prezenca e përdit-

⁷ Në rregullat minimale standarde të KB për aplikimin e procedurave gjyqësore kundrejt personave të mitur theksohet se "Të miturit nëpër burgje duhet të jenë të vendosur ndaras nga personat të rritur në institucione të ndryshme ose në pjesë të ndryshme të institucionit në të cilin janë vendosur edhe të burgosur të moshës madhore." Në rregulloren e KP për mbrojtjen e personave të mitur të privuar nga liria qëndron "Në të gjitha vendet për privim nga liria, personat mitur duhet të jenë të ndarë nga personat e rritur, përveç në rast se nuk janë pjesë e familjes së njëjtë".

shme e mjekut në institucion. MPN mori përgjigje nga Drejtoria e Entit se sigurimi i kujdesit shëndetësor për personat e mitur është 24 orësh, ndërsa kur mjeku nuk është prezent gjithnjë thirret Urgjenca. Megjithatë, në përgjigje ishte theksuar se në rastet e izolimit, mjeku vjen çdo ditë, kryen kontrolle mjekësore dhe kthehet me transportin që është i paraparë për tërë turnin. Gjatë vizitës për ri-kontroll dy persona ishin të vendosur në dhomën e izolimit ndërsa mjeku nuk ishte prezent gjatë ditës derisa zgjati vizita.

Në repartin e hapur janë hasur krevate pa dyshekë, si dhe dyshekë të vjetruar të cilët nuk janë të përshtatshëm për përdorim. Të përkujdesurit u ankuan se nuk ka ngrohje dhe se nuk u jepen batanije shtesë gjatë motit të keq. Sa i përket Repartit për ndikim të përforcuar për riedukim nuk janë marrë masa për të rrethuar një pjesë të hapësirës për shëtitje, edhe pse MPN u informua se rekomandimi i njëjtë do të realizohet me sigurimin e fondeve nga buxheti i paraparë për vitin 2013.

MPN konstatoi se Enti Edukues-Korrektues Tetovë ka kryer dezinfektimin e kuzhinës dhe ishte konstatuar higjienë më e mirë në pjesë e përgatitjes së ushqimit. Një pjesë e nxënësve u ankuan për sasinë e ushqimit që e marrin, por pjesa më e madhe ishin të kënaqur nga cilësia e ushqimit të përgatitur. Përveç kësaj, u konstatua se nuk ka dietë të posaçme për nxënësit e sëmurë nga hepatiti. Në kuzhinë ishte theksuar lista javore e ushqimit për personat e vendosur në Entin Edukues-Korrektues Tetovë.

Edhe pse më parë ishin konstatuar kushte sub-standarde në këtë objekt, gjatë vizitës së fundit MPN konstatoi se personat vendosen në kushte nën standardet minimale, dhe veçanërisht shqetësuese është gjendja në Repartin për ndikim të përforcuar riedukues (RNPR), ku përveç gjendjeve të theksuara dhe rekomandimeve të dhëna në raportet paraprake, personat vendosen në dhoma të vjetra të paraburgimit që nuk kanë ngrohje, ventilim, dhe brenda në to ndodhen tualetet, ndërsa lagështia është mbi maksimumin e lejuar, gjegjësisht mbi 70% në dhomat ku të përkujdesurit flenë. Për shkak të kushteve të hasura MPN dorëzoi kërkesë për masa urgjente me të cilat do të përmirësohen kushtet e institucionit, dhe kërkoi realizimin me kohë të Projektit për rekonstruktimin e Institucioneve ndëshkuese-korrektuese (INK) dhe enteve edukuese-korrektuese (EEK), sipas të cilit do të ndërtohet një ent edukues-korrektues me kapacitet prej 84 vende për vendosje.

Gjatë vizitës për ri-kontroll në **burgun Shkup** ishte përfshirë një bashkëpunëtor i jashtëm-psikiatër, në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim me Shoqatën e Psikiatërve të RM. MPN zbatoi vizitë që ishte e fokusuar në disa konstatime negative nga raporti i parë i posaçëm (për pjesën e paraburgimit) i vitit 2011 dhe kontroll për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Gjatë vizitës së rregullt në Burgun Shkup (në pjesën e Repartit të paraburgimit) në vitin 2011 ishin dhënë rekomandime për t'u hetuar të gjitha rastet e dyshimta për torturë të mundshme ose trajtim tjetër brutal dhe jonjerëzor ndaj të burgosurve dhe të paraburgosurve, që të mënjanohet vendosja e një numri të madh të personave në dhomat e paraburgimit në të cilat ka vetëm nga një WC, që të sigurohet dyshek dhe krevat për secilin person të burgosur dhe të paraburgosur, si dhe dhomë e veçantë për kontrollin e personave.

Gjatë bisedës me disa persona të paraburgosur meshkuj dhe femra, si dhe persona të mitur, MPN nuk mori ankesa për dhunë fizike ose abuzim nga shërbimet e burgjeve. Personat e paraburgosur theksuan se Sektori për sigurim ka sjellje korrekte, ndërsa ankesat kryesisht kishin të bëjnë me cilësinë e ushqimit, kushtet e këqija materiale (mbipopullimin), si dhe shëtitjen në ajër të pastër.

Personave të paraburgosur ju mundësohet blerja e ushqimit nga jashtë në pajtim me Rregullin e Shtëpisë për zbatimin e masës së paraburgimit (i paketuar me deklaratë në ambalazh plastike, dhe jo i përgatitur në kushte shtëpiake). MPN nuk mori ankesa për ushqimin për nga aspekti fetar. Është vlerësuar se mjekët japin mendimin e tyre profesional nëse është nevojshme dietë speciale për arsye shëndetësore të paraburgosurve të caktuar. Personat e paraburgosur të gjitha vaktet i konsumojnë në

të njëjtat dhoma ku ata banojnë (nuk ka dhomë të veçantë në formën e një mense ku personat e paraburgosur do të mund të konsumonin ushqimin e tyre).

Numri më i madh i personave të paraburgosur u ankuan për pjesën e hapësirës së kufizuar dhe shumë restriktiv për lëvizje – respektivisht këta persona pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në dhomat e tyre (deri më 23 orë në ditë), ndërsa vetëm 45 minuta, ndonjëherë edhe nga 30 apo 15 minuta qëndrojnë në ambient të hapur, gjë që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore. MPN vlerëson se mosaktiviteti i personave të paraburgosur dhe qëndrimi i tyre në dhomat e tyre deri më 23 orë në ditë është në kundërshtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe është kundër produktiv. Veçanërisht shqetësues është gjatësia e paraburgimit e cila ndikon në shëndetin e personave të paraburgosur, si në shëndetin trupor ashtu edhe në atë mental.

Gjatë vizitës për ri-kontroll MPN ka konstatuar se në repartin për paraburgim gjendja aspak nuk ka ndryshuar dhe akoma ekziston mbipopullimi. D.m.th gjatë vizitës për ri-kontroll u has gjendja në një dhomë ku ishin vendosur 12 persona të paraburgosur, ndërsa në të ka vetëm një WC. MPN vërejti dy persona të cilët nuk kanë krevatat e tyre dhe ishin vendosur që ta kalojnë natën në dyshek të vendosur në dysheme (njëri nga ata ishte person i mitur). Në lidhje me këtë MPN theksoi se vendosja e tillë nuk është në pajtim me rregullat juridike vendore dhe me standardet ndërkombëtare dhe se e njëjta duhet të korrigjohet në mënyrë adekuate. Shqetësuese është gjendja në pjesën e vjetër, krahun B, në të cilin janë të vendosur edhe nga 10 persona në një dhomë, ndërsa gjatë matjes së lagështisë në këtë pjesë ishte matur 65% RH, që është mbi kufirin e standardit maksimal të dëshiruar që është nga 30 deri në 60%. Në pjesët e tjera edhe pse lagështia ishte në nivel më të ulët, megjithatë është e qartë se mbipopullimi sjellë deri te kushtet e vështira për qëndrim, ventilim të dobët, ajër të pamjaftueshëm si dhe mungesë të higjienës brenda dhomave.

Gjatë vizitës kishte disa ankesa nga personat e paraburgosur për sa i përket kujdesit shëndetësor dhe dispozicionit të terapisë medikamentoze (me ilaçe). Në lidhje me këto ankesa u krye një inspektim mbi dokumentacionin mjekësor, gjatë së cilit u konstatua se në të gjitha rastet është mundësuar kujdesi shëndetësor adekuat. Si problem me të cilin ballafaqohet Sektori për kujdes shëndetësor është numri i pamjaftueshëm i personave nga Sektori i sigurimit të cilët e kanë për detyrë që t'i dërgojnë personat e paraburgosur deri në vendet e duhura për kontroll nga specialisti, ashtu që raste të caktuara që nuk janë akute dhe të prioritetit të lartë shtyhen për një periudhë të caktuar, por në mënyrë që nuk do të rrezikohet shëndeti i personave të paraburgosur.

Deri në burgun Shkupi MPN dorëzoi kërkesë për të marrë masa urgjente, ndërsa te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve janë dorëzuar rekomandime për sigurimin e buxhetit më të cilin do të blejnë shtretër për secilin person të paraburgosur (krevat dhe dyshek), si dhe sasi të mjaftueshme të ushqimit të shumëllojshëm, duke pas parasysh trendin e rritjes së rasteve të paraburgimit, por edhe realizimin në kohë të Projektit për rekonstruktimin e INK dhe EEK sipas të cilit do të ndërtohet një repart i ri për paraburgim me kapacitet prej 200 persona, si dhe një repart i mbyllur me kapacitet prej 40 persona.

Në vitin 2013 MPN realizoi vizita për ri-kontroll edhe në: **burgun Tetovë, burgun Strumicë, burgun Ohër dhe burgun Gjevgjeli.**

Në **Burgun Tetovë** vizita u realizua me një bashkëpunëtor të jashtëm – psikiatër, me ç'rast u konstatua se nga rekomandimet e dorëzuara deri te burgu, pjesa më e madhe mbeten të pazbatuara, gjegjësisht varen nga fondet financiare shtesë. MPN vlerësoi se nuk është zbatuar rekomandimi që ka të bëjë me repartin e pranimit dhe në të akoma vendosen kategori të ndryshme të personave të dënuar gjë që mund të sjell deri te infeksioni kriminologjik. Njëkohësisht është konstatuar se nuk është vepruar sipas rekomandimit për marrjen e masave shtesë, me qëllim që të rritet angazhimi me punë i personave të burgosur, si dhe pajisja e një dhome të veçantë dhe adekuate

për bastisje personale të personave të burgosur në pajtim me standardet përcaktuara ndërkombëtare.

MPN konstatoi se nuk ka ndryshime sa i përket përmirësimit të kushteve që ishin kërkuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve. Deri te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ishin dorëzuar rekomandime për përmirësimin e kushteve në Repartin e pranimit, zvogëlimin e mbipopullimit, respektivisht sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për personat e burgosur në përputhje me standardet vendore dhe ato ndërkombëtare, sigurimin e dhomës adekuate për ambulancë për ekzaminime mjekësore, si dhe pajisjen e një dhome adekuate në të cilën personat do të mund ta realizojnë të drejtën e vizitës (kjo e drejtë tani për tani realizohet në hyrjen e burgut pa u mundësuar privatësia gjatë vizitave).

Pas vizitës së majit të vitit 2012, MPN kërkoi nga Drejtoria që të merr masa për hetimin dhe konstatimin në kohë të të gjitha rrethanave në rastet ku personat të cilët e vuajnë masën e paraburgimit ankohen për sjellje jo korrekte dhe kërcënime verbale nga disa punonjës në Shërbimin e sigurimit, si dhe për mënyrën në të cilën zbatohet kontrolli i dhomave, pa pasur konsideratë për gjërat personale të personave. Gjatë vizitës për ri-kontroll nga biseda me personat e paraburgosur MPN nuk mori ankesa për trajtim mizor, jonjerëzor apo degradues, as për sjellje jo korrekte të punonjësve në Shërbimin e sigurimit.

Gjithashtu ishte konstatuar se është vepruar sipas rekomandimit të dhënë për përforcimin e kontrollit mbi punën e personelit mjekësor si dhe vizita e përditshme e mjekut personave të cilët kanë qenë në dhomën e izolimit, gjegjësisht në burg është punësuar një mjek, dhe më këtë, në këtë institucion, dukshëm është përmirësuar përkujdesi shëndetësor. MPN konstatoi se është vepruar edhe sipas rekomandimit për vendosje të një sënduk i veçantë për paraqitjen e personave të burgosur për kontroll mjekësor.

Në **Burgun Strumicë** u realizua vizita për ri-kontroll së bashku me një bashkëpunëtor të jashtëm nga Shoqata e Psikiatërve të RM. Gjatë vizitës MPN bisedoi me disa persona të burgosur të vendosur në ambient gjysmë të hapur / të hapur të cilët theksuar se Sektori i sigurimit ka sjellje korrekte, njëherësh ishin të kënaqur edhe nga sjellja e Sektorit për risocializim. Gjatë bisedës me personat e vendosur në dhomat e izolimit MPN u informua se punonjësit në Sektorin e sigurimit gjatë kryerjes së kontrollit janë kërcënuar, gjithashtu, një personit nuk i është lejuar të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore dënim në dhomën e izolimit. Nga Sektori për risocializim MPN u informua se të gjithë personat të cilëve iu shqiptohet masa disiplinore ju tregohet për të drejtën e për ankesë kundër vendimit të marrë. Një person i burgosur i vendosur në dhomën e izolimit tregoi se ishte shtyrë nga gardianët, si dhe ishte i goditur në shpinë. Njëherësh ishte theksuar se një pjesë e punonjësve në Sektorin e sigurimit i kanë ofenduar personat e dënuar me fjalë fyese.

Në vitin 2012 MPN mori ankesë për abuzim fizik dhe poshtërim nga shërbimi i sigurimit. Gjatë vizitës për ri-kontroll pjesa më e madhe e personave të dënuar ishin të kënaqur nga sjellja e shërbimit, por megjithatë një pjesë e personave të vendosur në dhomat e izolimit të cilëve ju ishte shqiptuar masa disiplinore u ankuan nga sjellja e kryeshefave nga Sektori i sigurimit. Në lidhje me këtë MPN vlerësoi se rekomandimi i dhënë pjesërisht është zbatuar që edhe më tej kërkon hetim efikas dhe në kohë të të gjitha rasteve të mundshme të abuzimit fizik, d.m.th torturë ose lloj tjetër i trajtimit mizor dhe jo njerëzor.

MPN konstatoi se një pjesë e rekomandimeve të dhëna pjesërisht ose plotësisht janë zbatuar. Rekomandimet që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor, përmirësimin e kushteve në dhomat e izolimit, vendosja e sistemit për thirrje, si dhe siguri i një dhome të veçantë për kontrollin e personave të dënuar, nuk ishin plotësuar.

Gjatë bisedës me mjekun, si dhe nga inspektimi i dokumentacionit mjekësor

është konstatuar se i njëjti i viziton personat që janë në vuajtje të dënimit disiplinor në dhomën e izolimit vetëm ditën e martë dhe të premte kur e viziton burgun, por në këtë mënyrë nuk zbatohet obligimi që del nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, i paraparë në nenin 181 paragrafi 4, ku është konstatuar se personin e dënuar për çdo ditë e viziton mjeku, ndërsa drejtori i institucionit një herë në javë. Edhe pse MPN ishte i njoftuar që vetëm mjeku ka qasje në dokumentacionin mjekësor, gjatë inspektimit të drejtpërdrejtë është konstatuar se qasje kanë punonjësit, ndërsa vetë mjeku nuk ishte i njoftuar me rekomandimin paraprak për konfidentalitetin e dokumentacionit mjekësor.

Në burg nuk kishte dhomë të veçantë për zbatimin e kontrollit nga mjeku. Një gjendje e tillë është përmendur edhe në raportin e vitit të kaluar. Për këtë qëllim është shfrytëzuar dhoma ku është vendosur biblioteka. Nga vizita u arrit në përfundim se dhoma nuk i plotëson standardet minimale për ambulancë mjekësore. Ligji për kujdesin shëndetësor parashikon që dhoma në të cilën bëhen kontrollet të jetë së paku 16 m², të ketë ujë të rrjedhshëm dhe ndriçim të mirë. Sa i përket orëdive, duhet të jetë e pajisur me tavolinë pune, dy karrige rrotulluese, njëra për mjekun tjetra për pacientin, krevat mjekësor, paravan, dollap në të cilin ruhet terapia dhe trajtimi antishok.

Në Burgun Strumicë nuk realizohet arsimimi në përputhje me obligimin që del nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve. Sipas të dhënave nga Sektori për risocializim në burgun Strumicë 60% e të burgosurve e kanë të kryer shkollën fillore. Sektori me iniciativë të vetë një pjese të personave të dënuar u ka mësuar shkrim leximin, ndërsa burgu ka siguruar libra, fletore dhe lapsa për të shkruar.

Pas realizimit të vizitës, Avokati i Popullit – MPN kërkoi nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve që të realizojë mbikëqyrje të jashtëzakonshme profesionale nga instruktorët në lidhje me kujdesin shëndetësor të personave të dënuar, dhe e njëjta është realizuar me 29.05.2013.

Në bazë të mbikëqyrjes së realizuar është lëshuar Urdhër nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve me të cilin drejtori i burgut detyrohet:

- Të bëjë sanimin dhe rinovimin e të dy dhomave (bibliotekës dhe kuzhinës së personelit të burgut) në një dhomë, e cila do t'i plotësojë kushtet për funksionimin e ambulancës (klinikës).

- Të sigurohet evidencë e drejtë e të gjitha kontrolleve mjekësore të kryera të personave të dënuar dhe të sigurojë pa pengesë realizimin e të drejtës së konfidentalitetit të dokumentacionit mjekësor të personave të dënuar në institucion.

Njëherësh, gjatë mbikëqyrjes së kryer nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve me kërkesë të Avokatit të Popullit – MPN, drejtori i burgut ka informuar se gjatë kujdestarisë nuk kryejnë më ekzaminime mjekësore dhe se është siguruar një dollap i posaçëm për ruajtjen e dokumentacionit mjekësor.

Në **Burgun Ohër**, MPN u shoqërua nga një përfaqësues i Shoqatës së Psikiatërve të RM. Gjatë vizitës paraprake ishte dhënë rekomandim që të mos përdoren dhomat ku vuhet masa e izolimit, sepse të njëjtat janë nën standardet minimale, dhe edhe pse ishte dhënë përgjigje se ato nuk do të përdoren deri në rinovimin e tyre, gjatë vizitës për ri-kontroll u konstatua se ato akoma përdoren. D.m.th. gjatë vizitës MPN hasi në dy persona të dënuar të cilët e vuajnë masën disiplinore të izolimit në dhomat e njëjta. Nga inspektimi në dhomat e izolimit MPN konstatoi se gjendja e tyre nuk ka ndryshuar, gjegjësisht të njëjtat nuk ishin rinovuar dhe në to edhe më tej mbahen persona edhe pse nuk i plotësojnë standardet minimale. Në këtë drejtim MPN u thirr në Rregullat e OKB për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria në të cilat, në pikën 67 thuhet se *...“masat disiplinore që përmbajnë trajtim mizor, jonjerëzor dhe degradues rreptësisht duhet ndaluar, dhe në të cilat përfshihet edhe dërgimi në dhomën e izolimit ose cilado formë tjetër e dënimit me të cilën mund të rrezikohet shëndeti fizik dhe mental i personave të mitur“.*

Në pjesën e rekomandimeve të tjera, MPN arriti në përfundim se nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi për hetimin e të gjitha shkeljeve të mundshme nga punonjësit e Shërbimit të sigurimit dhe vendosjen e trajtimit njerëzor dhe dinjitoz ndaj personave të privuar nga liria. Gjatë bisedës me personat e paraburgosur MPN nuk mori ankesa, por kishte ankesa nga personat e vendosur në dhomat e izolimit të cilët u ankuan për sjelljen e punonjësve në Shërbimin e sigurimit, si dhe për kujdesin mjekësor përderisa e vuanin masën e shqiptuar. MPN bisedoi edhe me disa persona të dënuar nga reparti i mbyllur dhe i hapur/gjysmë i hapur. D.m.th. një person i vendosur në repartin e mbyllur konsideronte se sjellja e punonjësve në Sektorin e sigurimit nuk është korrekt, sepse disa persona nga i njëjti sektor ndaj tyre janë sjellë keq dhe në mënyrë ofenduese.

Gjatë vizitës për ri-kontroll në burgun për personat e mitur, MPN nga biseda me drejtorin e burgut u informua se ka vetëm një person të mitur që ka qenë i vendosur në repartin e mbyllur së bashku me persona të rinj të moshës madhore. Në këtë drejtim MPN konsideron se autoritetet e burgut e kanë ndjekur parimin për interesin më të mirë të fëmijës për faktin që atë e ka vendosur me persona të rinj të moshës madhore, njëherit nuk ka qenë tërësisht i ndarë, por megjithatë thekson se në rast të një numri më të madh të personave të mitur, drejtoria duhet t'i merr të gjitha masat për t'i ndarë nga personat e rritur.

Në pjesën e paraburgimit është vërejtur mbipopullim. Personat e paraburgosur u ankuan në lidhje me hapësirën e kufizuar të lëvizjes dhe shumë restriktive – d.m.th. këto persona pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në dhomat e tyre (edhe deri në 23 orë në ditë), dhe vetëm nga një orë, dhe ndonjëherë edhe nga 30 minuta qëndrojnë jashtë në ambient të hapur gjë që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore.

Gjatë bisedës me Sektorin për risocializim MPN mori përgjigje se rregullisht zbatohet edukimi i personave të dënuar, sidomos për sëmundjet ngjitëse dhe mënyrën e mbrojtjes nga to nga OJQ dhe Kryqi i kuq. Gjatë vizitës për ri-kontroll MPN konstatoi se numri i të sëmurëve nga Hepatiti B është reduktuar, më saktë gjatë vizitës kishte vetëm 5 persona të sëmurë. Autoritetet e burgut kanë marrë masa për parandalim dhe kanë bërë vaksinimin edhe të punonjësve në burgun për persona të mitur.

Në lidhje me rekomandimet deri te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve është vlerësuar se nuk janë zbatuar, më saktësisht është konstatuar se në burg nuk është kryer rinovimi i atyre pjesëve që u vlerësuan si vende që nuk i plotësojnë standardet për vendosjen e personave të privuar nga liria, dhe pas dorëzimit të rekomandimit për rinovimin e dhomave të izolimit MPN ka vërejtur se nuk ka ndryshime, gjegjësisht Drejtoria nuk ka marrë masa për sanimin e tyre.

MPN ka konstatuar se rekomandimi që të rritet buxheti për ushqim nuk është zbatuar, dhe gjatë bisedës me të burgosurit ka marrë ankesa për sasinë dhe cilësinë e ushqimit. E njëjta ankesë u bë edhe nga të paraburgosurit të cilët u ankuan se ju ndahet pak ushqim, ndërkaq gjatë vizitës është vërejtur se numri i personave të vendosur në paraburgim gjithnjë rritet që imponon nevojën për rritjen e buxhetit për ushqim. Në burgun Ohër edhe në vitin 2013 ishte konstatuar se procesi arsimor nuk zbatohet.

Pas vizitës së realizuar, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional kërkoi nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të zbatojë mbikëqyrje të jashtëzakonshme profesionale nga instruktorët në lidhje me dhomat e izolimit. Në të vërtetë, gjatë vizitës për ri-kontroll, MPN ka konstatuar se dhomat e izolimit akoma shfrytëzohen gjatë shqiptimit të masës disiplinore, për të cilat më parë ishte udhëzuar se janë jo humane dhe degraduese, nuk plotësojnë minimumin e standardeve ndërkombëtare dhe vendore dhe të njëjtat duhet të jenë jashtë përdorimit. Nga mbikëqyrja e kryer në Burgun Ohër, është konstatuar se dhomat e izolimit nuk shfrytëzohen më, gjegjësisht janë jashtë përdorimit. Më saktë, me 27.05.2013, nga drejtori i burgut Ohër është marrë urdhri me të cilin ndalohet përdorimi i dhomave të izolimit në burg derisa të rinovohen.

Në **Burgun Gjevgjeli** vizita u realizua së bashku me bashkëpunëtorë nga Shoqata e Mjekësisë Ligjore pranë Institutit për Mjekësi Ligjore dhe Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji.

MPN gjatë vizitës për ri-kontroll konstatoi se në Burgun Gjevgjeli edhe më tej nuk ka mjek të punësuar, ndërsa qasje në kartonët e shëndetësor ka Sektori i sigurimit. Kujdesi shëndetësor realizohet përmes angazhimit të mjekut me kontratë në vepër.

Gjatë bisedës me të dënuarit pjesa më e madhe u ankuan për ushqimin jo cilësor, gjegjësisht marrjen e ushqimit të njëllojshëm që shërbehet në burg. Nga inspektimi i listës së ushqimit është konstatuar se janë caktuar ushqime të pasura me proteina dhe se ushqimi është i shumëllojshëm. Nga drejtori i burgut u paraqit një dokument edhe për marrjen e shtupave (bris) të rregullt të personave të cilët janë të angazhuar në kuzhinë dhe rezultatet e tyre më tej do të futen në librezat sanitare.

Gjatë vizitës për ri-kontroll në burgun Gjevgjeli, MPN arriti në përfundimin se kushtet në pjesën e paraburgimit, si dhe në pjesën e izolimit janë të njëjta, gjegjësisht edhe më tej nuk i plotësojnë standardet e dëshiruara për dhoma ku vendosen persona të privuar nga liria. Gjithashtu MPN konstatoi se ambienti për shëtitje nuk është i rrethuar me qëllim të përdorimit gjatë motit të lig. Në shëtitore janë vendosur karrige për të pushuar me pjesë të mbuluar me kallam, terren për sport, dhe në ambientin e njëjtë të burgosurit ushtrojnë ngritje peshe.

Gjatë vizitës së parë MPN ka vërejtur se pjesa më e madhe e të dënuar dhe personave të paraburgosur nuk kanë ankesa për sjelljen e punonjësve, por gjatë vizitës për ri-kontroll në repartin gjysmë të hapur një pjesë e të dënuarve u ankua për sjelljen e disa punonjësve. MPN shprehu shqetësim për shkallën dhe efikasitetin e masave që merren nga institucioni, me qëllim që të zvogëlohet, gjegjësisht të parandalohet sjellja jo njerëzore dhe mizore ndaj personave në burg.

Nga biseda me personat e paraburgosur nuk kishte ankesa për përdorimin e tepruar të forcës ose se ishin trajtuar në mënyrë jo njerëzore. Personat në paraburgim janë ankuar për kushte në të cilat gjenden, se të njëjtit nuk kanë shtrojë, krevatet janë të vjetruar, ndërsa dhomat të pamjaftueshme për vendosjen e më tepër personave. Gjatë bisedës me punonjësit e Sektorit të sigurimit, si dhe gjatë kryerjes së inspektimit është vërejtur qëndrimi i punonjësve ndaj të dënuarve se bëhet fjalë për "narkomanë", "kriminelë", ndërsa për një person drejtpërdrejtë është thënë se ka Hepatit B, edhe pse personi pretendonte se një gjë e tillë nuk është e vërtetë. Punonjësit theksuan se të dënuarit kanë sjellje të dhunshme dhe nuk duan të bashkëpunojnë gjë që e vë në pikëpyetje procesin e risocializimit.

MPN gjatë vizitës për ri-kontroll dërgoi edhe rekomandime të reja në lidhje me risocializimin, kujdesin shëndetësor, si dhe me marrjen e masave më efektive për sanksionimin e zyrtarëve për të cilët do të konstatohet se kanë kryer dhunë ndaj personave të dënuar.

3.3 INSTITUCIONE PËR PËRKUJDESJEN DHE VENDOSJEN E TË HUAJVE, MIGRANTËVE ILEGALË DHE AZILKËRKUESVE

Theks i veçantë në vitin 2013 u vu mbi situatën me migrantët e paligjshëm dhe azilkërkuesit, duke pasur parasysh se gjithnjë e më tepër po rritet numri i kësaj kategorie që vijnë nga vendet me konflikte dhe të cilët kalojnë nëpër vend deri në destinacionet e dëshiruara. Në vitin 2013 janë realizuar vizita për ri-kontroll në Qendrën e Vendosjes së Kërkuesve të së Drejtës së Azilit, si dhe në Qendrën e Pranimit të të Huajve. Vizita për ri-kontroll në Qendrën për të huaj u realizua në shoqërim me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj e cila është regjistruar si Shoqatë për Ndhimë

Juridike Falas.

Gjatë vizitës në **Qendrën e Vendosjes së Kërkuesve të së Drejtës së Azilit**, janë hasur 85 persona – azilkërkues të shpërndarë në të dy ndërtesat. Në hyrje të ndërtesës së parë për vendosjen e personave azilkërkues, rruga ishte pjesërisht e dëmtuar dhe shembur, ndërsa ndërtesa e shkatërruar dhe në gjendje edhe më të keqe nga vizita e mëparshme e realizuar në dhjetor 2011. Në ndërtesën e parë janë vërejtur dhoma të pista (të papastërta) në të cilat njëherit dukej edhe sasia e madhe e lagështisë, në disa dhoma dritaret ishin të thyera, dhe një pjesë e tualeteve ishin plotësisht të shkatërruara, të pista dhe jashtë përdorimit. Tualetet ishin të papërshtatshëm dhe MPN arriti në përfundim se paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse. Në disa dhoma orenditë ishin tërësisht të shkatërruara, ndërsa në disa korridore është vërejtur sasi e madhe e mbeturinave. Mensat e vogla ishin të pista dhe të papërshtatshme, ndërsa në ndërtesën e dytë kapacitetet e vendosjes ishin në gjendje më të mirë dhe me një nivel të higjienës më të theksuar.

Edhe në përgjigjen e Qendrës u theksua se për mirëmbajtjen e higjienës është angazhuar një pastruese, gjatë vizitës për ri-kontroll ishte e qartë se mirëmbajtja e higjienës varet kryesisht nga personat e vendosur të cilët njëherit nuk trajnohen për aftësitë themelore jetësore të nevojshme për higjienë, si dhe mënyra e jetës e parapare me Rendin e Shtëpisë të qendrës. Në lidhje me Rendin e Shtëpisë nga drejtorja e Qendrës u tha se i njëjti përkthehet në UNCHR në më shumë gjuhë të cilat përdoren nga personat azilkërkues, ndërkaq aktualisht po përpilohet rendi i ri shtëpiak i cili do të përcaktojë edhe veprimet në lidhje me dhunën fizike ndërmjet azilkërkuesve. Gjatë bisedës me personat e vendosur, njëri nga ata theksoi se ka marrë Rendin shtëpiak në gjuhën frënge, ndërsa një pjesë e tyre theksuan se gjatë pranimit nuk kanë marrë informacione të mjaftueshme për të drejtat që i kanë derisa janë të vendosur në Qendër, ndërkaq një pjesë e tyre janë informuar ndërmjet veti për Rendin e Shtëpisë së institucionit.

Në bazë të bisedës së realizuar me punonjësit, MPN u njoftua se në këtë Qendër punojnë 10 persona dhe për të siguruar resurse njerëzore shtesë Qendra bashkëpunon me organizatat civile dhe në këtë mënyrë siguron punëtorë social, edukator dhe mësues të gjuhës maqedonase. Në institucion është i punësuar edhe një psikolog me kontratë në vepër. Në institucion nuk ka të punësuar jurist dhe akoma është e angazhuar vetëm një pastruese dhe një roje për kapacitetet e vendosjes. Në këtë drejtim MPN vlerëson se numri i resurseve njerëzore të qendrës në bashkëpunim me sektorin civil është rritur, por si çështje shtrohet qëndrueshmëria e këtyre resurseve dhe ndërtimi i kapaciteteve që do të ishin të punësuar në kohë të pacaktuar në Qendrën për vendosjen e personave azilkërkues.

Gjatë vizitës së MPN në vitin 2013 është konstatuar se Qendra ka lidhur kontratë me një ambulancë me ç'rast mjeku i viziton personat dhe kryen e ekzaminime të martën dhe të enjten, përderisa infermierja është angazhuar përmes sektorit joqeveritar dhe e njëjta është prezente të hënën, të mërkurën dhe të premten. Në këtë mënyrë është siguruar që çdo ditë të ketë personel mjekësor nga ora 12:00 deri në ora 15:00, por ekzaminimet bëhen vetëm nëse personat vetë kërkojnë të kontrollohen për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën gjenden. Edhe pse nga MPN është dhënë rekomandim që të punësohet një mjek i rregullt i cili për çdo ditë do të ishte prezent në Qendër, gjendja aktuale mundëson qasje të kufizuar të personelit mjekësor prej 3 orësh në ditë, me ç'rast nuk bëhet kontrolli i parë i personave kur ata arrijnë dhe vendosen në qendër. Nga infermierja është thënë se ajo nuk merr listë të personave të rinj të pranuar që të mund të bëhet kontrolli sistematik i parë dhe të konstatohet gjendja shëndetësore e personave që qëndrojnë në qendër.

MPN bisedoi me disa persona të vendosur në Qendër, të cilët u ankuan për cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

Gjatë vizitës për ri-kontroll në **Qendrën për pranimit të të Huajve** ishin ven-

dosur 74 persona nga të cilët 5 femra dhe disa persona të mitur. Gjatë bisedës me disa persona meshkuj dhe femra, si dhe me personat e mitur, MPN nuk mori ankesa për sjellje të keqe, dhunë fizike ose abuzim nga zyrtarët.

Personat e huaj theksuan se policët kanë sjellje korrekte ndaj tyre, ndërsa pjesa më e madhe e ankesave kishin të bëjnë me atë se nuk u lejohej të kontaktojnë familjet e tyre, me ç'rast njëri theksoi se tani 2 muaj është vendosur në Qendër, dhe se akoma nuk i kanë lejuar që ta kontaktojnë familjen për ta informuar se është vendosur dhe se është në gjendje të mirë shëndetësore. Gjithashtu, ankesat kishin të bëjnë me anulimin e procedurave, si dhe mos informimi për atë se sa do të zgjatë procedura dhe për kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në Qendër.

Përveç kësaj MPN ka konstatuar se Rendi i Shtëpisë nuk mund të zbatohet në tërësi, sa i përket realizimit të shëtitjes së personave të ndaluar. Edhe pse me ndryshimet e Rendit shtëpiak është caktuar që shëtitja të jetë në ajër të pastër për një orë, megjithatë edhe nga Drejtoria edhe nga personat e vendosur kemi informacion se është vështirë që kjo dispozitë të zbatohet për shkak se ka mungesë të punonjësve, si dhe për shkak të vet lokacionit të Qendrës, me ç'rast ekziston rreziku nga ikja e migrantëve të paligjshëm të ndaluar. Në këtë drejtim MPN vlerëson se mungesa e resurseve njerëzore nuk duhet t'i kufizojë të drejtat e migrantëve të paligjshëm derisa janë të vendosur në Qendrën e pranimit. Njëherit është konstatuar se lokacioni është jo adekuat për një institucion të tillë dhe se qasja tek i njëjti është vështirësuar në masë të konsiderueshme, me ç'rast shtrohet pyetja për arritjen e shpejtë të automjeteve gjatë situatave urgjente (Qendra nuk disponon me automjet transportues të vet dhe për shoqërim përdoren furgonet e stacioneve policore).

Pjesa më e madhe e personave të vendosur nuk kishin ankesa në lidhje me ushqimin, gjegjësisht ata janë të kënaqur me atë, por të njëjtit u ankuan se nuk marrin mjete të mjaftueshme për pastrim, si dhe mjete për higjienë personale. MPN mori ankesa edhe në lidhje me ujin e ngrohtë për dush, më saktësisht një person theksoi se më tepër se dy javë nuk kanë ujë të ngrohtë në dushet, me çka është vështirësuar mirëmbajtja e higjienës personale të personave të vendosur. Gjithashtu është vërejtur se pjesë më e madhe e tyre nuk kanë veshje të duhur të përshtatshme ndaj motit.

MPN arriti në përfundim se pjesa më e madhe e rekomandimeve të dhëna nuk janë zbatuar nga institucioni. Gjatë vizitës për ri-kontroll është konstatuar se në dhomën e izolimit krevatet nuk janë të fiksuara për dysheme, nuk është caktuar protokoll i shkruar për të vepruar në raste të dhunës fizike dhe incidenteve ndërmjet personave të vendosur në qendrën e pranimit dhe akoma në Qendrën nuk janë plotësuar standardet ndërkombëtare në lidhje me numrin e kapaciteteve të vendosjes, gjegjësisht të shtretërve në dhomat për vendosje. MPN ka informacion se Rendi i Shtëpisë nuk është i përkthyer, por procedura e përkthimit të cilën do ta zbatojë UNHCR është në realizim e sipër dhe së shpejti do të jetë në dispozicion të personave të vendosur në Qendrën.

3.4 VENDE TË TJERA

Në vitin 2013, përveç vizitave standarde të vendeve ku personat privohen nga liria, MPN realizoi vizita për ri-kontroll edhe në institucion të hapura (de facto institucione ku liria e lëvizjes është e kufizuar), me qëllim që të konstatojë trajtimin e kategorive vulnerable të personave, kryesisht të personave me aftësi të kufizuara, dhe të fëmijëve. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e në lidhje me punën me kategorinë prekshme, si dhe nevoja për ekspertizë në fushën e trajtimit të fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuara, dhe duke u nisur sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës për Personat me Aftësi të Kufizuara, gjatë vizitave për ri-kontroll ishin

u përfshinë bashkëpunëtorët e jashtëm nga Shoqata e Punëtorëve Social të Qytetit të Shkupit, Dhoma e Psikologëve si dhe nga Lidhja e Defektologëve të RM.

Në këtë aspekt në vitin 2013 u realizuan dy vizita për ri-kontroll në Institucionin Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale Shkup, një vizitë në Institucionin për Përkujdesje, Edukim dhe Arsimit të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Milanoviq", si dhe një vizitë në Entin Special Demir Kapia – Institucion për Persona me Pengesa në Zhvillimin Mendor ku sigurohet vendosja, përkujdesi, kujdesi shëndetësor, rehabilitimi, terapia e punës dhe angazhimi në përrputhje me aftësitë dhe gjendjen shëndetësore të përdoruesve.

Vizita e parë në Institucionin Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale Shkup është realizuar gjatë orarit të rregullt të punës, ndërsa vizita e dytë është realizuar në orët e mbrëmjes. MPN gjatë vizitës së parë për ri-kontroll ka konstatuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve të MPN janë zbatuar ose pjesërisht janë zbatuar. Në këtë drejtim është konstatuar se repartet ishin rinovuar (reparti për observim, reparti i parë dhe i dytë për meshkuj dhe reparti i përzier) dhe tek të njëjtët ishin vendosur dyer dhe dritare të reja, krevate të ri etj.

MPN për shkak të parandalimit të dhunës ndërmjet të përkujdesurve paraprakisht ka kërkuar nga Drejtoria mbikëqyrje të përforcuar dhe vendosjen e protokolleve të veçantë për parandalimin e dhunës midis të miturve të vendosur në Institucion, si dhe regjistrim në një regjistër/libër të veçantë. Gjatë vizitës për ri-kontroll është konstatuar se nuk udhëhiqet regjistër i veçantë për dhunë fizike ndërmjet fëmijëve dhe për rastet e vetëlëndimit. Drejtoria ka filluar me përpilimin e procedurave interne dhe udhëzimeve për procedurat themelore të punës, por akoma nuk zbatohen protokolle për parandalimin e dhunës midis të përkujdesurve të vendosur në këtë Institucion.

Nga këqyrja e listës së të përkujdesurve është konstatuar se Institucionin Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale edhe më tej, dhe në kundërshtim me rekomandimin e MPN, vazhdojnë të udhëzohen dhe të kujdesen persona të mitur kryerës të veprave penale (të moshës 14 deri 18 vjet). Në mënyrë që të zvogëlohet mundësia nga ndikimi negativ dhe përhapja e infeksionit krimnologjik, MPN nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale ka kërkuar që në Institucionin publik të përkujdesen kryesisht persona të mitur me probleme edukativo-sociale.

Gjatë vizitës së dytë për ri-kontroll që u realizua në orët e mbrëmjes, MPN realizoi më shumë biseda me të përkujdesurit e vendosur në këtë institucion, me qëllim që të përcaktojë se në çfarë mënyrë trajtohen ata dhe nëse kanë ankesa për sjelljen e punonjësve. Gjatë vizitës në Institucion prej gjithsej 36 të përkujdesur, mungonin 12 nga të cilët vetëm 2 me arsye, ndërsa të tjerët ishin në arrati. Prezenca dhe mungesa ishte regjistruar ashtu siç duhet në librin e kujdestarisë nga edukatorët e turnit paraprak. Në vendin e punës ishte vetëm një edukator, i cili njëherit gjatë natës është angazhuar si gardian.

Në interes të MPN ishte që të njoftohet për kategorinë e personave që vendosen, duke pasur parasysh rekomandimin e dhënë që në Institucionin publik për përkujdesje të fëmijëve ekskluzivisht të udhëzohen dhe të kujdesen persona të mitur me probleme edukativo-sociale, por jo dhe kryerës të veprave penale ose fëmijë kryerës të veprave të cilat me ligj janë të parapara si vepra penale. Nga edukatori, MPN-ja u njoftua se edhe më tej në këtë institucion vendosen kategori të ndryshme të të përkujdesurve.

Me qëllim që të vlerësohet se si zhvillohet mbikëqyrja e personave të mitur gjatë natës u njoftua se dyert e institucionit pas orës 21:00 mbyllen, dhe njëherit punonjësi social udhëheq regjistrin e akteve të dhunës.

Duke marrë parasysh se në raportet e kaluara mbikëqyrja e përforcuar është kërkuar për grupin trajnues, sidomos për kontrollin e futjes së alkoolit dhe cigareve në këtë pjesë të objektit, gjatë vizitës MPN konstatoi se ka përmirësime sa i përket higjienës dhe mirëmbajtjes së dhomave në grupet e trajnimit, në to nuk janë vërejtur alkool ose cigare, ndërsa gjatë bisedës me të përkujdesurit u njoftua se ata janë të

kënaqur me kushtet. Sa i përket trajtimit të tyre, ata u shprehën të kënaqur nga qasja e drejtorit dhe të punonjësve, ata pa u penguar kanë mundësi të kontaktojnë familjen para së gjithash prindërit, por u ankuan për dhunën e një pjese të të përkujdesurve dhe vlerësojnë se duhet të merren masa adekuate që e njëjta të largohet.

Për dallim nga vizita në Institucioni Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale, ku edhe gjatë dy vizitave u has numër më i madh i fëmijëve të përfshirë në aktivitete edukativo-arsimore, gjatë vizitës në **Institucionin Publik "Ranka Milanović"** - u hasën vetëm dy persona, kurse të tjerët ishin në arrati.

Institucioni, në pajtim me nenin 120 të Ligjit për kujdes social, është i detyruar që për shfrytëzuesit të sigurojë kushte të përshtatshme për vendosje, ushqim, zbatim të përmbytjeve të planifikuara dhe të organizuara, masa dhe aktivitete në procesin e edukimit dhe arsimimit të tyre, aktivitete të lira dhe jetë kulturore-zbavitës, si dhe të kujdeset për jetën dhe shëndetin e shfrytëzuesve të vendosur në institucion.

MPN gjatë vizitës për ri-kontroll konstatoi se asnjëri nga dy të përkujdesurit e pranishëm (nga të cilët njëri duhet të jetë klasa e VII, dhe tjetri në viti I në shkollë të mesme) nuk vijojnë mësimin. Nga inspektimi i kryer u konstatua se nuk është zbatuar rekomandimi që ka të bëjë me motivimin për përfshirje në procesin arsimor, dhe as për organizimin e trajnimeve të llojllojshme për aftësim, duke filluar nga trajnimet më themelore për aftësitë jetësore, trajnime për motivimin e fëmijëve, trajnime për zhvillimin e aftësive teknike, seminare të specializuara dhe trajnime për fëmijët në fushën e shëndetit seksual-reproduktiv.

MPN realizoi inspektim në disa dhoma në repartin e meshkujve, me ç'rast konstatoi se të njëjtat akoma nuk janë të pajisura sa duhet dhe në to ka vetëm krevate dhe dollapë të dëmtuar. Gjatë inspektimit u konstatua se higjiena në dhoma nuk mirëmbahet rregullisht dhe nuk ishte në nivel të kënaqshëm.

Gjatë kësaj vizite, MPN kërkoi përfshirje më të madhe të familjeve / kujdestarëve në trajtimin e shfrytëzuesit dhe mbajtjen e një liste për përcjelljen e pjesëmarrjes së prindit / kujdestarit në trajtimin e shfrytëzuesit. Në lidhje me kujdesin shëndetësor u dhanë rekomandime që të realizohen ekzaminime shëndetësore parandaluese të të përkujdesurve, për konstatimin e gjendjes së tyre shëndetësore, që të parandalohet përhapja e sëmundjeve seksuale ngjitëse përmes vaksinimit për Hepatit B dhe të punësohet një person mjekësor, me qëllim të kujdesit shëndetësor në kohë për të përkujdesurit e vendosur në Institucion.

Vizita në **Entin Special Demir Kapi** është realizuar me bashkëpunëtorë nga Shoqata e Defektologëve të RM. Enti Special në Demir Kapi në përputhje me procedurat pozitive-juridike në fuqi është institucion për vendosjen e personave me pengesa në zhvillimin mental që siguron vendosje, kujdes, kujdes shëndetësor, rehabilitim, terapi të punës dhe angazhimit në përputhje me aftësitë dhe gjendjen shëndetësore të tyre.

Monitorimin e institucioneve ku vendosen shfrytëzuesit me pengesa të rënda dhe shumë të rënda në zhvillimin intelektual, MPN e realizon me qëllim të përcaktimit të rrezeve dhe veprimeve që mund të çojnë deri te tortura ose trajtimet tjera mizore, jonjerëzore dhe degraduese, monitorimin e realizimit të të drejtës së tyre për liri dhe siguri, pastaj të konstatojë nëse shfrytëzuesit janë nënshtruar trajtimit mjekësor pa pëlqimin e tyre të dhënë lirshëm dhe të bazuar në informacione, realizimi i të drejtës së tyre për kujdes shëndetësor, si dhe përcaktimi i kushteve në të cilat këto persona banojnë (kushte materiale, veshmbathje, ngrohje, ushqim, kushte sanitare etj).

Gjatë vizitës për ri-kontroll MPN konstatoi se rinovimi i bllokut A që së shpejti duhet të lëshohet në përdorim është në fazën përfundimtare, për të cilin MPN dha rekomandim në pjesën për përmirësimin e kushteve materiale. Edhe pse në shumicën e reparteve është konstatuar përmirësim i kushteve edhe më tej gjendja në aneksin e ndërtesës (Depandans) është vlerësuar të jetë shqetësuese. Në pjesën për vendosje të aneksit të ndërtesës është konstatuar temperaturë e ulët, gjegjësisht dhoma me ngrohje të pamjaftueshme sipas standardeve të dëshiruara. Në shumicën e dhomave

ishin të vendosur nga 6 persona, ndërsa në disa dhoma ndjehej erë e keqe e fortë e urinës. Në pjesën e njëjtë është konstatuar edhe rritje e numrit të shfrytëzuesve për shkak të rinovimit të objekteve të tjera, gjegjësisht një pjesë e të përkujdesurve të repartit A ishin transferuar në këtë objekt.

Gjatë vizitës MPN vërejti edhe kthimin e një shfrytëzuesi që me procesin e de-institucionalizimit ishte transferuar në qendrën e kujdesit ditor jashtë Entit, por nuk ka mundur të mësohet me kushtet e reja. Për shkak të mungesës së periudhës së mjaftueshme të adaptimit personi nuk ka pranuar të qëndrojë në qendrën për kujdes ditor, me ç'rast është kthyer dukshëm i mërzitur.

Pas inspektimit të kryer në depo dhe kuzhinë MPN konstatoi se Enti disponon me produkte të mjaftueshme të nevojshëm për shfrytëzuesit. Pasi që në Ent ka persona që vështirë mund të konsumojnë ushqim, ishte e dukshme se ka mjaft qumësht dhe prodhime të qumështit, si dhe ushqime të tjera me vlerë të pasur energjike.

MPN në vitin 2012 dha rekomandim gjatë ndarjes së mjeteve kontraceptive që gjithnjë të kërkohet dhe merret aprovimi i kujdestarit apo i shfrytëzuesit (nëse është i aftë për punë). Shfrytëzuesit (dhe/ose kujdestarët e tyre) duhet të jenë të informuar në mënyrë korrekte për qëllimin e mjeteve kontraceptive që u jepen. Nga institucioni është dërguar një shkresë deri te të gjitha qendrat për punë sociale për të siguruar pëlqimin për përdorimin e terapisë kontraceptive. Në këtë drejtim, shumica e kujdestarëve kanë dhënë pëlqimin, ndërsa personave që nuk iu është marrë aftësia për punë iu shpjegohet, gjegjësisht ata ishin të njoftuar për qëllimin e pranimit të terapisë kontraceptive. Nga punonjësit në objektin e ri është treguar se terapia kontraceptive jepet në çdo tre muaj dhe përdoruesit e dinë se për çfarë arsye e marrin terapisë.

Gjatë vizitës u konstatua se Enti ka kërkuar nga qendrat për punë sociale analizë me kohë dhe përcaktim të kujdestarisë për personat për të cilët duhet të ngrihet procedurë për privimin e aftësisë për punë, por duhet edhe koordinim shtesë me ministrinë përkatëse.

Është marrë pëlqimi për punësimin e një punonjësi social, si dhe përfshirja me kontratë e neuropsikiatrit, por duhet të sigurohet edhe mjeku amë për përdoruesit në pajtim me vendin ku është vendosur me qëllim të realizimit të kujdesit shëndetësor pa pengesë.

Në përgjithësi është vlerësuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve paraprakisht të dhëna, janë realizuar nga ky institucion. Shfrytëzuesit nuk kishin ankesa për sjelljen e punonjësve, por është konstatuar se procesi i de-institucionalizimit nuk zbatohet ashtu siç duhet. Në këtë drejtim një pjesë e ekipit profesional u deklarua se ka lëshime të caktuara, gjegjësisht mendimi i personelit të Entit nëse ndonjë shfrytëzues është i përgatitur të jetojë në bashkësi, nuk merret parasysh. Gjithashtu, nuk ekziston përgatitje për vetë procesin, me ç'rast tek disa shfrytëzues ka revoltë dhe refuzim që të largohen nga Enti.

3.5 MASAT E NDËRMARRA DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA

Pas realizimit të vizitave për ri-kontroll në stacionet policore, ku është konstatuar se një pjesë e tyre nuk kanë kushte të përshtatshme për ndalimin e personave, ministria përkatëse ka njoftuar MPN se për zbatimin e Planit Aksional për rikonstruktivitet që do të fillon të implementohet nga viti 2013, në vend të dinamikës paraprakisht të caktuar 2012-2015⁸. Ndërkohë për shkak të anulimit të zbatimit të planit Aksional, në SP

⁸ Në përputhje me planin e aksionit të MPB në vitin 2012 në mesin e 5 stacioneve policore për rikonstruktivitet ishte përcaktuar SP Kumanovë, ndërsa në vitin 2013 SP Kriva Pallankë dhe SP Radovish. Por pas vizitës së realizuar në SP Kumanovë, si dhe në SP Manastir dhe Ohër në vitin 2013, është konstatuar se nuk ka filluar implementimi i planit të aksionit, gjegjësisht rinovimi i vendeve për ndalim.

Kriva Pallankë do të përdoret dhoma ndihmëse për ndalim në të cilën personave do t'iu sigurohen kushte më të përshtatshme dhe më humane për qëndrim. Nga ministria përkatëse u njoftua se gjatë rikonstruktimit të stacioneve policore rekomandimet e MPN do të merren në konsideratë, me qëllim të përmbushjes së standardeve të kërkuara.

Sa i përket sigurimit të buxhetit të posaçëm me të cilin do të përfshihen shpenzimet për ushqim të personave të privuar nga liria në SP Kumanovë, është njoftuar se nga shërbimet kompetente bëhen përpjekje për sigurimin e mjeteve financiare. Në këtë drejtim MPN vlerëson se realizimi i të drejtës për ushqim dhe ujë është tregues i rëndësishëm për trajtimin human të personave të privuar nga liria dhe në asnjë mënyrë personat e ndaluar nuk duhet të lihen pa vakt, i cili ju takon në përputhje me Procedurat Operative Standarde për ndalimin dhe trajtimin e personave të personave të ndaluar. Këto procedura përcaktojnë se ushqimi sigurohet nga fondet personale të personit të ndaluar, nga fondet e familjes së tij dhe/ose nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për rekomandimit që të përpilohet një udhëzim intern për mënyrë e plotësimit të procesverbaleve për ndalim, me definim të qartë të nocioneve privim nga liria, paraburgim dhe ndalim, MBP në përgjigjen e dorëzuar tregoi se në zhvillim e sipër është ndryshimi dhe plotësimi i Procedurave Operative Standarde për ndalim dhe procedurën për personat e ndaluar ku do të rregullohen këto çështje.

Për vizitat për ri-kontroll në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme, MPN mori përgjigje nga **SP Kriva Pallankë, SP Gjevgjeli, SP Kumanovë dhe SP Radovish. SP Kriva Pallankë** në përgjigjen e vet vuri në pah se disponon me hapësirë të kufizuar për ndalimin e personave, gjegjësisht se nuk ka dhoma të përshtatshme që do të adaptoheshin që të mund përkohësisht të përdoren, deri në rikonstruktimin e dhomave të vjetra për ndalim. Në pjesën e rekomandimit për kontroll mjekësor të detyruar për personat me lëndime të dukshme ose me nivel të lartë të alkoolizimit, SP Kriva Pallankë informoi MPN se janë marrë masa në lidhje me këtë rekomandim, si dhe e njëjta evidentohet ashtu siç duhet në procesverbal për të drejtën e mjekut.

Në lidhje me rekomandimet e tjera, është dhënë përgjigje se janë marrë masa në evidencën për përcaktimin e rregullt të rrjedhjeve logjike të ngjarjeve, ka filluar procesi për mbajtjen e evidencës zyrtare për realizimin e ushqimit, si dhe janë futur lista të veçantë të kontrollit për mbikëqyrje të zbatuar mbi personat e ndaluar kur të njëjtit vendosen në bodrum.

SP Gjevgjeli dorëzoi njoftim deri te MPN se janë marrë të gjitha masat për përmbushjen e tërësishme të rekomandimeve të dhëna, gjegjësisht janë larguar të gjitha materialet e lëndët e rrezikshme tualetet për personat e lënduar, ndërsa në lidhje me pajisjen e dhomave për marrje në pyetje dhe ndalim të personave të mitur, ky stacion realizoi bashkëpunim me UNICEF për rregullimin e dhomave të tilla në përputhje legjislationin. Për një pjesë të rekomandimeve për të cilat ekzistojnë pengesa teknike në sferën e realizimit, siç është vendosja e një platforme para hyrjes së stacionit policor që gjendet në katin e parë të ndërtesës, përveç kësaj do të shqyrtohen zgjidhje të përshtatshme për tejkalimin e gjendjes së konstatuar.

Nga **SP Kumanovë** është dorëzuar përgjigje se për mirëmbajtjen e higjienës në vendet e ndalimit, përgjegjës janë vetë zyrtarët e policisë, përderisa sigurimi i ngrohjes së përshtatshme është direkt i lidhur me rikonstruktimin e stacioneve policore, në përputhje me planin e aksionit të MPB. Rekomandimet e mbetura u pranuan nga ky stacion policor.

SP Radovish njoftoi se është vepruar në lidhje me rekomandimet e dhëna, gjegjësisht koha e privimit dhe ndalimit nga liria regjistrohen ashtu siç duhet në procesverbalet për ndalim, mbahet evidencë e posaçme për realizimin të drejtës së ushqimit, të drejtat janë të shfaqura edhe në dhomat e ndalimit dhe është kërkuar sigurimi i dyshekëve dhe batanijeve që do të përdoren në dhomat e ndalimit. Pasi që SP Radovish ka dhoma të vjetruara për ndalim, rinovimi i të njëjtave do të varet nga

zbatimi i Plani Aksional ndërsa aktualisht në përputhje me Vendimin për përcaktimin e stacioneve policore për ndalim i sjellë nga MPB, ky stacion është kompetent të veprojë, gjegjësisht të ndal persona në stacionin policor.

Në lidhje me gjendjen me **Entin Edukues-Korrektues Tetovë**, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve me disa shkresa ka njoftuar se në Projektin për rikonstruktimin e institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe institucioneve edukuese-korrektuese në RM është përfshirë edhe Enti Edukues-Korrektues, me ç'rast në një shkresë, në maj të vitit 2013, është theksuar se në pjesën e dytë të vitit 2013 do të fillojë ndërtimi i këtij objekti. Pas vizitës për ri-kontroll, të realizuar në nëntor të vitit 2013, është dorëzuar informacioni se në gusht 2013 është nënshkruar kontratë me kontraktuesit e punëve ndërtimore dhe pritet ndërtimi të fillojë në vitin 2014 (muajin shkurt) dhe të zgjat 24 muaj. Në përputhje me këtë informacion plani fillestar për të filluar ndërtimin në vitin 2013 është shtyrë për vitin 2014 që sjell në përfundim se ka vonesë në lidhje me afatet e përcaktuara paraprakisht për ndërtimin e Entit Edukues-Korrektues.

Drejtorja njëkohësisht informoi se për rekomandimin për sigurimin e ushqimit të përshtatshëm dhe cilësor për personat e mitur është dhënë në shqyrtim deri në Entin Edukues-Korrektues Tetovë, ndërsa në lidhje me përmirësimin e procesit arsimor dhe të risocializimit janë realizuar më shumë projekte në bashkëpunim me partnerë vendor dhe ndërkombëtar.

Enti Edukues-Korrektues Tetovë r njoftoi MPN se varësisht nga kushtet mbahet konsideratë për ndarjen e personave të mitur dhe të rinjtë e moshë madhore, dhe njëherit është kërkuar përmirësimi i mjeteve financiare për përshtatjen dhe përmirësimin e kushteve të personave të mitur në repartin për ndikim të përforcuar riedukues. Janë siguruar dyshekë të ri, si dhe shtroje për ato raste ku ishte konstatuar se mungojnë ose janë të dëmtuara. Gjithashtu, në lidhje me kujdesin stomatologjik Enti Edukues-Korrektues Tetovë theksoi se merren masa të duhura, ndërsa rekomandimi për vaksinimin e punonjësve për hepatit është zbatuar.

Në lidhje me sigurimin e procesit arsimor, Enti Edukues-Korrektues Tetovë ka njoftuar se në më shumë raste deri te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ka dorëzuar lista me emra të personave të cilët duhet të jenë pjesë e procesit arsimor, por i njëjti akoma nuk ka filluar.

Burgu Shkup ka njoftuar MPN se janë marrë masa për përmirësimin e kushteve për vendosjen e personave të dënuar dhe të paraburgosur, gjegjësisht janë blerë numër i mjaftueshëm i krevateve, janë siguruar dyshekë të përshtatshëm, dhe do të bëhen përpjekje për sigurimin e mbulesës së shtratit. Gjithashtu është zbatuar rikonstruktimi i banjës në repartin gjysmë të hapur me çka do të tejkalohet problemi për ngrohjen e ujit. Burgu Shkup ka njoftuar se është realizuar deratizimi dhe dezinfektimi i dhomave të paraburgimit.

Në lidhje me sigurimin e ushqimit të llojllojshëm që i kënaq vlerat energjike, burgu njoftoi se ka nevojë për fonde të aprovuara nga Ministria e Drejtësisë. Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve nuk iu përgjigj në mënyrë të drejtpërdrejtë rekomandimit për sigurimin e një buxheti të përshtatshëm për ushqim, duke marrë parasysh rritjen e rasteve të paraburgimit, por vetëm e njoftoi MPN se buxheti për ushqim sigurohet në proporcion me numrin e ditëve të paraburgimit të vitit paraprak (në përputhje me Udhëzimin për alokimin e fondeve buxhetore, programi 30 – Institucione ndëshkuese-korrektuese për vitin 2013).

Për ta zvogëluar mbipopullimin në repartin e paraburgimit, ka filluar procedura e transferimit të personave në burgun Kumanovë. Njëkohësisht Drejtoria ka njoftuar se për rikonstruktimin e Burgut Shkup në rrjedhë e sipër është përpilimi i dokumentacionit të projektit, ndërsa ndërtimi i objekteve do të fillojë në gjysmën e dytë të vitit 2014.

Burgu Tetovë e ka njoftuar MPN se mos përmbushja e një pjese të rekomandimeve është për arsye të natyrës financiare, ndërsa për disa gjendje të caktuara

të cilat, para së gjithash, kanë të bëjnë me kushtet e vendosjes është njoftuar edhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve. Në pajtim me burgun, sigurimi i repartit të pritjes ku nuk do të ketë kategori të ndryshme të personave të burgosur është shumë i rëndësishëm, por përmbushja e rekomandimit është kushtëzuar me parakushtet financiare dhe teknike. Përveç kësaj, sa i përket kujdesit shëndetësor burgu ka dorëzuar informacion se do të sigurojë një kasafortë për ruajtjen e terapisë së metadonit, ndërsa për personat që kanë sëmundje të caktuara do të sigurojë regjim special të ushqimit.

Edhe nga Drejtoria për Ekzekutimin e sanksioneve, në lidhje me rinovimin dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme, është theksuar problemi i sigurimit të fondeve. Në përgjigje, Drejtoria ka informuar se me qëllim të rritjes së kapaciteteve të vendosjes nëpër burgje, në rrjedhë e sipër është realizimi i një Projekt për rikonstruktimin e institucioneve ndëshkuese-korrektuese që do të përfshijë ndërtimin dhe rikonstruktimin e Entit Ndëshkues-Korrektues "Idrizovë", burgut Shkup, burgut Kumanovë dhe Entit Edukues – Korrektues Tetovë. Megjithatë MPN vuri në dukje se sigurimi i kushteve të përshtatshme duhet të zbatohet në të gjitha burgjet, ndërsa me ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve të përcaktuara me projekt do të përmirësohen kushtet në institucionet e lartpërmendura dhe do të ndikohet në zvogëlimin e mbipopullimit që në përgjithësi ekziston në të gjitha burgjet. Pasi që në burgun Tetovë është konstatuar mbipopullim, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dorëzoi një informacion edhe për projektin për vendosjen e shërbimit masa alternative të dënimit (lirim me kusht) punë në komunitet) në kuadër të Drejtorisë.

Burgu Strumicë dorëzoi një përgjigje me të cilën njoftoi se Drejtoria e burgut rregullisht i viziton personat e burgosur dhe gjatë vizitave nuk ka pasur ankesa për sjellje jo korrekte nga punonjësit në Sektorin e sigurimit. Pas vizitës burgu ka vendosur një kuti postale për paraqitjen e personave të burgosur për kontroll mjekësor. Përveç mbikëqyrjes së zbatuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, dhe me kërkesë të MPN, burgu Strumicë ka ndërmarrë aktivitete për rinovimin dhe pajisjen e ambulancës, me ç'rast janë siguruar kushte në përputhje me të gjitha standardet, dhe njëherësh është bërë përshtatja e një dhome për bastisjen e personave të burgosur. Në lidhje me sigurimin e konfidencialitetit të dokumentacionit mjekësor, qasje në të njëjtin ka vetëm mjeku, dhe janë shtypur kartonë shëndetësor përkatës në përputhje me rekomandimet e dhëna. Për rekomandimet e mbetura burgu Strumicë ka njoftuar se në pjesën e izolimit është vendosur sistemi elektrik për thirrje, ndërsa në aspektin për angazhim pune drejtoria e burgut bashkëpunon me disa institucione shtetërore, si dhe me disa shkolla të mesme.

Nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të cilës i është dorëzuar rekomandimi për punësimin e një mjeku dhe një infermiere për të siguruar kujdes shëndetësor të vazhdueshëm dhe për çdo ditë, është dhënë përgjigje se në të kaluarën në disa raste është dorëzuar kërkesë deri te Ministria e Financave për dhënie të pëlqimit për punësim, por deri më tani nuk ka punësime të reja në këtë burg. Ashtu si në burgun Tetovë edhe për këtë burg Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve në lidhje me rinovimin e disa pjesëve ka theksuar se është i nevojshëm sigurimi i fondeve shtesë.

Në lidhje me raportin për vizitën për ri-kontroll **Burgu Ohër** dorëzoi një përgjigje me të cilën njoftoi MPN se është dhënë urdhri për mospërdorimin e dhomave të izolimit deri në sigurimin e kushteve të përshtatshme. Pas kontrollit për shkeljet e mundshme nga Shërbimi i sigurimit, burgu ka konstatuar se nuk ka elemente për sjellje të tillë nga Sektori i lartpërmendur.

Në lidhje me pajisjen e një dhome të veçantë për kontroll, burgu ka informuar se e njëjta do të pajiset pasi që të sigurohen fonde për atë qëllim. Burgu, pas rekomandimit të dhënë dhe për shkak të mungesës së mjekut me marrëdhënie pune të rregullt, ka kufizuar qasjen ndaj dokumentacionit mjekësor me qëllim të sigurimit të konfidencialitetit të të dhënave të personave të privuar nga liria.

Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve ka dorëzuar një informacion se është

bërë analiza e gjendjes së procesit arsimor në institucionet ndëshkuese – korrektuese dhe në institucionet edukuese-korrektuese dhe i njëjti është dorëzuar deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me ç'rast kjo ministri duhet të ofrojë mënyrë për organizimin e procesit arsimor në burgun Ohër. Drejtoria kërkoi nga MPN nëse i njëjti ka kompetencë rekomandimin ta dorëzojë deri te ministria përkatëse për arsim dhe shkencë. Megjithatë, MPN vlerëson se Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve e cila është organi përgjegjës për ekzekutimin e sanksioneve, është përgjegjëse për realizimin e të drejtave të personave të dënuar në mes të cilave edhe të drejtën për arsimim. Mënyra e koordinimit dhe organizimit me ministritë e tjera është detyrë e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Zgjidhja e mungesës së personelit mjekësor sipas Drejtorisë do të tejkalohet me ndryshimet e ligjit në përputhje me të cilat do të zgjidhet statusi i punonjësve mjekësor, gjegjësisht të njëjtit do të merren nga institucionet shëndetësore publike që kryejnë kujdesin shëndetësor primar.

Burgu Gjevgjeli në vend që të përgjigjet se në çfarë mënyre do të veprojë sipas rekomandimeve të dhëna, u lëshua në vlerësimin nëse MPN saktësisht i ka perceptuar gjendjet gjatë vizitës që ka realizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Mjekësisë Ligjore dhe Shoqatën për të Drejtën Penale dhe Kriminologji. Në këtë mënyrë burgu ka njoftuar MPN se mjeku në mënyrë profesionale kryen punën e tij, ndërsa qasjen deri te dokumentacioni mjekësor e ka Sektori i sigurimit për shkak të mungesës së personelit të rregullt mjekësor. Për realizimin e rekomandimit për t'iu mbrojtur pjesa e hapësirës për shëtitje nga kushtet e jashtme atmosferike, burgu ka theksuar se për këtë nevojiten më tepër fonde me të cilat për momentin nuk disponojnë. Gjithashtu, burgu hyri në shpjegime nëse ka qenë objektiv perceptimi i MPN për kushtet në një pjesë të reparteve, ndërsa nuk i ishte përgjigjur rekomandimit nëse dhe si do të merren masa efikase nga institucioni me qëllim të zvogëlimit, gjegjësisht parandalimit të trajtimit jonjerëzor ndaj personave të privuar nga liria.

Burgu Gjevgjeli u pajtua se regjistri për përdorimin e mjeteve për detyrim duhet të ketë numra dhe vullë në çdo faqe për të evituar çfarëdo keqpërdorimi nga ana e zyrtarëve.

Drejtoria për Ekzekutimin e sanksioneve, në lidhje me rekomandimin për punësimin e një mjeku dhe një infermiere në burgun Gjevgjeli, e ka njoftuar MPN se me ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve zgjidhet edhe statusi i personelit mjekësor. Në lidhje me rekomandimin për sigurimin e arsimit fillor dhe të mesëm për të burgosurve Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ka njoftuar se janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe masat që janë nën kompetencat e saj, ndër të cilat edhe përgatitja e analizës për gjendjen në procesin arsimor në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe në institucionet edukuese-korrektuese.

Për vizitën e realizuar në **Qendrën për Pranimin e Azilkërkuesve** është dorëzuar përgjigja me të cilën Qendra ka informuar se ky institucion në vazhdimësi siguron kujdes shëndetësor për të përkujdesurit dhe atë me kompensim të shpenzimeve për intervenime specialistike dhe subspecialistike, për furnizime të rregullta të ilaçeve, si dhe ekzaminimet me kohë nga ordianca me të cilën institucioni ka lidhur kontratë. Në lidhje me rekomandimin për sigurimin me kohë të veshmbathjeve për azilkërkuesit, institucioni ka theksuar se i njëjti po zbatohet në pajtim me dinamikën e azilkërkuesve dhe kushteve klimatike. Për vërejtjen për përpilimin e rregullave të shtëpisë për gjuhët që do t'iu kumtohen azilkërkuesve, Qendra për pranim e ka njoftuar MPN se në bashkëpunim me Zyrën e Komisarit për Refugjatë dhe Ministrinë për Punë dhe Politikë sociale është përgatitur një broshurë informative për azilkërkuesit në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre, dhe përveç kësaj do të përkthehet edhe në gjuhët që më së shpeshti i flasin azilkërkuesit. Në lidhje me rekomandimin për vendosjen e një protokollit të shkruar për të vepruar gjatë dhunës fizike dhe incidenteve ndërmjet personave të vendosur në qendër, Qendra ka informuar se protokollit është paraparë për

aspektet e detyruara për të vepruar, të dhëna nga drejtori i këtij institucioni. Nga ministria përkatëse është theksuar se rekomandimi për rinovim, me qëllim të tejkalimit të kushteve të papërshtatshme do të merret në konsideratë për të siguruar fonde shtesë nga buxheti ekzistues i ministrisë.

MPB ka dorëzuar një përgjigje me të cilën ka njoftuar se një pjesë e rekomandimeve të dorëzuara janë zbatuar plotësisht, gjegjësisht qasje deri në ambulancë ka vetëm mjeku, janë siguruar informacione për rendin shtëpiak në gjuhën që e kuptojnë personat e vendosur në **Qendrën për Pranimin e të Huajve**, është siguruar e drejta e personave për të kontaktuar familjet e tyre, është vendosur edhe koordinimi me Qendrën për punë sociale, dhe personat njoftohen me të drejtën e azilit. Gjithashtu, MPB ka njoftuar se është vepruar në lidhje me rekomandimin e MPN për ndryshimin e Rregullores për rendin shtëpiak me të cilin përcaktohet e drejta për shëtitje na ambient të hapur të personave të vendosur në këtë qendër. Një pjesë e rekomandimeve janë zbatuar pjesërisht, ndërsa për ato që nuk janë zbatuar janë paraparë aktivitete në Programin e punës së njësisve organizative në Policin kufitare për vitin 2014, ndërsa rekomandimet e dorëzuara janë marrë në konsideratë edhe gjatë përpilimit të Planit Aksional.

Institucioni Publik për Kujdesen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale në përgjigjen e tij për vizitën e parë për ri-kontroll ka theksuar se ky institucion është i llojit të hapur dhe shpeshherë shfrytëzuesit fusin alkoool dhe cigare, por personat profesional bëjnë përpjekje që këto dukuri të dëmshme të evitohen përmes bisedave, sesioneve edukative si dhe përmes sanksionimit të sjelljes së tillë. Njëkohësisht nxënësit mësojnë për shprehitë higjienike jetësore.

Rekomandimi për zëvendësimin e dritareve të thyera është zbatuar, ndërsa institucioni publik i regjistron të gjitha rastet në regjistrin për ngjarje ditore mes të cilave dhunën fizike dhe vetëlëndimin. Por, për të përmbushur rekomandimin, në të ardhmen institucioni do të mbajë një libër të veçantë për dhunën fizike dhe vetëlëndimin.

Në lidhje me raportin për vizitën në orët e natës në Institucioni Publik për Kujdesen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale, institucioni është pajtuar me konstatimin për mungesën e resurseve njerëzore sidomos gjatë natës, kur personi i njëjtë është edhe edukator edhe gardian, gjë për të cilën është njoftuar ministria përkatëse. Përveç kësaj, përmes marrëveshjes janë marrë tre edukatorë, dy nga të cilët janë caktuar në turnin e natës ndërsa njëri në turnin e ditës.

Institucioni ka konstatuar gjendje me përzierjen e kategorive të personave, gjegjësisht se në të njëjtin vendosen edhe persona të mitur, kryerës të veprave penale, por veprojnë sipas aktvendimeve të qendrave për punë sociale. Në lidhje me rekomandimet e tjera ky Institucion publik ka njoftuar se është vepruar në lidhje me ta, ndërsa përveç kësaj po përgatiten procedura interne në lidhje me punën individuale të ekipit profesional me persona të mitur.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale më tej ka informuar se në Institucioni Publik për Kujdesen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale duhet të udhëzohen persona të mitur me probleme edukativo-sociale, por jo dhe kryerës të veprave penale, me qëllim që të parandalohet infeksioni kriminologjik. Në këtë drejtim Ministria ju ka dhënë rekomandime qendrave për punë sociale. Për shkak të pamundësisë që të zbatohet rekomandimi për punësimin me marrëdhënie pune të rregullt të një mjeku-specialist në fushën e psikiatrisë për fëmijë, shfrytëzohen shërbimet e Entit për shëndësi mentale. Në përputhje me rekomandimin e fundit Ministria do të kërkojë që të jep definicion ligjor për termin "fëmijë me probleme edukativo-sociale".

Në lidhje me gjendjen e konstatuar në **Institucionin Publik Enti për Përkujdesje, Edukim dhe Arsimit të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Milonoviç"** institucioni dorëzoi një përgjigje se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Njëkohësisht është potencuar se për një pjesë të rekomandimeve ky institucion nuk mund të veprojë, sepse xhirologjaria e tij akoma është e bllokuar. Ministria për

Punë dhe Politikë Sociale dorëzoi një përgjigje se në kuadër të fondeve në dispozicion në vitin 2014 do të rinovohet reparti i meshkujve, si dhe do të pajisen një numër i caktuar i dhomave në të cilat do të zhvillohen aktivitetet e lira të fëmijëve, dhe njëherit do të detyrojë institucionin të përpilojë një plan dhe program për përmirësimin e organizimit të punës së institucionit që do të kontribuojë drejt rritjes së efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit të edukimit dhe riedukimit.

Në lidhje me rekomandimet për **Entin e Specializuar Demir Kapi**, MPN nuk mori përgjigje në afatin e paraparë ligjor për çka dhe ka dorëzuar urgjencë deri te Ministria përkatëse, si dhe deri te Enti Demir Kapi. Përveç kësaj, enti e ka informuar MPN se do të vazhdojë me rinovimin e objekteve të mbetura, do të sigurojë përkujdesje të përshtatshme në pjesën e mirëmbajtjes së higjienës dhe do të mbajë llogari për gjininë gjatë zbatimit të larjes. Në lidhje me rekomandimin për punësimin e një mjeku, ky institucion ka dorëzuar kërkesë deri te ministria përkatëse, por akoma nuk ka marrë pëlqim.

4 GJENDJA ME MIGRANTËT E ILEGALË DHE AZLKËRKUESIT

Gjatë viteve të fundit RM është vend transit përmes së cilës kalojnë migrantë të ilegalë dhe azilkërkues, prandaj në këtë drejtim në vitin 2013 MPN ka i kushtuar kujdes të veçantë gjendjes dhe trajtimit të personave të kësaj kategorie. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që privimi nga liria për migrantët të përdoret si opsion i fundit. Kur shqiptohet privimi nga liria, gjegjësisht ndalimi, i njëjti duhet të jetë i domosdoshëm dhe në proporcion me qëllimin legjitim që dëshirohet të arrihet. Direktiva e BE (2008/113/EC) përcakton se secili vend anëtar duhet ta kufizojë periudhën e privimit nga liria. Kur, megjithatë, aplikohet privimi nga liria për migrantë dhe azilkërkuesve duhet të merret në konsideratë që të sigurohen kushte që do të reflektojnë statusin dhe nevojat e personave, gjegjësisht të mos jenë me regjim të burgut që do t'i trajtojnë migrantët si persona të burgosur. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që qendra të themeluara posaçërisht për vendosjen e emigrantëve që do të bashkëveprojnë me statusin ligjor⁹.

Megjithatë kur migrantët vendosen në vendet për privimin nga liria duhet të respektohen standardet relevante ndërkombëtare dhe rajonale për privim nga liria. Duhet që personat të kenë qasje në procedurat për azil, si dhe të kenë mekanizma mbrojtës që janë të rëndësishëm për parandalimin e torturës. Mekanizmat mbrojtës duhet të përfshijnë qasje tek avokati mbrojtës, ekzaminimi mjekësor si dhe mundësia për të kontaktuar familjen dhe përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike-konsullore. Mbrojtje e veçantë duhet t'u sigurohet fëmijëve – migrantë, femrave, personave me aftësi të kufizuara mentale, si dhe për personave me probleme të posaçme shëndetësore, viktimave të trafikimit me njerëz dhe personave të moshuar.

Në RM ekzistojnë dy qendra, njëra për pranimin dhe vendosjen e të huajve që është në përgjegjësi të MPB, si dhe qendra për strehimin e azilkërkuesve në përgjegjësi të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale. Në vitin 2013 MPN në bashkëpunim me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj realizoi vizitë në këto qendra, si dhe në tre vendkalime kufitare me qëllim të përcaktimit se si trajtohen të huajt, migrantët ilegalë dhe azilkërkuesit. Gjatë vizitave MPN udhëhoqej në përputhje me 10 Parimet udhëheqëse që kanë të bëjnë me azilkërkuesit dhe migrantët e paligjshëm, si dhe në përputhje me standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT)

Në pajtim me Ligjin për azil dhe mbrojtjes së përkohshme, kërkesa për azil mund të dorëzohet edhe në vendkalimin kufitar ose në stacionin policor më të afërt. MPN nga stacionet policore për kontroll kufitar është njoftuar se sugjerohen të drejtat e personave të privuar nga liria, si dhe të migrantëve ilegalë në gjuhën që ata e njohin, dhe në rast se nuk e dinë gjuhën lajmërohet sektori përkatës në MPB dhe merren veprime përkatëse. Gjatë vizitës së qendrave për vendosje, pjesa më e madhe e personave theksuan se nuk kanë qenë të njoftuar për të drejtën që të kërkojnë azil edhe në vendkalim kufitar. Në vendkalimet kufitare është konstatuar se nuk ka dhomë të veçantë për azilkërkuesit.

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut "të gjithë, pa dallim të sta-

⁹ Standardet e KPT, cituar nga Raporti i përgjithshëm i 7-të, pika.54

tusit të migrimit ka të drejta themelore për trajtim të barabartë para ligjit të njëjtë. Migrantët nuk duhet të jenë të diskriminuar për shkak të statusit të tyre". Në këtë drejtim edhe Komisari për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës ka dhënë rekomandim deri te vendet anëtare që "të gjithë personat gjatë ardhjes në kufi të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre".

MPN ka potencuar edhe Rezolutën 1707 (2010) për *Privimin nga liria të azilkërkuesve dhe migrantëve të paligjshëm në Evropë*¹⁰ në të cilën në pikën 9.2.3 thuhet se personat e ndaluar duhet të informohen në mënyrë adekuate në një gjuhë të thjeshtë që e kuptojnë për të drejtat themelore, si dhe rregullat dhe procedurat e ndalimit. Në këtë pjesë edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportet vjetore¹¹ thekson se në interes edhe të migrantëve por edhe të personelit është të ekzistojnë rregulla të qarta të shtëpisë dhe një kopje e këtyre rregullave të jetë në dispozicion në gjuhët të cilat më së shpeshti i përdorin këta persona. Rregullat kërkojnë që personat e ndaluar të mos pyeten për të nënshkruar dokument në gjuhën që nuk e kuptojnë ose përmbajtjen e të cilit nuk e kuptojnë¹².

Sipas udhëzimeve për migrantët ilegalë që kërkojnë vendosje të përshtatshme, MPN konstatoi e në Qendrën për Pranimin e të Huajve nuk janë përmbushur standardet e dëshiruara. MPN theksoi se edhe standardet e KPT përcaktojnë sigurimin e dhomave të pajisura ashtu siç duhet me orendi të cilat duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të mirë, me sipërfaqe hapësinore të mjaftueshme për personat që qëndrojnë aty. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që personat të mos vendosen në kushte substandarde, dhe përveç kësaj kushtet për vendosje mund të paraqesin edhe shkak për trajtim johuman sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹³.

